



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 46

Tiranë – E enjte, 25 mars 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 22.3.2021	Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar.....	5135
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 24.3.2021	Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar “ <i>Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret</i> ” A.Ş. për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (<i>vero cell</i>), <i>Coronovac</i> , të krijuar nga <i>Sinovac Life Science Co Ltd.</i> dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës.....	5137
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 10.2.2021	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Bashkinë Fier.....	5137
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 17.3.2021	Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.....	5138
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 17.3.2021	Për miratimin e marrëveshjes së grantit për asistencë teknike për rrjetin hekurudhor në Shqipëri – rehabilitimin e linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimin e lidhjes hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), Hekurudhës Shqiptare (entiteti i projektit) dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim, të mbështetur nga fondi i veçantë i iniciativës evropiane qendrore dhe me aksionar BERZH-in.	5140
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 160, datë 17.3.2021	Për miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për përdorimin e fondeve të mbetura nga programi “Mbrojtja mjedisore e liqenit të Shkodrës”, për t’u përdorur për financimin e shërbimit të borxhit për marrëveshjen e huas për programin “Infrastruktura bashkiake II”.....	5157

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 17.3.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 226, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e kostos së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit”.....	5158
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 163, datë 17.3.2021	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të portit të peshkimit në Triport, Vlorë.	5159
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 17.3.2021	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Hysko.....	5160
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 165, datë 17.3.2021	Për disa shtesa në vendimin nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”.....	5160
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 166, datë 17.3.2021	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë të pafrytshme”, të sipërfaqeve të pasurive me numra 821/46 dhe 822/34, zona kadastrale 1492, Bashkia Divjakë.....	5161
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 17.3.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar.....	5168
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 24.2.2021	Për mbulimin e shpenzimeve financiare të prokurorit të sistemit të prokurorisë, që shërben si prokuror ndërlidhës pranë <i>Eurojust</i> -it.....	5168
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 174, datë 24.3.2021	Për kryerjen e pagesës së dozave të vaksinave, që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar “ <i>Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret</i> ” A.Ş., për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (<i>vero cell</i>) <i>Coronovac</i> , të krijuar nga <i>Sinovac Life Science Co Ltd.</i> dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës.....	5169
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 17.3.2021	Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e spitalit rajonal “Memorial” në Fier, si projekt pilot.....	5170
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 23.2.2021	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me nenin 81, pika 2 të Kushtetutës të shprehjes “ <i>së Apelit</i> ”, në nenin 29, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.....	5172
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 23.2.2021	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2018-217 (30), datë 13.2.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	5182
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 9.3.2021	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të urdhrit nr. 633, datë 17.11.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	5187



AKT NORMATIV
Nr. 8, datë 22.3.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT
2021”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Në nënndarjen “- Fondi rezervë i buxhetit ...” shifra “... 3 000 milionë lekë” zëvendësohet me “... 4 000 milionë lekë”.

2. Nënndarja “Fondi për studime dhe projekte ...” hiqet.

3. Tabela 4, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën 4, që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2

Neni 14 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 14

Fondi rezervë, prej 5 000 milionë lekësh, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për:

- raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme, në masën 4 000 milionë lekë;

- përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, në masën 1 000 milionë lekë;

Kontingjenca për risqet e borxhit, prej 4 500 milionë lekësh, përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondit rezervë dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Tab. 4

TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021
FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2021

ne milion leke (in million lek)

Nr.	E M E R T I M I	Buxheti 2021 AN	Ne % te PBB	I T E M S
	TOTALI TE ARDHURAVE	487,526	29.0%	TOTAL REVENUE
I.	Te ardhura nga ndihmat	20,353	1.2%	Grants
	<i>Nga te cilat: mbeshetje buxhetore</i>	<i>9,553</i>	<i>0.6%</i>	<i>from which: Budget Support</i>
	<i>Nga te cilat: projekte te destinuar per investime</i>	<i>11,000</i>	<i>0.7%</i>	
II.	Te ardhura tatimore	445,573	26.5%	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	319,592	19.0%	From tax offices and customs
	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	152,061	9.0%	V.A.T.
	Tatimi mbi Fitimin	33,031	2.0%	Profit Tax
	Akczizat	49,000	2.9%	Excise Tax
	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	41,000	2.4%	Personal Income Tax
	Taksa Nacionale dhe te tjera	36,000	2.3%	National Taxes and others
	Taksa Doganore	6,500	0.4%	Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	25,426	1.5%	Local Taxes
	Taksa Lokale	19,778	1.2%	Local Taxes
	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	5,648	0.3%	Property Tax
II.3	Te ardhurat nga Fondet Speciale	100,555	6.0%	Revenues from Special Funds
	Sigurimi Shoqeror	85,471	5.1%	Social Insurance
	Sigurimi Shendetesor	14,084	0.8%	Health Insurance
	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	1,000	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
III.	Te ardhura Jotatimore	21,600	1.3%	Nontax Revenue
	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	1,000	0.1%	Profit transfer from BOA
	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	12,000	0.7%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	300	0.0%	Divident
	Tarifat e Sherbimeve	2,800	0.2%	Services Fees
	Te tjera	5,500	0.3%	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	596,221	35.4%	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	467,769	27.8%	Current Expenditures
1	Personeli	91,834	5.5%	Personnel expenditures
	Paga	71,085	4.2%	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	11,699	0.7%	Social insurance contributions
	Fondi i vecante i pagave	250	0.0%	Bonus fund
	Politika te reja pagash	8,000	0.5%	Contingency for new wage policies
	Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta	800	0.0%	Higher Education from its own revenues
2	Interesat	43,800	2.6%	Interest
	Te Brendshme	24,300	1.4%	Domestic
	Te Huaja	15,000	0.9%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit	4,500	0.3%	Contingency for debt related risks
3	Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat:	49,888	3.0%	Operational & Maintenance of which:
	<i>Te qeverisjes qendrore</i>	<i>46,538</i>	<i>2.8%</i>	<i>Central government</i>
	<i>Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta</i>	<i>800</i>	<i>0.0%</i>	<i>from revenues of Higher Education System</i>
	<i>Te tjera jashte limitit</i>	<i>2,550</i>	<i>0.2%</i>	<i>from Exceptional Revenues</i>
4	Subvencionet	1,550	0.1%	Subsidies
5	Shpenzime per Fondet Speciale	195,171	11.6%	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	142,265	8.5%	Social insurance
	Politika te reja pensionesh	2,400	0.1%	Contingency for new pension policies
	Bonusi i Pensionistev			Pensioners' Bonus
	Sigurime Shendetesore	47,506	2.8%	Health insurance
	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	3,000	0.2%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	56,826	3.4%	Local Budget expenditure
	Transferrat nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	27,050	1.6%	Central Government Grant for Local Government
	<i>Transferte e pakushtëzuar e përgjithshme</i>	<i>18,450</i>	<i>1.1%</i>	<i>Unconditional Fund</i>
	<i>Transferte e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specific)</i>	<i>8,100</i>	<i>0.5%</i>	<i>Specific Grant</i>
	<i>Transferte per emergjencat civile</i>	<i>500</i>		
	Buxheti vendor (te ardhurat e veta tatimore)	25,426	1.5%	Local Budget (Own revenues)
	Taksa te ndara	900	0.1%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (te ardhurat e veta jo-tatimore)	2,700	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor	750	0.0%	Local foreign financing
7	Shpenzime te tjera	28,700	1.7%	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	800	0.0%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia	24,700	1.5%	Social assistance and disability
	Kompensim per ish te përdjekurit politike	1,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,200	0.1%	Birth Bonus
II.	Fondi Reserve	5,000	0.3%	Reserve fund, Contingency
	Fondi Reserve	4,000	0.2%	Reserve Fund
	Rezerve per zgjedhjet	1,000	0.1%	Contingency for deficit financing
III.	Shpenzime Kapitale	123,452	7.3%	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	60,024	3.6%	Domestic financing
	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1,000	0.1%	From Higher Education System's own revenues
	Financimi Huaj	34,428	2.0%	Foreign financing
	<i>nga te cilat: Energjia</i>	<i>2,300</i>	<i>0.1%</i>	<i>from which: Energy</i>
	Fondi i Rindertimit	28,000	1.7%	
	DEFICITI	-108,695	-6.5%	Cash Balance
	FINANCIMI DEFICITIT	108,695	6.5%	Financing (Cash)
	Brendshem	95,642	5.7%	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi			Privatization receipts
	Hua-marreje e brendshme	49,900	3.0%	Domestic borrowing
	Te tjera	45,742	2.7%	Other
I	Huaj	13,052	0.8%	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	24,178	1.4%	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arktes			Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-40,890	-2.4%	Repayments
	Mbeshetje buxhetore	29,764	1.8%	Budget support
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	1,682,637	100.0%	Gross Domestic Product (GDP)

**AKT NORMATIV**
Nr. 10, datë 24.3.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR “KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET” A.Ş. PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN E INAKTIVIZUAR KUNDËR COVID-19 (VERO CELL), CORONAVAC, TË KRIJUAR NGA SINOVA LIFE SCIENCE CO LTD. DHE TË PRODHUAR NË REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1****Miratimi i marrëveshjes së nënshkruar**

Miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar “Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret” A.Ş. për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (*vero cell*), *Coronavac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 156, datë 10.2.2021

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PËR BASHKINË FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar në vitin 2021, në llogarinë ekonomike 604 “Transferta të brendshme”, të programit 07330 “Shërbimet e kujdesit dytësor”, i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, i cili i transferohet Bashkisë Fier, për financimin e shpenzimeve të akomodimit të punonjësve të angazhuar për ndërtimin e spitalit të Fierit.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM
Nr. 158, datë 17.3.2021

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE
TË PROCEDURAVE PËR SHPALLJEN E
GJENDJES SË FATKEQËSISË
NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 40, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjendja e fatkeqësisë natyrore shpallet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga pasoja të shkaktuara nga fatkeqësia, nuk janë në gjendje ta përballojnë atë.

2. Shpallja e gjendjes së emergjencës dhe klasifikimi i llojit të saj varen nga këta faktorë:

a) shtrirja territoriale e zonës së dëmtuar ose të prekur, sipas rastit;

b) ndikimet e këtyre dëmeve në prishjen e ekuilibrave të jetës normale të komunitetit;

c) të dhënat shkencore nga institutet/strukturat përkatëse, për rastin konkret të fatkeqësisë.

3. Shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe klasifikimi i llojit të saj varen nga këta faktorë:

a) Për tërmetet, të dhënat e para jepen nga strukturat brenda 2 (dy) orëve dhe në mënyrë periodike për vijueshmërinë e goditjeve sizmike, dëmet e shkaktuara në humbje të jetëve njerëzore, banesa dhe dëme të tjera infrastrukturore, deri në shuarjen përfundimtare të goditjeve sizmike.

b) Për përmbytjet dhe vërshimet e ujit, që vijnë si rezultat i rritjes në nivele kritike të ujit, nga faktorë gjeologjikë, atmosferikë apo njerëzorë, në shtratin e lumenjve, në nivelin e liqeneve apo në baticat bregdetare, duke mbuluar përkohësisht me ujë sipërfaqe tokë në atë nivel që përbëjnë rrezik për njerëzit, banesat dhe infrastrukturën.

c) Temperaturat ekstreme e të tejzgjatura, kur këto shkaktojnë dëme serioze në jetën dhe shëndetin e njerëzve, edhe në pasuritë e tyre.

ç) Rrëshqitjet arkitektonike të shkaktuara drejtpërdrejt nga një ngjarje tërmeti apo nga dukuri të tjera gjeologjike, të cilat kanë shkaktuar humbje të jetëve njerëzore, të gjësë së gjallë ose dëme në banesa dhe infrastrukturë.

d) Për ortekët e formuar nga dëborat e akumuluar dhe e paqëndrueshme, në terrene të pjerrëta mjaftueshëm (mbi 30°), rënia e të cilëve ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në njerëz dhe në gjënë e gjallë ose bllokim të rrjetit të infrastrukturës kritike.

dh) Për erërat e forta në tokë dhe në det, kur ato zgjasin në kohë e në hapësirë, duke sjellë probleme për transportin rrugor dhe atë detar, duke u shoqëruar me rrëzime të pemëve, të objekteve apo të strukturave të ndryshme me rrezik për aksidente, gjymtje e dëme të pronës dhe, me raste, kërcënim të jetës.

e) Për zjarret masive në pyje apo në zona të populluara, kur ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë të flakëve, në zonat e ekspozuara, duke kërcënuar jetën e njeriut, pronën dhe gjënë e gjallë, shoqëruar me temperatura të larta dhe erëra të forta, duke bërë edhe kontrollin e tyre shumë të vështirë.

ë) Për sëmundje infektive me përhapje masive, të cilat mund të jenë epidemi, e cila është paraqitja e dy dhe më shumë rasteve të sëmundjeve infektive, të lidhura në kohë e në territor apo rritje mbi normën e pritur të numrit të rasteve të sëmundjes dhe pandemi, ku përhapja masive e sëmundjes ngjitetë i kalon kufijtë e shtetit, duke përfshirë disa shtete e më shumë se një kontinent.

f) Për aksidentet teknologjike që vijnë si rezultat i sulmeve terroriste, të problemeve teknike të pajisjeve prodhuese, dështimeve teknike, kompleksitetit të tepërt të procesit të prodhimit, gabimeve në projektim dhe prodhim, zhvlerësimit të pajisjeve, mjeteve të vjetëruara të prodhimit, gabimeve apo dëmtimeve me dashje të personelit, keqkuptimeve për veprimet e përbashkëta të profesionistëve, faktorë të jashtëm etj., kur këto shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve e në pasuritë e tyre.

g) Për aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, që vijnë si rezultat i dështimeve, gabimeve njerëzore, dobësive të thella strukturore të vetë mjeteve, teknikës apo të infrastrukturës së tyre, ose faktorë të jashtëm, të cilët shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve dhe në pasuritë e tyre.

gj) Për aksidentet bërthamore apo radiologjike, që vijnë si rezultat i zhvillimeve të pakontrolluara të ciklit të prodhimit nga operatorë të ndryshëm apo të ndërmarrjeve me veprimtari me rrezatime



jonizuese, një situatë jo e zakonshme ose ngjarje që përfshin një burim rrezatimi që dikton masa të menjëhershme për të zbutur pasojat e rënda të dëmshme për sigurinë, shëndetin e njeriut, cilësinë e jetës, pronën ose mjedisin ose një emergjencë në të cilën ka ose parashikohet të ketë një rrezik nga energjia si pasojë e reaksionit zinxhir bërthamor ose nga zbërthimi i produkteve të një reaksioni zinxhir bërthamor ose ekspozimi ndaj rrezatimit.

h) Rrëzimet e digave të shkaktuara drejtpërdrejt nga një ngjarje tërmeti, nga amortizimi në vite, ndryshimi i kushteve klimatike etj., që sjellin si pasojë përmbytje masive, të cilat shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve e në pasuritë e tyre, si dhe kolaps në ekonomi.

i) Për dukuri natyrore ekstreme apo fatkeqësi të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, në gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

4. Institucionet, institutet dhe strukturat kryesore të ngarkuara për dhënien e informacionit dhe vlerësimit paraprak të dëmeve për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore janë:

a) ministritë, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore apo të kompetencave që kanë lidhje me dukurinë natyrore apo fatkeqësitë e tjera;

b) institutet/strukturat shtetërore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e shkallës së fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësitë e tjera;

c) prefekti i qarkut;

ç) bashkia në territorin e së cilës ndodh fatkeqësia.

5. Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kur sigurohen të dhënat, sipas pikës 3, të këtij vendimi, ndiqen këto procedura:

a) Në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në një kohë sa më të shpejtë nga momenti i konstatimit të një dukurie, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, dërgohen raporte me të dhëna nga autoritetet e listuara, më poshtë vijon:

i. institucionet, institutet dhe strukturat shtetërore përgjegjëse për monitorimin e vlerësimin e intensitetit të fatkeqësisë, të cilat, në varësi të llojit të fatkeqësisë, dërgojnë të dhënat e para të regjistruara në mënyrë periodike, plotësojnë këto të dhëna, përgatisin raporte deri në shuarjen e plotë të aktivitetit të fatkeqësisë;

ii. prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë, për gjendjen e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia në territorin e përgjegjësisë së tyre.

b) Raporti i vlerësimit paraprak të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia, i dërguar nga kryetari i bashkisë dhe prefekti i qarkut, shoqërohet me kërkesë për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

c) Me marrjen e të dhënave dhe të kërkesës, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile analizon e vlerëson të dhënat dhe paraqet raportin e situatës e, sipas rastit, i propozon ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

ç) Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, vendos shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë në të gjithë territorin ose për një pjesë të territorit të vendit.

6. Nisma për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për rastet sipas pikës 10, të nenit 3, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ndërmerret nga ministritë e linjës, sipas veçorive që shfaqen, si dhe fushës së përgjegjësisë shtetërore apo kompetencave që mbulojnë, në bashkëpropozim me ministrin përgjegjës për mbrojtjen civile, bazuar në informacionin e marrë nga institutet/strukturat shtetërore përkatëse dhe organet e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia.

7. Vendimi nr. 664, datë 18.12.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen të gjitha ministritë, institutet kërkimore e shkencore, të përmendura në pikën 5, të këtij vendimi, entet publike, sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore që mbulojnë për mbrojtjen civile, në bashkëpunim me organet e vetëqeverisjes vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**VENDIM**

Nr. 159, datë 17.3.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT PËR ASISTENCË TEKNIKE PËR RRJETIN HEKURUDHOR NË SHQIPËRI – REHABILITIMIN E LINJËS HEKURUDHORE TIRANË–DURRËS DHE NDËRTIMIN E LIDHJES HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (MARRËSI), HEKURUDHËS SHQIPTARE (ENTITETI I PROJEKTIT) DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, TË MBËSHTETUR NGA FONDI I VEÇANTË I INICIATIVËS EVROPIANE QENDRORE DHE ME AKSIONAR BERZH-in

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit për asistencë teknike për rrjetin hekurudhor në Shqipëri – rehabilitimin e linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimin e lidhjes hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), Hekurudhës Shqiptare (entiteti i projektit) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të mbështetur nga fondi i veçantë i iniciativës evropiane qendrore dhe me aksionar BERZH-in, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

Marrëveshje Granti nr. 900\48466

MARRËVESHJE GRANTI

PËR ASISTENCË TEKNIKE PËR RRJETIN HEKURUDHOR NË SHQIPËRI – REHABILITIMIN E LINJËS HEKURUDHORE TIRANË–DURRËS DHE NDËRTIMIN E LIDHJES HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (MARRËSI) DHE HEKURUDHËS SHQIPTARE (ENTITETI I PROJEKTIT), DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, TË MBËSHTETUR NGA NISMA E EVROPËS QENDRORE DHE FONDI I VEÇANTË I AKSIONARËVE TË BERZH-it

Datë 20 janar 2021

**TABELA E PËRMBAJTJES
NENI I – PËRKUFIZIMET DHE
INTERPRETIMI**

Seksioni 1.01 Përkufizimet

Seksioni 1.02 Interpretimi

NENI II – FINANCIMI I GRANTIT

Seksioni 2.01 Shuma dhe qëllimi

Seksioni 2.02 Pagesat

Seksioni 2.03 Taksat dhe detyrimet

NENI III – KUSHTET PARAPRAKE

Seksioni 3.01 Pagesa e parë e Grantit

Seksioni 3.02 Të gjitha pagesat e Grantit

NENI IV – DËTYRIMET E PALËVE

Seksioni 4.01 Kryerja e punës dhe veprimtaritë

Seksioni 4.02 Përdorimi i Grantit

Seksioni 4.03 Marrëveshja e Huas

Seksioni 4.04 Prokurimi

Seksioni 4.05 Kontratat

Seksioni 4.06 Siguracioni

Seksioni 4.07 Të dhënat financiare dhe raportet

Seksioni 4.08 Dhënia e informacionit

Seksioni 4.09 Mashtrimi dhe korrupsioni

Seksioni 4.10 Vizibiliteti

Seksioni 4.11 Inspektimi dhe audit

**NENI V – PËRFAQËSIMET DHE
GARANCITË**

Seksioni 5.01 Përfaqësimet

Seksioni 5.02 Njohja/pranimi dhe përsëritja



NENI VI – PEZULLIMI DHE ANULIMI

Seksioni 6.01 Anulimi nga marrësi

Seksioni 6.02 Pezullimi ose anulimi i pagesave

Seksioni 6.03 Raste rimbursimi

NENI VII – TË NDRYSHME

Seksioni 7.01 Afati dhe përfundimi

Seksioni 7.02 Vazhdimësia

Seksioni 7.03 Marrëveshja e plotë; ndryshimet dhe heqja dorë

Seksioni 7.04 Njoftimet

Për entin zbatues të projektit

Seksioni 7.05 Gjuha angleze

Seksioni 7.06 Të drejtat, mjetet juridike dhe heqja dorë

Seksioni 7.07 Përgjegjësia dhe dëmshpërblimi

Seksioni 7.08 Ligji zbatues

Seksioni 7.09 Arbitrazhi dhe juridiksioni

Seksioni 7.10 Pasuesit dhe drejtëmarrësit; të drejtat e palëve të treta

Seksioni 7.11 Nxjerrja e informacionit

Seksioni 7.12 Kopjet origjinale

MODELI A: FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË

MODELI B: FORMATI I LETRËS PËR EMËRIMIN E NËNSHKRUESVE TË AUTORIZUAR

SHTOJCË 1: ZËRAT E FINANCUAR NGA GRANTI

SHTOJCË 2: PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

MARRËVESHJE GRANTI NR. [Numri i kontratës]

Kjo Marrëveshje Granti (kjo “Marrëveshje”) në datën 20 janar 2021 lidhet ndërmjet:

1. Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një institucion financiar ndërkombëtar i krijuar në përputhje me Marrëveshjen që themelon Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një traktat shumëpalësh i nënshkruar në Paris, më 29 maj 1990, me seli qendrore në *One Exchange Square, London EC2A 2JN, United Kingdom* (Mbretëria e Bashkuar) (BERZH); dhe

2. Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë, Shqipëri (Marrësi);

3. Hekurudha Shqiptare, një shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas legjislacionit

Shqiptar (“Entiteti i Projektit” dhe së bashku me BERZH-in dhe Marrësin “Palët”).

Duke marrë parasysh se:

A. Më 29 dhjetor 2016, BERZH-i (në cilësinë e tij si huadhënës) ka lidhur një marrëveshje huaje (Marrëveshja e Huas) me Marrësin (në cilësinë e tij si huamarrës), në zbatim të së cilës BERZH-i ka rënë dakord që të japë një hua prej 36,870,000.00 eurosh për të financuar një pjesë të rehabilitimit të hekurudhës Tiranë–Durrës, duke përfshirë ndërtimin e një linje për të lidhur Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (Projekti). Marrësi i ka kërkuar BERZH-it që të financojë disa aktivitete për asistencë teknike për të mbështetur Projektin.

B. Në zbatim të nenit 18 të Marrëveshjes që themelon Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, BERZH-i ka krijuar fondin e veçantë të aksionarëve të BERZH-it (Fondi) të cilin e menaxhon dhe e administron ai. Gjithashtu, Nisma e Evropës Qendrore i ka siguruar financim BERZH-it (Fondi dhe Nisma e Evropës Qendrore, ku secili referohet si “Donator” dhe së bashku “Donatorët”).

C. BERZH-i ka rënë dakord të ofrojë një grant në një shumë prej 565,000.00 eurosh (që përbëhet nga deri në 65,000.00 euro nga Fondi dhe deri në 500,000.00 euro nga Nisma e Evropës Qendrore), me termat dhe kushtet e përcaktuar në këtë Marrëveshje, për prokurimin e shërbimeve të caktuara të konsulencës, siç janë përshkruar në shtojcën 2 (Përshkrimi i projektit) në këtë dokument.

D. Marrësi ka rënë dakord që Enti Zbatues i Projektit do të zgjedhë dhe do të angazhojë çdo konsulent, duke lidhur kontrata në zbatim të të cilave çdo konsulent do të ofrojë asistencë teknike të caktuar për Marrësin/Entin Zbatues të Projektit.

Nëpërmjet këtij dokumenti Palët bien dakord sa më poshtë.

Neni I

Përkufizimet dhe interpretimi**Seksioni 1.01 Përkufizimet**

a) Me përjashtim të përcaktimeve në paragrafin “b” më poshtë, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa të mëdha të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.



b) Sa herë që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë listimet, modelet dhe shtojcat), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa të mëdha do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Ditë pune” nënkupton një ditë (përveç të shtunës apo së dielës) në të cilën bankat tregtare janë të hapura për ditë pune të zakonshme në Londër, Angli.

“Konsulent” nënkupton çdo konsulent me pozitë dhe reputacion të mirë që do të angazhohet nga Enti Zbatues i Projektit, i cili do të kryejë Shërbime Konsulencë.

“Kontratë Konsulencë” nënkupton çdo marrëveshje që do të lidhet ndërmjet Entit Zbatues të Projektit dhe Konsulentit përkatës, për realizimin e Shërbimeve të Konsulencës.

“Shërbime Konsulencë” nënkupton shërbimet që do të ofrohen nga çdo Konsulent, në lidhje

me Projektin, siç përshkruhet më tej në Përshkrimin e Projektit në shtojcën 2.

“Donator/ët” ka kuptimin e përshkruar në listimin B.

“Politikat dhe Procedurat e Zbatimit” nënkupton Politikat dhe Procedurat e Zbatimit të BERZH-it, të datës 4 tetor 2017, të cilat mund të gjenden

në: <http://www.ebrd.com/news/publications/policy/enforcement-policy-and-procedures.html>, siç ndryshohen herë pas here, dhe çdo politikë apo procedurë të përshtatur nga BERZH-i si pasues apo zëvendësues i këtyre politikave apo i procedurave.

“Fond” ka kuptimin e përshkruar në listimin B.

“Zërat e Financuar nga Granti” nënkupton shërbimet e konsulencës të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen tërësisht nga Granti, siç përshkruhen më tej në shtojcën 1 (Zërat e financuar nga Granti).

“Grant” ka kuptimin e përshkruar në seksionin 2.01(a) (Shuma dhe Qëllimi).

“Marrëveshje e Huasë” ka kuptimin e përshkruar në listimin A.

“Hua” nënkupton financimin e kryer apo që do të mundësohet nga BERZH-i për Marrësin në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huasë.

“Pagesë” nënkupton disbursimin e çdo pjese të Grantit, herë pas here, në përputhje me seksionin 3.02 (Pagesat).

“Kërkesë për Pagesë” nënkupton një Kërkesë për Pagesë, në formatin e modelit A (Formati i

Kërkesës për Pagesë) dhe kryesisht të pranueshme për BERZH-in, që i dorëzohet BERZH-it, në përputhje me seksionin 2.02(a) (Pagesat e Grantit).

“Rregullat dhe Politikat e Prokurimit” nënkupton rregullat e prokurimit të BERZH-it për veprimtarinë e sektorit publik, siç ndryshohen herë pas here.

“Praktika të ndaluara” nënkupton një Praktikë Detyruese, Praktikë me Marrëveshje të Fshtetë, Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Keqpërdorim i Burimeve Bankare apo i Aseteve Bankare, Praktikë që sjell Pengesë apo Vjedhje, ku secili prej këtyre kushteve është përcaktuar në Politikat dhe Procedurat e Zbatimit që janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

“Projekt” ka kuptimin e përshkruar në listimin A.

“Rast Rimbursimi” nënkupton ndonjë nga rastet apo ngjarjet e specifikuar në seksionin 6.03 (Rastet e rimbursimit).

“Hakmarrje” nënkupton çdo veprim të dëmshëm të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të rekomanduar, të mundshëm apo të ndërmarrë.

“Taksë” nënkupton çdo taks, tarifë për të drejtën e autorit, vula apo detyrime të tjetra, vlerësime, taksa, detyrime, tatim mbi vlerën e shtuar apo tatim i çfarëdo natyre (duke përfshirë çdo penalitet apo interes në lidhje me to) i vendosur sipas ndonjë ligji.

Seksioni 1.02 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

a) Fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe;

b) Titujt e tabelës së përmbajtjes janë vendosur vetëm për lehtësi reference dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

c) Fjalët që tregojnë persona përfshijnë korporata, partneritete dhe persona të tjerë juridikë dhe referencat për një person përfshijnë pasuesit e tij dhe tagrat e autorizuara;

d) Një referencë për një nen, seksion, shtojcë apo model do të interpretohet si referencë për atë nen apo seksion, shtojcë apo model të specifikuar në këtë Marrëveshje;

e) Çdo referencë në “legjislacion” do të thotë çdo ligj (duke përfshirë çdo ligj të përgjithshëm apo



të posaçëm) dhe çdo traktat, kushtetutë, statut, legjislacion, dekret, akt normativ, rregull, rregullore, gjykim, urdhër, urdhër gjyqësor, vendim gjyqësor, përcaktim, vendim gjyqi apo masë tjetër legjislative apo administrative, ose vendim gjyqësor apo arbitrazhi në çdo juridiksion që ka të drejtën ligjore apo përputhshmërinë me të cilin është në përputhje me praktikën e përgjithshme në këtë juridiksion.

f) Çdo referencë për një dispozitë ligji është një referencë për atë dispozitë, siç ndryshohet apo rimiratohet herë pas here; dhe

g) “Kontroll” (duke përfshirë, me kuptime korrelative, termat “të kontrolluar nga” dhe “nën kontroll të përbashkët me”), kur përdoren në lidhje me ndonjë person, nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të fuqisë për të drejtuar apo për të mundësuar drejtimin e menaxhimit dhe politikave të një personi të tillë, qoftë nëpërmjet pronësisë së aksioneve me të drejtë vote, kontratë apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni II

Financimi i Grantit

Seksioni 2.01 Shuma dhe qëllimi

a) Në bazë të dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, BERZH-i bie dakord që t'i ofrojë Marrësit,

i. nga burimet e Fondit, një grant në shumën totale prej 65,000.00 eurosh; dhe

ii. nga burimet e Nismës së Evropës Qendrore një grant në shumën totale prej 500,000.00 eurosh, në shumën totale prej 565,000.00 eurosh (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) (Granti).

b) Granti do të përdoret vetëm për qëllimet e financimit të Zërave të Financuar nga Granti.

c) Në parashikimet e seksionit 6.03(b) (Rastet e Rimbursimit), Granti nuk është i rimbursueshëm.

d) Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit shprehimisht pranojnë dhe bien dakord që BERZH-i nuk do të jetë i detyruar të kryejë ndonjë pagesë apo ndonjë pagesë tjetër në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, përveç në masën që fondet e mjaftueshme janë të disponueshme në Fond/nga Nisma e Evropës Qendrore për një qëllim të tillë.

Seksioni 2.02 Disbursimi i Grantit

a) Sipas parashikimeve të seksionit 6.02 (Pezullimi ose anulimi i pagesave) dhe të nenit III (Kushtet e pagesave), BERZH-i do të disbursojë Grantin herë pas here, në çfarëdo dite pune, në një

ose më shumë pagesa, me marrjen e kërkesës nga Ent Zbatues i Projektit. Çdo Kërkesë për Pagesë, e shoqëruar me dokumentet mbështetëse korresponduese, do të dorëzohet elektronikisht në format PDF, në adresën *email*-it të Departamentit për Operacionet e Financuara nga donatorët të Bankës, si vijon: DonorInvoices@ebrd.com (nëse tek Enti Zbatues i Projektit nuk është dhënë shprehimisht një adresë tjetër *email*-i, duke dërguar një kopje të Marrësi nga Banka). Çdo dokument mbështetës që nuk është në gjuhën angleze do të shoqërohet me përkthimin në gjuhën angleze, në përputhje me seksionin 7.05 (*Gjuha angleze*) të kësaj Marrëveshjeje. Enti Zbatues i Projektit do të sigurojë që çdo Kërkesë për Pagesë të merret nga Banka në adresën referuese të e-mailit të përmendur më lart, të paktën 10 ditë pune para datës së propozuar për një pagesë të tillë. Nëse BERZH nuk bie dakord ndryshe, një Kërkesë për Pagesë do të jetë e parevokueshme dhe detyruese për Entin Zbatues të Projektit.

b) Nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga BERZH-i, Enti Zbatues i Projektit nuk do të kërkojë një pagesë pas 3 viteve, nga data kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe çdo pjesë e padisbursuar e Grantit do të anulohet automatikisht në ditën në vijim.

c) Përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe me shkrim, pagesat do të bëhen vetëm për të financuar shpenzime të kryera (ose, nëse Palët bien dakord, shpenzime që do të bëhen), në lidhje me kosto të arsyeshme të Zërave të Financuar nga Granti.

d) Pagesat do të bëhen në euro.

e) Pagesat (përveç shumës së plotë të padisbursuar të Grantit) do të bëhen në suma jo më pak se 10,000.00 euro dhe jo më shumë se një herë në muaj.

Seksioni 2.03 Pagesat

a) Përveç nëse është rënë dakord ndryshe nga BERZH-i, shumat që do të disbursohen nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguheshin drejtpërdrejt në llogarinë e Konsulentit përkatës, siç përcaktohet në faturën përkatëse. BERZH-i do të kryejë pagesa vetëm nëpërmjet pagesave elektronike në një llogari bankare në emër të Konsulentit dhe në Shtetin e vendbanimit të Konsulentit.

b) Nëse data e caktuar për të kryer ndonjë pagesë, sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë një ditë



e cila nuk është ditë pune, kjo pagesë do të paguhet në ditën e ardhshme të punës.

c) Çdo shumë që duhet t'i paguhet BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të paguhet pa pretendime apo kundërkërkesa, në fonde menjëherë të disponueshme në euro, për vlerën në datën e caktuar, në një llogari që BERZH-i mund të caktojë herë pas here, duke njoftuar Marrësin dhe Entin e Zbatimit të Projektit. Të gjitha pagesat për BERZH-in, sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen të lira dhe pa zbritje apo mbajtje për llogari të ndonjë tatimi, detyrimi, tarife apo takse të çfarëdo natyre.

Seksioni 2.04 Taksat dhe Detyrimet

a) Marrësi apo enti zbatues i projektit, sipas rastit, duhet të paguajnë, në momentin e duhur, të gjitha taksat që i janë ngarkuar dhe janë të pagueshme apo që janë në lidhje me ekzekutimin, lëshimin, dorëzimin, regjistrimin apo noterizimin e kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë dokumenti tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

b) Marrësi apo Enti Zbatues i Projektit pranojnë dhe janë dakord që asnjë pjesë e të ardhurave të Grantit nuk do të përdoret, drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, për të paguar ndonjë Taksë, direkt apo indirekt, në Shqipëri apo diku tjetër.

c) Nëse në lidhje me një Kontratë Konsulence ngarkohet ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në):

i. Enti Zbatues i Projektit do të njoftojë BERZH-in sa më shpejt që të jetë e mundur;

ii. Enti Zbatues i Projektit do të paguajë drejtpërdrejt te Konsulenti një shumë të barabartë me çdo taksë të tillë indirekt (duke përfshirë TVSH-në); dhe

iii. në çdo Kërkesë për Pagesë, Enti Zbatues i Projektit do të vërtetojë që ai ka paguar një shumë të barabartë me një taksë të tillë indirekte, në çdo faturë të mëparshme të Konsulentit dhe do të marrë përsipër të paguajë taksën indirekt (duke përfshirë TVSH-në) në faturën aktuale.

Neni III

Kushtet paraprake

Seksioni 3.01 Pagesa e parë e Grantit

Detyrimi i BERZH-it për të kryer pagesën e parë të Grantit do t'i nënshtrohet përmbushjes paraprake, në formë dhe në thelb të pranueshme

për BERZH-in ose të heqjes dorë të kushteve paraprake të mëposhtme:

a) BERZH-i duhet të ketë marrë një kopje origjinale të nënshkruar në mënyrë të rregullt kësaj Marrëveshjeje;

b) janë përmbushur, në formë dhe thelb të pranueshme për BERZH-in, të gjitha kushtet paraprake të disbursimit të parë të Huas, sipas Marrëveshjes së Huas;

c) BERZH-i do të ketë marrë një plan të detajuar prokurimi dhe planin e pagesave për prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti;

d) BERZH-i do të ketë marrë një vërtetim për pozicionin e punës dhe për autoritetin, kryesisht sipas formatit në modelin B (*Formati i Letrës që Përvakton Nënshkruesit e Autorizuar*).

Seksioni 3.02 Të gjitha pagesat e Grantit

Detyrimi i BERZH-it për të kryer ndonjë pagesë të Grantit do të jetë, gjithashtu, në varësi të përmbushjes, në formë dhe thelb të pranueshme për BERZH-in ose të heqjes dorë prej kushteve, që në datën e kërkesës për një pagesë të tillë nga Enti Zbatues i Projektit dhe në datën e një pagese të tillë:

a) Marrëveshja e Huas do të jetë në fuqi të plotë dhe Marrësi (kur është e zbatueshme dhe Enti Zbatues i Projektit) do të jetë në përputhje me të gjitha detyrimet e tij në cilësinë e huamarrësit, sipas Marrëveshjes së Huas.

b) përfaqësimet dhe garancitë e bëra apo të konfirmuara nga Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit, sipas rastit, në këtë Marrëveshje do të jenë të vërteta në atë datë dhe prej asaj date, me të njëjtin efekt sikur këto përfaqësime dhe garanci të ishin bërë në atë datë dhe prej asaj date.

c) nuk ka ndodhur dhe nuk është në vazhdim asnjë nga rastet e përshkruara në seksionin 6.02(a) (Pezullimi ose anulimi i pagesave);

d) nuk duhet të ketë ndodhur asgjë, e cila sipas opinionit të arsyeshëm të BERZH-it, mund të ketë një efekt negativ material për Marrësin, Entin e Zbatimit të Projektit apo Projektin;

e) BERZH-i do të ketë marrë në kohë Kërkesën për Pagesë të Entit të Zbatimit të Projektit;

f) BERZH-i do të ketë marrë një kopje të vërtetuar të çdo Kontrate Konsulence të nënshkruar dhe çdo faturë në lidhje me të cilën kërkohet pagesa;

g) BERZH-i do të ketë marrë konfirmim nga Enti Zbatues i Projektit, që:



i. Shërbimet e Konsulencës janë ofruar në mënyrë të pranueshme apo janë kryer në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe me Kontratën përkatëse të Konsulencës;

ii. secila faturë është e drejtë dhe e saktë dhe korrespondon me shumat e përcaktuara në Kontratën përkatëse të Konsulencës; dhe

h) BERZH-i do të ketë marrë dokumente të tjera, të cilat BERZH-i mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, duke përfshirë: i. evidenca të tilla për sa i përket përdorimit të propozuar të të ardhurave të pagesës; dhe ii. evidenca të tilla të përdorimit të të ardhurave nga çdo pagesë/a e/të mëparshme.

Neni IV

Detyrimet e palëve

Përveç nëse BERZH-i bie dakord ndryshe me shkrim:

Seksioni 4.01 Kryerja e Punës dhe Veprimtaritë

Enti Zbatues i Projektit do të:

a) ruajë funksionimin e korporatës, në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi; dhe

b) kryejë punën dhe veprimtarinë, në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme dhe në përputhje me praktika të mira financiare, teknike dhe tregtare.

Seksioni 4.02 Përdorimi i Grantit

Marrësi nëpërmjet Entit të Zbatimit të Projektit do të përdorë Grantin në mënyrë rigorozë dhe vetëm për të financuar Zërat e Financuar nga Granti.

Seksioni 4.03 Marrëveshja e Huas

Marrësi, në rastet kur është e zbatueshme dhe Enti Zbatues i Projektit, në rastet kur është e zbatueshme, do:

a) t'i pëmbahet në çdo kohë detyrimeve në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas;

b) të sigurojë që çdo pjesë e Projektit e financuar nga Granti të kryhet në përputhje me detyrimet mjedisore dhe sociale të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas;

c) të sigurojë që Plani i Zbatimit të Projektit, i dorëzuar te dhe i miratuar nga BERZH-i, në zbatim të Marrëveshjes së Huas, përfshin Zërat e Financuar nga Granti dhe Kontratat e Konsulencës;

d) të sigurojë që aktivitetet dhe përgjegjësitë e njësisë së zbatimit të projektit (NJZP) përfshijnë

prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti dhe zbatimin e Financimit të Grantit;

e) të marrë dhe të mbajë efektive (ose kur është e përshtatshme do të rinovojë) të gjitha autorizimet që kërkojnë në zbatim të Marrëveshjes së Huas apo ndryshe për Projektin dhe do të kryejë dhe do të monitorojë të gjitha kushtet dhe kufizimet që përbahen në to apo që janë vendosur mbi Marrësin nga Autorizime të tilla.

Seksioni 4.04 Prokurimi

a) Enti Zbatues i Projektit do të sigurojë që çdo Zë i Financuar nga Granti prokurohet në përputhje me Politikën dhe Rregullat e Prokurimit.

b) Çdo Kontratë Konsulente do t'u nënshtrohet procedurave të rishikimit të përcaktuara në Politikën dhe Rregullat e Prokurimit dhe të rishikuara paraprakisht nga BERZH-i.

c) Nëse, në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, BERZH-i përcakton që Marrësi, Enti Zbatues i Projektit, një furnitor, një nënfurnitor, një kontraktor, një nënkontraktor, një koncesionar, një konsulent apo një nënkonsulent që konkurron për apo në ekzekutimin e ndonjë kontrate, në lidhje me Projektin apo çdo transaksion të parashikuar në të, është angazhuar në ndonjë Praktikë të Ndalar, BERZH-i mund ta shpallë një kontratë apo transaksion të tillë si të papërshtatshëm për financim dhe BERZH-i mund të marrë çdo Masë Zbatuese dhe Nxjerrje Informacioni (sipas kushteve që janë përcaktuar në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit).

d) Enti Zbatues i Projektit, në dokumentet e tenderit dhe në çdo kontratë në lidhje me Projektin apo çdo transaksion të përshkruar në të, do të përfshijë dispozita:

i. që deklarojnë se furnitorët, nënfurnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët nuk do të autorizojnë apo lejojnë cilindo nga zyrtarët, drejtuesit, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët, agjentët apo përfaqësuesit e tyre, të angazhohen në ndonjë Praktikë të Ndalar, në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar në të; dhe

ii. që njoftojnë furnitorët, nënfurnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët, që BERZH-i ka të drejtën të përdorë Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, duke përfshirë çdo Masë Zbatuese dhe Nxjerrje Informacioni, në lidhje me pretendimet e



Praktikave të Ndaluara, në lidhje me Projektin ose transaksionet e parashikuara në të.

Seksioni 4.05 Kontratat

a) Enti Zbatues i Projektit:

i. do të garantojë që të gjitha Kontratat e Konsulencës përfshijnë dispozita të pranueshme për BERZH-in, ku kërkohet që asnjë Konsulent nuk do të përfshihet në Praktika të Ndaluara apo Hakmarrëse;

ii. do t'i ofrojë BERZH-it një kopje të vërtetuar të të gjitha Kontratave të Konsulencës të nënshkruara, jo më vonë se dhjetë ditë pas datës së lidhjes së Kontratës.

b) Enti Zbatues i Projektit nuk do të bëjë asnjë ndryshim material (duke përfshirë çdo vendim në lidhje me përcaktimin e detyrave apo nënkontraktimin) në një Kontratë Konsulente pa miratim paraprak me shkrim të BERZH-it (miratim i cili nuk do të tërhiqet në mënyrë të paarsyeshme). Në çdo rast, Enti Zbatues i Projektit do të njoftojë BERZH-in për të gjitha ndryshimet materiale në çdo Kontratë Konsulente.

Seksioni 4.06 Siguracioni

Enti Zbatues i Projektit do të mbajë sigurim të mjaftueshëm, në raport me praktikat e mira financiare, teknike dhe tregtare në Shqipëri.

Seksioni 4.07 Të dhënat Financiare dhe Raportet

Marrësi, nëpërmjet Entit Zbatues të Projektit, do të:

a) mbajë libra të veçantë llogarie dhe të dhëna të tjera në lidhje me Grantin, në përputhje me standardet e pranueshme të kontabilitetit për BERZH-in dhe që zbatohen në vazhdimësi;

b) sigurojë që autorizimi, i cili u është dhënë Audituesve për të komunikuar drejtpërdrejt me BERZH-in, në përputhje me Marrëveshjen e Huas, shtrihet në informacionin e kërkuar nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me Grantin; dhe

c) ruajë të dhënat dhe dokumentet financiare të kontabilitetit, në lidhje me aktivitetet e financuara nga Granti, për të paktën 5 vjet nga data e përfundimit apo e mbarimit të Kontratës përkatëse të Konsulencës.

Seksioni 4.08 Dhënia e informacionit

a) Marrësi pranon që, në përputhje me Marrëveshjen e Huas, me marrjen e informacionit në cilësinë e tij si huadhënëse, BERZH-i mund të përdorë dhe të mbështetet në këtë informacion në

cilësinë e tij si ofruesi i Grantit, sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në masën që ky informacion nuk i është dhënë BERZH-it në zbatim të Marrëveshjes së Huas, Enti Zbatues i Projektit do t'i japë BERZH-it informacion në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për BERZH-in:

i. informacion të detajuar në lidhje me prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti, Kontratat e Konsulencës, Konsulentët dhe përdorimin e Grantit;

ii. informacion të mjaftueshëm për t'i mundësuar BERZH-it të gjurmtojë përdorimin e Grantit (si të ndarë nga Huaja); dhe

iii. informacione të tjera në lidhje me Marrësin, Entin Zbatues të Projektit, Projektin dhe transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje që mund të kërkojë BERZH-i herë pas here, në mënyrë të arsyeshme.

c) Sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast, brenda 30 ditëve pas përfundimit apo mbarimit të çdo Kontrate Konsulente, Enti Zbatues i Projektit do t'i dorëzojë BERZH-it një raport përfundimtar, në lidhje me përdorimin e Grantit.

d) Sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast, brenda 30 ditëve pas përfundimit të Projektit, Enti Zbatues i Projektit do t'i dorëzojë BERZH-it një raport përfundimtar, në lidhje me Projektin, duke identifikuar përdorimin e Grantit.

e) Me marrjen e një kërkesë, Enti Zbatues i Projektit do t'i sigurojë menjëherë BERZH-it prova të pranueshme që Zërat e Financuar nga Granti janë mbuluar me siguracion në nivel të mjaftueshëm.

f) Menjëherë pasi ndodh një rast i përshkruar në seksionin 6.02(a) (Pezullimi ose anulimi i pagesave), Marrësi, nëpërmjet Entit Zbatues të Projektit, do të njoftojë BERZH-in, në lidhje me të, duke specifikuar natyrën e një rasti të tillë dhe çdo masë që po ndërmerret Marrësi për të korrigjuar atë.

g) Marrësi ose Enti Zbatues i Projektit do të njoftojnë menjëherë BERZH-in nëse Marrësi apo Enti Zbatues i Projektit merr ndonjë informacion, në lidhje me një shkelje të seksionit 4.09 (Mashtrimi dhe Korrupsioni) apo seksionit 5.01(b) (Përfaqësimet) apo nëse ndonjë institucion financiar ndërkombëtar ka vendosur ndonjë sanksion mbi Marrësin apo Entin Zbatues të Projektit për ndonjë Praktikë të Ndalar. Nëse



BERZH-i njofton Marrësin dhe/ose Entin Zbatues të Projektit për shqetësimin e tij që ka pasur një shkelje të seksioneve 4.09 apo 5.01(b), Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit do të bashkëpunojnë me mirëbesim me BERZH-in dhe me përfaqësuesit për të përcaktuar nëse ka ndodhur një shkelje e tillë.

h) Enti Zbatues i Projektit do të njoftojë menjëherë BERZH-in për pezullimin apo ndërprerjen apo për çdo rast që mund të rezultojë në pezullim apo ndërprerje të Kontratës së Konsulencës.

i) Enti Zbatues i Projektit do t'i japë menjëherë BERZH-it çdo informacion të tillë shtesë që BERZH-i apo secili prej Donatorëve mund të kërkojë herë pas here, në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 4.09 Mashtrimi dhe Korrupsioni

Në çdo rast, as Marrësi dhe as Entiteti Zbatues i Projektit nuk do të autorizojnë apo lejojnë, ndonjë nga zyrtarët, drejtuesit, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët, agjentët apo përfaqësuesit, apo ndonjë Konsulent që të përfshihen në ndonjë Praktikë të Ndalar apo Hakmarrëse, në lidhje me Projektin, Grantin apo çdo transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje.

Seksioni 4.10 Vizibiliteti

a) Marrësi, nëpërmjet Entit Zbatues të Projektit, do të marrë masat e duhura për të reklamuar në publikime, komunikime përkatëse, si edhe në media, faktin që projekti ka marrë financim, ndër të tjerë, dhe nga Donatorët.

b) Emri, akronimi dhe logoja e BERZH-it, si edhe emrat, akronimet dhe logot (nëse ka) të Donatorëve të tjerë janë marka shërbimi të regjistruara, të cilat Marrësi nuk do t'i riprodhojë pa leje të shprehur me shkrim nga BERZH-i.

Seksioni 4.11 Inspektimi dhe Auditimi

Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit do t'i mundësojnë BERZH-it, Donatorëve dhe përfaqësuesve të autorizuar të tyre, me kërkesë të BERZH-it:

i. të vizitojnë çdo strukturë dhe vendndodhje punimesh, në lidhje me Projektin;

ii. të inspektojnë llogaritë dhe të dhënat e tyre, në lidhje me Projektin, performancën e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose Kontratat e Konsulencës;

iii. të auditojnë këto llogari me auditues të emëruar nga BERZH-i; dhe

iv. për këto qëllime, të takohen dhe të diskutojnë me përfaqësues dhe punonjës të tillë të

Marrësit dhe të Entit Zbatues të Projektit, siç BERZH-i mund ta çmojë të nevojshme dhe të përshtatshme.

Neni 5

Përfaqësimet dhe garancitë

Seksioni 5.01 Përfaqësimet

a) Nëse nga Marrësi, në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas, janë lëshuar përfaqësime dhe garanci, ato përsëriten nga Marrësi, sikur të ishin pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje, sikur referimet për "Huamarrësin" të lexoheshin si referime për "Marrësin" dhe në termin "Marrëveshje Financimi" është përcaktuar për t'u përfshirë kjo Marrëveshje.

b) Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit më tej garantojnë dhe përfaqësojnë që as Marrësi, as Enti Zbatues i Projektit dhe as ndonjë zyrtar, drejtues, punonjës i autorizuar, bashkëpunëtor, agjent apo përfaqësues i Marrësit apo i Entit Zbatues të Projektit nuk ka kryer apo nuk është përfshirë në ndonjë Praktikë të Ndalar ose Hakmarrëse, në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo marrëveshje.

Seksioni 5.02 Njohja/Pranimi dhe Përsëritja

a) Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit pranojnë që ata kanë kryer dhe përsëritur përfaqësimet dhe garancitë në seksionin 5.01 (Përfaqësimet), me synimin për të nxitur BERZH-in të lidhë këtë Marrëveshje dhe të sigurojnë Grantin, dhe se BERZH-i ka lidhur këtë Marrëveshje duke u bazuar dhe në mbështetje të plotë të secilit përfaqësim dhe garancie të tillë. Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit garantojnë që ata nuk kanë asnjë njohuri për ndonjë fakt ose çështje shtesë, mungesa e të cilëve bën mashtruese ndonjë prej këtyre përfaqësimeve dhe garancive.

b) Përfaqësimet dhe garancitë e dhëna në seksionin 5.01 (Përfaqësimet) do të konsiderohen se përsëriten me dorëzimin e secilës Kërkesë për Pagesë dhe në secilën datë të pagesës, me përjashtim të çdo përfaqësimi apo garancie që specifikohet se bëhet "nga data e kësaj Marrëveshjeje".



Neni VI Pezullimi dhe anulimi

Seksioni 6.01 Anulimi nga Marrësi

Marrësi, në çdo kohë, duke i dhënë njoftim me shkrim BERZH-it, jo më pak se 40 ditë para, mund të anulojë tërësisht ose pjesërisht çdo pjesë të padisbursuar të Grantit, duke parashikuar se BERZH-i është i kënaqur që do të mbetet i disponueshëm financimi i nevojshëm për të mundësuar Marrësin të përfundojë Projektin, në përputhje me Planin e Zbatimit të Projektit. Çdo njoftim anulimi nga Marrësi do të jetë i parevokueshëm dhe detyrues dhe shumat e Grantit të anuluar nga Marrësi nuk mund të rikthehen në gjendjen e mëparshme.

Seksioni 6.02 Pezullimi ose anulimi i pagesave

a) BERZH-i, duke njoftuar me shkrim Marrësin dhe Entin Zbatues të Projektit, mund të pezullojë ose të anulojë të drejtën e Entit Zbatues të Projektit për të kërkuar një pjesë ose të gjithë pjesën e padisbursuar të Grantit, nëse ka ndodhur dhe po vazhdon ndonjë nga rastet e mëposhtme:

i. BERZH-i ka pezulluar disbursimet ose ka anuluar të gjithë apo një pjesë të Huas ose BERZH-i ka të drejtën të pezullojë disbursimet apo të anulojë të gjithë ose një pjesë të Huas në përputhje me Marrëveshjen e Huas;

ii. Marrësi, në cilësinë e tij si huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas, ka anuluar një pjesë apo të gjithë pjesën e padisbursuar të Huas;

iii. Marrëveshja e Huas apo Marrëveshja e Projektit nuk është më në fuqi dhe efektive apo ka përfunduar;

iv. Marrësi apo Enti Zbatues i Projektit, sipas rastit, nuk përmbush ndonjë prej detyrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje apo Marrëveshjes së Huas;

v. ka ndodhur dhe po vazhdon të ndodhë ndonjë rast i përshkruar në seksionin 4.01 (Pezullimi) të Marrëveshjes së Huas dhe BERZH-i ka deklaruar se e gjithë ose një pjesë të Huas është e kërkueshme dhe e pagueshme;

vi. është kërkuar financim alternativ për projektin që sjell financim të dyfishtë (qoftë tërësisht apo pjesërisht);

vii. është apo është bërë e paligjshme në ndonjë juridiksion për BERZH-in që të bëjë, mbajë apo financojë Financimin e Grantit apo që të

përmbushë ndonjë prej detyrimeve të tij, sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Me nxjerrjen e një njoftimi për pezullim nga BERZH-i, në zbatim të paragrafit “a” më lart, e drejta e Entit Zbatues të Projektit për të kërkuar pagesa të mëtejshme do të pezullohet apo anulohet, siç shpjegohet në njoftim. E drejta e BERZH-it për pezullim nuk do të përjashtojë BERZH-in nga ushtrimi i së drejtës së tij për të anuluar, sipas parashikimit në këtë seksion, për të njëjtën arsye ose për ndonjë arsye tjetër dhe nuk do të kufizojë ndonjë të drejtë tjetër të BERZH-it në këtë Marrëveshje, në Marrëveshjen e Huas apo në ndonjë Marrëveshje tjetër Financimi që ka lidhje me Projektin.

Seksioni 6.03 Raste rimbursimi

a) Secili nga rastet dhe ngjarjet e mëposhtme do të përbëjë një Rast Rimbursimi, sipas kësaj Marrëveshjeje: ka ndodhur dhe po vazhdon ndonjë nga rastet e përshkruara në seksionin 6.02(a) (Pezullimi ose anulimi i pagesave) dhe, nëse është bërë i mundur korrigjimi brenda një periudhe 30-ditore, pasi BERZH-i të jetë njoftuar për të;

b) Nëse ndodh dhe po vazhdon një Rast Rimbursimi, BERZH-i, duke njoftuar Marrësin ose Entin Zbatues të Projektit, mund të kërkojë që Marrësi ose Enti Zbatues i Projektit të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Grantit dhe të paguajë çdo shumë tjetër të llogaritur apo të pagueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje. Përveç nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, shumat e kërkuar nga BERZH-i për këtë arsye do të bëhet ose: i. e kërkueshme dhe e pagueshme me kërkesë; ose ii. menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme pa asnjë njoftim tjetër dhe pa asnjë deklaratë, kërkesë apo ankesë të çdo lloji, për të cilat Marrësi heq dorë shprehimisht në këtë mënyrë.

c) Përveç nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, nëse në çdo kohë, në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, BERZH-i përcakton se Marrësi apo Enti Zbatues i Projektit apo një Konsulent është angazhuar në Praktika të Ndaluara apo Hakmarrëse në konkurrencë, për një Kontratë Konsulente apo ekzekutim e saj, BERZH-i, duke njoftuar Marrësin apo Entin Zbatues të Projektit, mund të kërkojë që Marrësi ose Enti Zbatues i Projektit të rimbursojnë të gjithë ose një pjesë të Grantit dhe kjo vlerë do të bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme me kërkesë.



Neni VII Të ndryshme

Seksioni 7.01 Afati dhe Përfundimi

a) Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive në momentin që BERZH-i merr njoftimin me shkrim nga Marrësi, që:

i. kjo Marrëveshje është miratuar, sipas rregullave nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë; dhe

ii. të gjitha procedurat e kërkuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë për këtë Marrëveshje janë efektive dhe të përfunduara.

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në momentin që Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit kanë kryer të gjitha detyrimet e tyre, në përputhje me dispozitat e saj, përveç nëse përfundohet më herët në përputhje me kushtet e saj.

b) BERZH-i, sipas opsionit të tij, mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke i dhënë jo më pak se 40 ditë njoftim me shkrim Marrësit dhe Entit Zbatues të Projektit.

c) Pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me paragrafin “b” më lart, Enti Zbatues i Projektit do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të zvogëluar humbjet dhe për të mbajtur në minimum shpenzimet e mëtejshme, sipas Kontratave të Konsulencës.

Seksioni 7.02 Vazhdimësia

Dëshmipërblimet dhe garancitë e Marrësit dhe të Entit Zbatues të Projektit dhe dispozitat e seksionit 2.03 (Pagesat), seksionit 4.07 (Të dhënat Financiare dhe Raportet), seksionit 4.08 (Dhënia e informacionit), seksionit 4.11 (Inspektimet dhe Auditimi), seksionit 6.03(c) (Rastet e Rimbursimit), ky seksion 7.02 (Vazhdimësia), seksionit 7.05 (Gjuha angleze), seksionit 7.07 (Përgjegjësia dhe Dëshmipërblimi), seksionit 7.08 (Legjislacioni Rregullues) dhe seksionit 7.09 (Arbitrazhi dhe Juridiksioni) do të vazhdojnë edhe pas rimbursimit të Grantit dhe përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.03 Marrëveshja e Plotë; Ndryshimet dhe Heqja Dorë

a) Kjo Marrëveshje dhe dokumentet e referuara në të përbëjnë të gjithë detyrimin e Palëve, në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson çdo shprehje paraprake të qëllimit ose të mirëkuptimit (me gojë ose me shkrim, të shprehur ose të nënkuptuar) në lidhje me këtë transaksion.

b) Çdo ndryshim, në cilindo nga termat ose kushtet e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë këtë seksion 7.03) do të jetë me shkrim dhe i nënshkruar nga të gjitha Palët. Palët me marrëveshje mund ta anulojnë ose ta ndryshojnë këtë Marrëveshje pa miratimin e ndonjë personi që nuk është palë në këtë Marrëveshje.

c) Çdo heqjeje dore prej BERZH-it nga ndonjë prej termave apo kushteve apo miratimi i dhënë nga BERZH-i, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë me shkrim dhe i nënshkruar nga BERZH-i. Në rast se BERZH-i heq dorë prej ndonjë kushti për ndonjë pagesë, Enti Zbatues i Projektit (dhe Marrësi kur është e zbatueshme) duke marrë të ardhurat e kësaj pagese, do të konsiderohet që ka rënë dakord me të gjithë termat dhe kushtet e një heqjeje të tillë dore.

Seksioni 7.04 Njoftimet

a) Çdo komunikim administrativ që do të jepet ose bëhet në bazë të kësaj Marrëveshjeje me BERZH-in ose Marrësin, ose Entin Zbatues të Projektit do të jetë me shkrim dhe mund të bëhet me postë elektronike për Palën marrëse.

b) Çdo njoftim joadministrativ, kërkesë apo komunikim tjetër që do të jepet apo bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje për BERZH-in apo për Marrësin ose për Entin Zbatues të Projektit do të bëhet me shkrim. Me përjashtim të rasteve, kur në këtë Marrëveshje parashikohet ndryshe, njoftimi, aplikimi apo çdo komunikim tjetër do të konsiderohet se është dhënë ose është bërë në mënyrë të rregullt, kur dërgohet dorazi, me postë fizike ose me transmetim me faks, te pala për të cilën kërkohet ose lejohej të dërgohet komunikimi, në adresën e specifikuar të palëve të caktuara më poshtë ose në një adresë tjetër, siç përcaktohet nga pala, duke njoftuar palën tjetër që jep ose bën njoftimin, kërkesën apo komunikim tjetër.

Për Marrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë
Shqipëri
Në vëmendje të: sekretariamin@financa.gov.al

Për BERZH-in:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom
Në vëmendje të: Ilir Basha
Faks: +355 4 2230 580



Për Entin Zbatues të Projektit

Hekurudha Shqiptare sh.a.

Rruga “Egnatia”, lagjja nr. 3

Durrës

Shqipëri

Në vëmendje të: z. Ani Dyrmishi, Administrator

Faks: +355 52 222 037

Seksioni 7.05 Gjuha angleze

Kjo Marrëveshje është përgatitur dhe ekzekutuar në gjuhën angleze. Të gjitha dokumentet që do të sigurohen dhe komunikimet që do të jepen ose bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze ose, nëse janë në një gjuhë tjetër, do të shoqërohen nga një përkthim në gjuhën angleze i vërtetuar nga Marrësi ose Enti Zbatues i Projektit, sipas rastit. Në çdo mosmarrëveshje për gjuhën, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Seksioni 7.06 Të drejtat, mjetet juridike dhe heqja dorë

a) Të drejtat dhe mjetet juridike të BERZH-it në lidhje me çdo keqinterpretim apo shkelje të ndonjë garancie prej Marrësit apo Entit Zbatues të Projektit, nuk do të cenohen nga asnjë hetim prej ose në emër të BERZH-it, në lidhje me çështjet e Marrësit apo të Entit Zbatues të Projektit, nga ekzekutimi ose kryerja e kësaj Marrëveshjeje ose nga ndonjë akt apo veprim tjetër që mund të bëhet nga ose në emër të BERZH-it, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe që mund të cenojnë këto të drejta dhe mjete juridike, me përjashtim të këtij seksioni 7.06.

b) Asnjë mënyrë negocimi apo heqjeje dore nga BERZH-i, në lidhje me ndonjë kusht të pagesës, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të dëmtojë ndonjë të drejtë, fuqi apo mjet juridik të BERZH-it, në lidhje me ndonjë kusht tjetër të pagesave apo të interpretohet si heqje dore prej tyre.

c) Asnjë veprim i BERZH-it, në lidhje me ndonjë pagesë, nuk do të ndikojë apo dëmtojë ndonjë të drejtë, fuqi apo mjet juridik të BERZH-it, në lidhje me ndonjë pagesë tjetër. Pa u kufizuar në sa më lart, e drejta e BERZH-it për të kërkuar përputhshmëri me ndonjë kusht, sipas kësaj Marrëveshjeje, kusht i cili mund të hiqet nga BERZH-i, në lidhje me ndonjë pagesë, rezervohet shprehimisht për qëllimet e çdo pagese pasuese, me përjashtim nëse Marrësi njoftohet nga BERZH-i.

d) Asnjë mënyrë negocimi dhe asnjë vonesë në ushtrimin apo mosveprimin për të ushtruar ndonjë të drejtë, fuqi apo mjet juridik që i takojnë BERZH-it në momentin kur ndodh ndonjë Rast Rimbursimi apo rast tjetër, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të dëmtojë këto të drejta, fuqi apo mjete juridike dhe nuk do të interpretohet si heqje dore prej tyre apo pranim në heshtje i tyre. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, fuqie ose mjeti juridik të tillë nuk mund të përjashtojë një ushtrim tjetër të tyre ose ushtrimin e mëtejshëm të tyre apo ushtrimin e ndonjë të drejte, fuqie apo mjeti juridik tjetër. Asnjë veprim i BERZH-it, në lidhje me Raste Rimbursimi nuk do të ndikojë apo dëmtojë ndonjë të drejtë, fuqi apo mjet juridik të BERZH-it, në lidhje me ndonjë Rast tjetër Rimbursimi apo rast tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

e) Të drejtat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë Marrëveshje janë kumulative dhe jo ekskluzive të ndonjë të drejte tjetër ose mjeti juridik, pavarësisht nëse parashikohet nga ligji në fuqi apo akte të tjera.

Seksioni 7.07 Përgjegjësia dhe Dëmshpërblimi

a) BERZH-i nuk bën asnjë përfaqësim apo garanci dhe nuk merr asnjë përgjegjësi, në lidhje me ndonjë Shërbim Konsulence apo Konsulent. Secila Palë:

i. pranon dhe bie dakord që ajo nuk do të jetë përgjegjëse për palën tjetër për ndonjë përgjegjësi, detyrim, humbje, dëmtim (qoftë direkt, indirekt, financiar, ekonomik apo pasojë, pavarësisht nëse është shkaktuar ose jo nga veprimi me neglizhencë apo mosveprimi i BERZH-it) penalitete, pretendime, veprime, tatime, detyrime, padi, kosto dhe shpenzime (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet për këshillim ligjor apo kosto për hetime), në lidhje me ndonjë Konsulent (duke përfshirë përzgjedhjen, angazhimin apo monitorimin e Konsulentit) apo ndonjë Shërbim Konsulence (duke përfshirë si pasojë nga Marrësi dhe/ose Enti Zbatues i Projektit që përdorin apo mbështeten në shërbimet e një Konsulenti) apo që lindin nga ose në lidhje me një Kontratë Konsulence; dhe

ii. çliron dhe shkarkon Palët e tjera nga çdo dhe të gjitha pretendimet, të drejtat, borxhet, detyrimet, kërkesat dhe veprimet e çfarëdo lloji apo natyre të cilat mund t'i kenë kundër palës tjetër aktualisht



apo në të ardhmen, të cilat lindin nga ose në lidhje me ndonjë veprim apo mosveprim të ndërmarrë apo të bërë (apo që nuk është ndërmarrë apo nuk është bërë) nga ndonjë Konsulent në ofrimin e Shërbimeve të Konsulencës.

b) Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit marrin përsipër që BERZH-i të mos dëmtohet nga ndonjë veprim, padi, pretendim, kërkesë, humbje, detyrim, dëmtim, kosto dhe shpenzime, taksa, përgjegjësi penale dhe përgjegjësi të tjera që i kanë ndodhur dhe/ose i pëson BERZH-i, të cilat lindin nga ose janë në lidhje me zbatimin e Projektit dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, duke parashikuar që Banka nuk do të ketë asnjë të drejtë që të dëmshpërblehet sipas kësaj Marrëveshjeje, për neglizhencë të sjelljes së papërshtatshme.

Seksioni 7.08 Ligji Rregullues

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin anglez. Çdo detyrim jokontraktual që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin anglez.

Seksioni 7.09 Arbitrazhi dhe Juridiksioni

a) Çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim që lind nga ose në lidhje me: i. këtë Marrëveshje; ii. shkelje, përfundim apo pavlefshmëri e saj; ose iii. çdo detyrim jokontraktual që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, do të zgjidhet me arbitrazh, në përputhje me rregulla e arbitrazhit UNCITRAL (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare), në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje (Rregullat UNCITRAL). Do të ketë një arbitër dhe autoriteti emëruar do të jetë LCIA (Gjykata e Londrës e Arbitrazhit Ndërkombëtar). Selia dhe vendi i arbitrazhit do të jetë në Londër, Angli dhe gjatë të gjitha procedurave të arbitrazhit do të përdoret gjuha angleze. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas Ligjit të Arbitrazhit të vitit 1996 ose ndryshe për të apeluar ndonjë vendim arbitrazhi, ose për të kërkuar përcaktimin e një pike paraprake të ligjit nga gjykata e Anglisë. Gjykata e arbitrazhit nuk do të jetë e autorizuar të japë dhe Marrësi dhe Njësia e Projektit bien dakord që ata të mos kërkojnë nga asnjë autoritet gjyqësor, ndonjë masë të përkohshme apo lehtësim paraprak kundër BERZH-it, pavarësisht nga ndonjë dispozitë e Rregullave të UNCITRAL-it. Gjykata e arbitrazhit do të ketë autoritetin të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në çdo procedim, vendim përfundimtar ose vendim tjetër çdo mosmarrëveshje të

mëtejshme të paraqitur siç duhet para saj nga BERZH-i (por jo nga ndonjë palë tjetër) në masën që mosmarrëveshja e tillë lind, kjo Marrëveshje, Marrëveshja e Huas ose ndonjë Marrëveshje tjetër Financimi, por në bazë të sa më lart, asnjë palë tjetër ose mosmarrëveshje nuk do të përfshihen ose nuk do të legjitimohen në procedurat e arbitrazhit. Në çdo procedurë arbitrazhi, certifikata e BERZH-it, për çdo shumë që i takon BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë prova *prima facie* e kësaj shume.

b) Pa cenuar paragrafin “a” më lart, kjo Marrëveshje dhe Marrëveshjet e tjera të Financimit dhe çdo e drejtë e BERZH-it që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo ndonjë Marrëveshje tjetër Financimi, sipas opsionit të BERZH-it, mund të zbatohet nga BERZH-i në gjykata të Shqipërisë ose ndonjë gjykatë tjetër që ka juridiksion. Për përfitim të BERZH-it, Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit, në mënyrë të parevokueshme i nënshtrohen juridiksionit joekskluziv të gjykatave të Anglisë, në lidhje me çdo mosmarrëveshje, konflikt apo pretendim (duke përfshirë në lidhje me ndonjë detyrim jokontraktual), që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë Marrëveshje tjetër Financiare, ose shkelje, përfundim apo pavlefshmëri të tyre apo prej tyre. Asgjë këtui nuk do të ndikojë në të drejtën e BERZH-it për të ndërmarrë veprime apo procese ligjore kundër Marrësit dhe Entit Zbatues të Projektit në ndonjë mënyrë të autorizuar nga ligjet e çdo juridiksioni përkatës. Fillimi i procedurave apo i masave ligjore nga BERZH-i në një apo më shumë juridiksione nuk do të pengojë BERZH-in që të ndërmarrë veprime apo procese ligjore në ndonjë juridiksion tjetër, qoftë njëkohësisht ose jo njëkohësisht. Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit heqin dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo kundërshtim që mund të kenë aktualisht apo në të ardhmen për çfarëdo arsye për vendosjen/përcaktimin e vendit të çfarëdo veprimi apo procesi ligjor dhe çdo pretendim që mund të kenë aktualisht apo në të ardhmen që veprime apo procese të tilla ligjore janë dërguar në një forum të papërshtatshëm.

Seksioni 7.10 Pasuesit dhe drejtëmarrësit; Të drejtat e Palëve të Treta

a) Kjo Marrëveshje do të lidhë ligjërisht dhe do të ndikojë në përfitimin e pasuesve dhe të drejtëmarrësve përkatës të Palëve, përveç që as



Marrësi dhe as Enti Zbatues i Projektit nuk mund të caktojnë ose të transferojnë në mënyrë tjetër të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave ose detyrimeve të tyre, sipas kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të BERZH-it.

b) Me përjashtim të sa parashikohet në paragrafin “a” më lart, asnjë nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me zbatimin e projektit dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje nuk synojnë të zbatohen nga ndonjë palë e tretë dhe dispozitat e Kontratave (Të Drejtat e Palëve të Treta), ligji i vitit 1999, përjashtohen dhe nuk do të zbatohen.

Seksioni 7.11 Nxjerrja e informacionit

a) BERZH-i mund të nxjerrë dokumente, informacione dhe të dhëna të tilla, në lidhje me Marrësin dhe Entin Zbatues të Projektit dhe këtë transaksion (përfshirë kopjet e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo marrëveshje tjetër të parashikuar këtu), siç BERZH-i e çmon të përshtatshme për çdo qëllim, në lidhje me ndonjë mosmarrëveshje që përfshin Marrësin dhe/ose Entin Zbatues të Projektit, me qëllim ruajtjen ose zbatimin e ndonjë prej të drejtave të BERZH-it, sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të parashikuar këtu ose arkëtimin e ndonjë shume që i detyrohet BERZH-it.

b) BERZH-i mund t’u japë Donatorëve dokumente, informacione dhe regjistrime të tilla (duke përfshirë një kopje të kësaj Marrëveshjeje), që u janë dhënë nga Marrësi apo Enti Zbatues i Projektit, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe nga Marrësi (dhe kur është e zbatueshme nga Enti Zbatues i Projektit), në cilësinë e tij si huamarrës, sipas kushteve të Marrëveshjes së Huas, siç BERZH mund ta çmojë të përshtatshme.

c) BERZH-i mund të publikojë një përshkrim të çdo Kontrate Konsulente, duke përfshirë emrin dhe kombësinë e Konsulentit dhe çmimin/vlerën e kontratës.

Seksioni 7.12 Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në tri kopje, një për secilën Palë, secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, siç duhet, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e përcaktuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCVE DHE EKONOMISË

Nga: _____

Emër: ANILA DENAJ

Titulli: MINISTËR I FINANCVE DHE
EKONOMISË

HEKURUDHA SHQIPTARE SI ENTI
ZBATUES I PROJEKTT

Nga: _____

Emër: ANI DYRMISHI

Titulli: HEKURUDHAT SHQIPTARE

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emër: MATTEO CLANGELI

Titulli: DREJTOR I ASOCIUAR,
DREJTUES I ZYRËS SË SHQIPËRISË



MODELI A
FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË

[me letër me kokë të Entit Zbatues të Projektit]

[data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Operacioneve të Financuara nga Donatori (DonorInvoices@ebrd.com)

Për: [përfshini emrin dhe adresën email të OL-së]

Lënda: Marrëveshja e Huas nr. [numri i kontratës]
Kontrata e Konsulencës nr. [numri i referencës]
Kontrata e Konsulencës nr. [numri i referencës]

Kërkesë për pagesë nr. _____¹

I/e nderuar zotëri/zonjë,

1. Ju lutem referojuni marrëveshjes së huas së datës [_____] (Marrëveshja e Grantit) ndërmjet [emri i Marrësit] (Marrësi), [emri i Entit Zbatues të Projektit] (Enti Zbatues i Projektit) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen e Huas do të kenë të njëjtin kuptim edhe këtu.

3. ²Nëpërmjet këtij dokumenti kërkojmë pagesën në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huas:

i. Donatori: []

Monedha e kërkuar: [monedha e Fondit]

Shuma totale (me shifra dhe fjalë): _____

Data e vlerës: [sa më shpejt që të jetë e mundur, në një datë të caktuar nga BERZH-i në diskrecionin e tij, por jo më vonë se] ³ _____ ⁴

ii. Donatori: []

Monedha e kërkuar: [monedha e Llogarisë]

Shuma totale (me shifra dhe fjalë): _____

Data e vlerës: [sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se] _____

4. ⁵Në lidhje me shumën prej [] që duhet të disbursohet nga [Fondi], me anë të kësaj ne konfirmojmë deklaratat e bëra në aneksin A (Kontrata e Konsulencës nr. [numri i referencës]) për këtë Kërkesë për Pagesë.

5. Në lidhje me shumën prej [] që duhet të disbursohet nga [Llogaria], me anë të kësaj ne konfirmojmë deklaratat e bëra në aneksin B (Kontrata e Konsulencës nr. [numri i referencës]) për këtë Kërkesë për Pagesë.

6. Për qëllimet e seksionit 3.02 (Të gjitha pagesat e Grantit) të Marrëveshjes së Grantit, me anë të kësaj ne përfaqësojmë dhe garantojmë që:⁶

¹ Çdo kërkesë duhet të numërohet në seri.

² Përfshini shumën totale që do të disbursohet nga secili fond apo llogari.

³ Nëse pagesa kërkohet për një datë valute specifike, fshini tekstin brenda këtyre kllapave.

⁴ Kjo datë nuk do të jetë më shpejt se 10 ditë pune pas dorëzimit të kërkesës për pagesë të BERZH-it.

⁵ Përsërisni këtë paragraf 4 për çdo Kontratë dhe Kontratë Konsulence.

⁶ Zërat e mëposhtëm duhet të ndjekin paragrafët përkatës në seksionin 3.02.



a) Marrëveshja e Huas do të jetë në fuqi të plotë dhe Marrësi (dhe Enti Zbatues i Projektit, kur është e zbatueshme) do të jenë në përputhje me të gjitha detyrimet e tij në cilësinë e huamarrësit, sipas Marrëveshjes së Huas;

b) janë përmbushur, në formë dhe në thelb të pranueshme për BERZH-in, të gjitha kushtet para disbursimit të Huas, sipas Marrëveshjes së Huas;

c) përfaqësimet dhe garancitë e bëra apo të konfirmuara nga Marrësi dhe Enti Zbatues i Projektit, sipas rastit, në këtë Marrëveshje do të jenë të vërteta në atë datë dhe prej asaj date, me të njëjtin efekt, sikur këto përfaqësime dhe garanci të ishin bërë në atë datë dhe prej asaj date;

d) nuk ka ndodhur dhe nuk është në vazhdimësi asnjë Rast Rimbursimi;

e) nuk duhet të ketë ndodhur asgjë e cila mund të ketë efekt negativ material për Marrësin, Entin Zbatues të Projektit apo Projektin; dhe

f) Kontrata e Konsulencës është në fuqi dhe efektive dhe në të nuk është bërë asnjë ndryshim material.

7. ⁷Bashkëlidhur kësaj Kërkese për Pagesë:

a) ⁸një kopje e vërtetuar e një fature e datës [] nga [emri i Konsulentit], në lidhje me Kontratën e Konsulencës nr. [numri i referencës] [dhe të gjitha dokumentet mbështetëse⁹], në lidhje me të cilat kërkohet pagesa nga [Fondi];

b) një kopje e vërtetuar e një fature e datës [] nga [emri i Konsulentit], në lidhje me Kontratën e Konsulencës nr. [numri i referencës] [dhe të gjitha dokumentet mbështetëse], në lidhje me të cilat kërkohet pagesa nga [Llogaria];

...

c) dokumente të tilla të tjera që ka kërkuar BERZH-i [duke përfshirë: i. evidenca në lidhje me përdorimin e propozuar të të ardhurave të pagesës; dhe ii. evidenca në lidhje me përdorimin e propozuar të të ardhurave të ndonjë pagese të mëparshme].

8. Më lëshimin e kësaj Kërkese për Pagesë, Enti Zbatues i Projektit autorizon BERZH-in që të kryejë pagesën si më poshtë:

i. Për [emri i Konsulentit], në përputhje me Kontratën e Konsulencës nr. [numri i referencës], në shumën prej [] nga [Fondi];

ii. Për [emri i Konsulentit], në përputhje me Kontratën e Konsulencës nr. [numri i referencës], në shumën prej [] nga [Llogaria],

në çdo rast në emër të Entit Zbatues të Projektit.

Me respekt,

HEKURUDHA SHQIPTARE

Nga: _____

Përfaqësuesi i autorizuar¹⁰

⁷ Zërat e mëposhtëm duhet të ndjekin paragrafët përkatës në seksionin 3.02.

⁸ Nëse artikujt e financuar nga Granti janë prokuruar në mënyrë të thjeshtuar (ose ekuivalente), nuk kërkohen kopjet e faturave të kontratave.

⁹ Nuk kërkohen dokumente mbështetëse për zëra të financuar nga granti, të cilat janë financuar si pagesë totale, me kusht që Përfutuesi mban të dhënat e pagesave dhe të dokumenteve mbështetëse, siç kërkohet nga kjo Marrëveshje.

¹⁰ Personi që nënshkruan Kërkesën për Pagesë duhet të jetë i emëruar në Çertifikatën e Pozicionit të Punës dhe Autoritetit.



ANEKSI A
KONTRATË KONSULENCE NR. [NUMRI REFERENCËS]

Në lidhje me shumën prej [] që duhet të disbursohet nga [Fondi], me anë të kësaj konfirmojmë që:

a) Të ardhurat nga pagesa janë të nevojshme për Entin Zbatues të Projektit, në mënyrë rigoroze dhe vetëm për të financuar kostot e arsyeshme të shpenzimeve të shkaktuara [ose, nëse është rënë dakord me BERZH-in, që do të bëhen], në lidhje me Zërat e Financuar nga Granti të përshkruara në seksionin [1(a)] të shtojcës 1 (Zëra të Financuar nga Granti).

b) Ne ju kemi vënë në dispozicion një kopje të vërtetuar të Kontratës efektive të Konsulencës për [Titulli i kontratës] të datës [] dhe të lidhur ndërmjet Entit Zbatues të Projektit dhe [emri i Konsulentit], me numër reference [].

c) Shuma prej [] do të përdoret për sa më poshtë: [Marrësi të japë detaje të përdorimit të propozuar të të ardhurave nga pagesa].

d) Shërbimet e Konsulencës janë kryer në mënyrë të kënaqshme, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës përkatëse të Konsulencës.

e) Fatura e bashkëlidhur është e drejtë dhe e saktë dhe korrespondon me shumën e përcaktuar në Kontratën e Konsulencës me numër reference [].

f) Udhëzimet e pagesës për Konsulentin:

i. Detajet e bankës së Konsulentit:

Emri i llogarisë së Konsulentit: _____

Numri i llogarisë së Konsulentit (numri IBAN)¹¹: _____

Emri i bankës së Konsulentit: _____

Kodi SWIFT i bankës së Konsulentit: _____

Adresa e bankës e Konsulentit: _____

ii. Detaje të bankës korrespondente të Konsulentit:

Emri i bankës korrespondente:¹² _____

Kodi SWIFT i bankës korrespondente: _____

Adresa e bankës korrespondente: _____

Emri i llogarisë bankare korrespondente: _____

Numri i llogarisë bankare korrespondente (numri IBAN)¹³: _____

Referenca: _____

g) ¹⁴Me anë të kësaj vërtetojmë që kemi paguar një shumë të barabartë me çdo dhe të gjitha tatimet indirekte (përfshirë TVSH-në) në të gjitha faturat e mëparshme të secilit prej Konsulentëve, dhe me anë të kësaj marrim përsipër të paguajmë tatimet indirekte (përfshirë TVSH-në) në faturën me të cilën lidhet kjo Kërkese për pagesë brenda [30 ditëve] nga data e kësaj Kërkese për pagesë.

¹¹ Të gjitha pagesat që nuk janë USD duhet të përfshijnë numrin IBAN (Numri ndërkombëtar i llogarisë bankare)

¹² Emri i Bankës në Londër

¹³ Të gjitha pagesat që nuk janë në USD duhet të përfshijnë numrin IBAN (Numri ndërkombëtar i llogarisë bankare)

¹⁴ Përfshini nëse ngarkohet ndonjë tatim indirekt (përfshirë TVSH-në) në lidhje me Kontratën e Konsulencës (shihni seksionin 2.04(c) (Tatimet dhe Detyrimet)).



MODELI B
FORMATI I LETRËS PËR EMËRIMIN E NËNSHKRUESVE TË AUTORIZUAR

[Do të ofrohet nga Marrësi me letër me kokë të Marrësit]

[data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: []

Lënda: Marrëveshja e Grantit nr. [numri i kontratës]

I/e nderuar zotëri/zonjë

Në referencë të marrëveshjes së grantit të datës [] (Marrëveshja e Grantit) ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Hekurudha Shqiptare (Enti Zbatues i Projektit) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ju informojmë që personat, specimenet e nënshkrimeve të vërtetuara të të cilëve paraqiten më poshtë, janë të autorizuar të nënshkruajnë kërkesa pagese dhe çdo njoftim ose dokument tjetër që kërkohet të lëshohet nga Enti Zbatues i Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje Granti.

EMRI POZICIONI SPECIMENI I NËNSHKRIMIT

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

SHTOJCË 1

ZËRAT E FINANCUAR NGA GRANTI

Zërat e financuar nga Granti do të përfshijnë Shërbimet e Konsulencës të mëposhtme:

1. Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social i ndërtimit në një shumë prej 65,000.00 eurosh (Kontratë Konsulence nr. [për t'u konfirmuar]). Kjo do të financohet nga Fondi i Veçantë i Aksionarëve të BERZH-it.

2. Asistenca që do të financohet nga Nisma e Evropës Qendrore, në lidhje me:

i. Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), në një shumë deri në 150,000.00 euro (Kontratë Konsulence nr. [për t'u konfirmuar]).

ii. Rishikimi i Metodologjisë së Tarifave të Aksesit dhe Plani i Menaxhimit të Aseteve në një shumë deri në 350,000.00 euro (Kontratë Konsulence nr. [për t'u konfirmuar]).

Shërbimet e konsulencës përshkruhen më tej në shtojcën 2 (*Përshkrimi i Projektit*).

SHTOJCË 2

PËRSHKRIMI I PROJEKTT

1. Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social i Ndërtimit

Objekti kryesor i kësaj pike është ndërtimi i kapaciteteve të Hekurudhës Shqiptare (HSH ose Hekurudha Shqiptare), duke ofruar asistencë në zhvillimin dhe në zbatimin e një specifikimi për Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Ndërtimit (CESM) dhe mbështetjen e elementeve strukturore të sistemit të menaxhimit të EHSS-së për t'u zbatuar nga HSH-ja. CESM-ja do të duhet të strukturohet për të garantuar që masat lehtësuese mjedisore, shëndetësore, të sigurisë dhe ato sociale (EHSS) janë të përfshira në Projektin e Investimit dhe në rastet kur janë të zbatueshme, të përmbushen kushtet e Kërkesave të Performancës së Bankës, Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social të Projektit të Investimit (ESAP) dhe rregulloret shqiptare.

2. Asistenca me Raportimin IFRS

Rishikimi dhe ndryshimet e politikave dhe të procedurave të kontabilitetit të HSH-së për të garantuar përputhshmërinë e tyre me raportimin IFRS. Ofrimi i mbështetjes për HSH-në me përgatitjen e të dhënave financiare dhe të

raportimeve plotësisht, në përputhje me IFRS-në. Këshillimi për HSH-në për raporte të tjera dhe analiza të veçanta, si pjesë e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, të cilat janë të nevojshme për të lehtësuar menaxhimin efektiv financiar. Trajnimi i Drejtuesit Kryesor Financiar të HSH-së dhe i grupit të tij të punës për zbatimin e politikave dhe të procedurave të reja në përputhje me IFRS-në.

3. Rishikimi i Metodologjisë së Tarifave të Aksesit dhe Plani i Menaxhimit të Aseteve

Dy objektivat kryesorë të kësaj pike janë hartimi i një Plani Menaxhimi të Aseteve për të mbështetur mirëmbajtjen efikase të asetëve të përdorura nga HSH-ja dhe për të vendosur tarifën bazë për Tarifën e Aksesit, si dhe të mbështesë Shoqërinë në zbatimin e metodologjisë së Tarifave të Aksesit, bazuar në kosto të drejtpërdrejta të infrastrukturës operuese.

VENDIM

Nr. 160, datë 17.3.2021

**PËR MIRATIMIN E
LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT
AM MAIN (KfW), PËR PËRDORIMIN E
FONDEVE TË MBETURA NGA
PROGRAMI “MBROJTJA MJEDISORE E
LIQENIT TË SHKODRËS”, PËR T’U
PËRDORUR PËR FINANCIMIN E
SHËRBIMIT TË BORXHIT PËR
MARRËVESHJEN E HUAS PËR
PROGRAMIN “INFRASTRUKTURA
BASHKIAKE II”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW



Frankfurt am Main (KfW), për përdorimin e fondeve të mbetura nga programi “Mbrotja mjedisore e liqenit të Shkodrës”, për t’u përdorur për financimin e shërbimit të borxhit për marrëveshjen e huas, për programin “Infrastruktura bashkiake II”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Datë 20.9.2019

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të (nëpërmjet *email-it*)
UK Shkodër
Shkodër
Email: uks@ukshkodër-al.com

LEa4: Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë

Furnizimi me ujë dhe mbrotja mjedisore e liqenit të Shkodrës

BMZ ID 2002 66 676 EUR 10,500,000.00

Shërbimi i Borxhit për Programin e Infrastrukturës Bashkiake II (hua e butë)
(BMZ ID 2010 66 315)

Të nderuar zotërinj,

I referohemi Bashkëpunimit Financiar gjerman me Shqipërinë, në kuadrin e projektit të furnizimit me ujë dhe të mbrotjes mjedisore të liqenit të Shkodrës (BMZ ID 2002 66 676). Projekti paraqet fonde të mbetura në shumën prej 9.781.44 eurosh.

Ne propozojmë të përdorim fondet e mbetura në shumën prej **9.781.44 eurosh**, për shërbimin e borxhit për projektin Infrastruktura Bashkiake II (hua e butë) BMZ 2010 66 315.

Ne kërkojmë të jepni pëlqimin tuaj për përdorimin e përshkruar më sipër të fondeve të mbetura, duke nënshkruar dhe duke kthyer një kopje të kësaj letre.

Me respekt,

KfW

Dr. Kirk Mildner

Shefi i Departamentit

Stephan Raabe

Menaxher i Projektit

Lexuar dhe rënë dakord

Vendi, data, nënshkrimi

Emri: Anila Denaj

Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

VENDIM
Nr. 161, datë 17.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 226, DATË 21.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
FINANCIMIN E KOSTOS SË
MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE QË
ZBATOHEN NGA FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja “a”, e 4, dhe 8, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 226, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, masa 3% ndryshohet dhe bëhet 5%;

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. “Financimin e koston së menaxhimit të projekteve, në kuadr të programit të rindërtimit që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat nuk e kanë të parashikuar këtë kosto në marrëveshjet përkatëse të financimit. Kjo kosto është në masën 3% mbi vlerën totale të financimit të çdo programi/projekti.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM
Nr. 163, datë 17.3.2021

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
TË PORTIT TË PESHKIMIT NË
TRIPOST, VLORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të portit

të peshkimit në Triport, Vlorë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përdoret nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe





VENDIM
Nr. 164, datë 17.3.2021

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. ARBEN HYSKO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Hysko, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 165, datë 17.3.2021

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.
569, DATË 17.7.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
KOMPETENCAVE, MËNYRËN E
ORGANIZIMIT DHE TË
FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË BREGDETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e

ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 6, të kreut III, të vendimit nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 6/1, 6/2 dhe 6/3, me këtë përmbajtje:

“6/1. Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit krijohet Komisioni i Ankimit të AKB-së, i cili drejtohet nga drejtori i përgjithshëm dhe, si rregull, ka në përbërje të tij:

a) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për performancën dhe menaxhimin e integruar të zonave bregdetare;

b) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit të zonave bregdetare;

c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse;

ç) nëpunësin përgjegjës për çështjet juridike/ligjore të agjencisë, në cilësinë e sekretarit të Komisionit të Ankimit të AKB-së.

6/2. Në mungesë të anëtarëve të komisionit të përcaktuar në pikën 6.1 të këtij kreu, për shkak të mosplotësimit të pozicionit të punës, drejtori i përgjithshëm cakton zëvendësuesin e njësisë përgjegjëse respektive, deri në plotësimin e vendit vakant.

6/3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Komisionit të Ankimit të AKB-së përcaktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKB-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM
Nr. 166, datë 17.3.2021

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT NGA KATEGORIA E
RESURSIT “TOKË BUJQËSORE” NË
“TOKË TË PAFRYTSHME”, TË
SIPËRFAQEVE TË PASURIVE ME
NUMRA 821/46 DHE 822/34, ZONA
KADASTRALE 1492, BASHKIA DIVJAKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/1, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë të pafrytshme”, për sipërfaqen prej 157 888 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) m², pasuria me numër 821/46, dhe për

sipërfaqen prej 650 638 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) m², pasuria me numër 822/34, zona kadastrale 1492, Bashkia Divjakë, sipas certifikatave të pasurive dhe hartave treguese, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Fier, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë të pafrytshme”, të pasurive me numër 821/46 dhe 822/34, zona kadastrale 1492, Bashkia Divjakë.

3. Ngarkohet Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë të pasqyrojë në kartelat e pasurisë dhe në certifikatat e pasurive ndryshimin e zërit kadastral të pasurive me numër 821/46 dhe 822/34, zona kadastrale 1492, Bashkia Divjakë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1653655
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit LUSHNJE Zona Kadastrale Nr. 1492
 Numri i Pasurisë 822/34 Volumi 48 Faqe 241
 Adresa e Pasurisë Nivjakë
 Lloji i Pasurisë Arë
 Sipërfaqja Totale 650.638 m²
 Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>Republika e Shqipërisë</u>				

- është pronar i pas. nr. 822/34
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 13.02.18 Nr. 939

Data e lëshimit të çertifikatës
08/03/2018

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
Shkelqim Tebelli



Miratuar nga V.K.M. Nr.519. Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 48 Fq 241.

A – SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vijon nga: Vol. 38 Fq 13.

Zona Kadastrale: 1492 NR. i PASURISE: 822/34

Vijon në: Vol. Fq. deri në: Vol. Fq. -->

Indeksi i Hartës: K-34-100-(1-C)

PERFUNDIMTARE (data): 24 / 11 / 2006.

Adresa e pasurisë: Rrethi LUSHNJE Q/F DIVJAKE

Rr/L P/G Sh K Ap

Përshkrim i Veçantë

B – SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: Are.

Brënda V.K.N. : Jo - - - > Po, Ref: .

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: Sa Truall	Nga Sip. Truall : sa Ndërtesë
1. 650 638 m ²	1. m ²	1. m ²
Ref. 00005738	Ref.	Ref.
2. m ²	2. m ²	2. m ²
Ref.	Ref.	Ref.
3. m ²	3. m ²	3. m ²
Ref.	Ref.	Ref.
4. m ²	4. m ²	4. m ²
Ref.	Ref.	Ref.

Për pjesën e përbashkët

PALLAT

Kuotat e Pjesëmarrjes:

%

Nr. i Pasurisë (Pallat):

Vol. Fq.



C – SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasa p	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
05738	08/03/2018	Republika e Shqipërisë			Divjakë		08/03/2018	R.pronesia VKM 49/2018	

Shënim : Kollona I/F/B tregon: I – individ, person fizik ose juridik; F – perfaqësues i familjes; B – bashkepronar (%)



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

NDORE E REGJISTRIMIT JRIVE TE PALUAJTSHME LUSHNJE	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
	ZONA KADASTRALE <u>497</u> NR.PASURISE <u>828/39</u> VOL <u>8 FQ 24</u> INDEKSI I HARTES <u>K-34-100-(1-C)</u> SHKALLA <u>1:8000</u> ADRESA E PASURISE: Rrethi LUSHNJE Q/F <u>Divjake</u> Rr/L _____ P/G Sh K Ap _____
	B. KUFIZIMET Y. <u>14.05</u> L. <u>322/2</u> J. <u>1397</u> P. <u>1397</u>
PRONARI: <u>Republika e Shqipërisë</u>	
HARTOGRAFI	



REPUBLICA E SHQIPËRISË
Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme

REPUBLICA E SHQIPËRISË
Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

1653654

Zyra e Regjistrimit LUSHNJE Zona Kadastrale Nr. 1492
 Numri i Pasurisë 821/46 Volumi 49 Faqe 177
 Adresa e Pasurisë Divjake
 Lloji i Pasurisë Arë
 Sipërfaqja Totale 157888m²
 Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
Republika e Shqipërisë				

- është pronar i pas. nr. 821/46
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 02.03.18 Nr. 934

Data e lëshimit të çertifikatës

08/03/2018

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

(Shkëqim Mëbelle)



Miratuar nga V.K.M. Nr.519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 49 Fq 17

A – SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vijon nga: Vol. 38 Fq 12

Zona Kadastrale: 1492 NR. i PASURISE: 821/46

Vijon në: Vol. Fq. deri në: Vol. Fq.

Indeksi i Hartës: K-34-100-(1-C)

PERFUNDIMTARE (data): 30 / 03 / 200

Adresa e pasurisë: Rrethi LUSHNJE Q/F DIVJAKE

Rr/L P/G Sh K Ap

Përshkrim i Veçantë

B – SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: Are

Brënda V.K.N. : Jo - - - -> Po, Ref:

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: Sa Truall	Nga Sip. Truall :sa Ndërtesë
157 888 m ²	1. m ²	1. m ²
Ref. 00002570	Ref.	Ref.
2. m ²	2. m ²	2. m ²
Ref.	Ref.	Ref.
3. m ²	3. m ²	3. m ²
Ref.	Ref.	Ref.
4. m ²	4. m ²	4. m ²
Ref.	Ref.	Ref.

Për pjesën e përbashkët

PALLAT

Kuotat e Pjesëmarrjes:

%

Nr. i Pasurisë (Pallat):

Vol. Fq.

C – SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasa I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
05738	08/03/2018	Republika e Shqipërisë		Divjakë		08/03/2018	R.pronesia VKM 49/2018	

Shënim : Kollona I/F/B tregon: I – individ, person fizik ose juridik; F – perfaqësues i familjes; B – bashkepronar (%)



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

YRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
LUSHNJE

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE



ZONA KADASTRALE 452 NR.PASURISE 821/46 VOL 59 FQ 77INDEKSI I HARTES K-34-102-(1-C) SHKALLA 1:8000ADRESA E PASURISE: Rrethi LUSHNJE Q/F Shijak

Rr/L _____ P/G Sh K Ap

B. KUFIZIMET

Y. 1381L. 1399J. 1406P. 821/451 47

PRONARI:

Republika e Shqipërisë

HARTOGRAFI

**VENDIM****Nr. 167, datë 17.3.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 407, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E NJË REGJIMI KONTROLLI PËR TË
GARANTUAR RESPEKTIMIN E
RREGULLAVE TË POLITIKAVE
MENAXHUESE NË PESHKIM”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 72, pika 8, 74, pika 3, 82, pika 2, 101, pikat 2 e 3, 113, pika 1, 116, 118, pika 3, dhe 135, pika 1, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 33 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“33. Të gjitha anijet mbi 12 m, të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit (RAP), instalojnë në bordin e tyre pajisjen MTU (*Mobile Transceiver Unit*), për identifikimin e lokalizimin nëpërmjet satelitit. Kjo pajisje duhet të jetë në përputhje me sistemin e instaluar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe në ministri, si dhe duhet të plotësojë të gjitha specifikimet, sipas pikës 24, të këtij vendimi.

Ministria përgjegjëse për peshkimin u jep në përdorim të gjitha anijeve mbi 12 metra, të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit, pajisjen MTU, e cila, nëse del jashtë funksionimit, zëvendësohet me shpenzimet e subjektit përdorues.”.

b) Pika 33/1 shfuqizohet.

2. Fondet për blerjen e pajisjeve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, për vitin 2021, të përballohen nga buxheti i shtetit i këtij viti, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM**Nr. 171, datë 24.2.2021**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
FINANCIARE TË PROKURORIT TË
SISTEMIT TË PROKURORISË, QË
SHËRBEN SI PROKUROR
NDËRLIDHËS PRANË EUROJUST-it**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it, ratifikuar me ligjin nr. 113/2018, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Prokuroria e Përgjithshme, brenda fondeve buxhetore të miratuara, të përballojë shpenzimet financiare të prokurorit ndërlidhës në Eurojust:

a) për qiranë e apartamentit, mirëmbajtjen e tij, për ngrohje, gaz, energji elektrike dhe ujë;

b) për pajisje shtëpiake;

c) për siguracion shëndetësor familjar;

ç) shpenzimet e transportit publik për udhëtime brenda vendit pritës për nevoja pune;

d) për taksa të shkollave publike, kur në vendin pritës shkollat janë me pagesë, kundrejt vërtetimit nga autoritetet shkollore të vendit pritës.

2. Bashkëshorti/ja i/e prokurorit ndërlidhës përfiton shpërblim mujor në vlerën 50 për qind të pagës së pozicionit të punës, grada “Atashe”, të vendit pritës. Pagesa e shpërblimit mujor fillon pas paraqitjes së vërtetimit të shoqërimit të prokurorit ndërlidhës nga bashkëshorti/ja në detyrë, në vendin pritës. Ky shpërblim u nënshtrohet ndalesave të tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shpërblimi derdhet në llogarinë e bashkëshortit/es, në njërin nga bankat e vendit pritës, ku bashkëshorti/ja ka llogarinë personale.

Bashkëshorti/ja i/e prokurorit ndërlidhës, i cili/e cila nuk e shoqëron atë në detyrë në vendin



pritës, nuk përfiton shpërblimin e parashikuar në këtë pikë. I ndërpritet e drejta për shpërblim mujor bashkëshortit/es, i cili/e cila nuk shoqëron prokurorin ndërlidhës për më shumë se tre muaj rresht në detyrë.

3. Çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç, që jeton me prokurorin ndërlidhës në vendin pritës, përfiton shpërblim mujor me vlerën 20 për qind të pagës së gradës “Atashe”, të vendit pritës. Ky shpërblim i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shpërblimi i fëmijës derdhet në llogarinë e prokurorit ndërlidhës.

4. Për shpenzime që janë të përshtatshme të kryhen në vendin pritës, prokurori ndërlidhës dërgon ofertat në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila përzgjedh dhe miraton ofertën më të përshtatshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin e prokurimit publik, të ndryshuar.

5. Kur prokurori ndërlidhës dërgohet me shërbim jashtë vendit pritës ose kur vjen në atdhe, ndërkohë që në shtetin ku kryen detyrën ka lënë bashkëshorten dhe fëmijët, merr 100 për qind të trajtimit financiar, të dhënë për përkujdesje ndaj familjes së tij.

6. Kur prokurori ndërlidhës shtrohet për kurim në institucionet shëndetësore të shtetit ku kryen detyrën ose në ndonjë shtet tjetër ai vazhdon ta përfitojë pagesën përkatëse dhe trajtimin financiar, të dhënë për përkujdesje ndaj familjes së tij.

7. Prokurori ndërlidhës gëzon të drejtën e pushimeve javore, të pushimeve në ditët e festave zyrtare dhe të pushimit vjetor të paguar, për kohën që është me detyrë jashtë shtetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Prokuroria e Përgjithshme nuk merr përsipër shpenzimet e kthimit në atdhe të prokurorit ndërlidhës për kryerjen e lejes së zakonshme. Me miratimin e prokurorit të përgjithshëm, vetëm në raste fatkeqësie, prokurorit ndërlidhës dhe familjarëve shoqërues u paguhen nga shteti shpenzimet e udhëtimit (për ardhjen në atdhe dhe kthimin në vendin e huaj).

8. Prokuroria e Përgjithshme, për prokurorin ndërlidhës dhe pjesëtarët e familjes që janë në ngarkim të tij, përballojnë sigurimet e detyrueshme, sipas legjislacionit të shtetit përkatës, ku kryen detyrën. Prokurori ndërlidhës dhe pjesëtarët e familjes, në ngarkimin e tij, kanë të drejtë që me

miratimin e prokurorit të Përgjithshëm, për raste urgjencash, të mjekohen në vendin ku kryen detyrën, kur, për këtë rast, nuk është parashikuar sigurimi shëndetësor. Shpenzimet përballohen nga shteti, ndërsa për rastet e tjera përballohen nga vetë prokurori ndërlidhës.

9. Prokurori ndërlidhës ka të drejtë të përfitojë shpenzime udhëtimi, akomodimi dhe dietë në valutë të huaj, sipas legjislacionit në fuqi, kur emërohet në detyrë, thirret në atdhe ose dërgohet me shërbim në një shtet tjetër, si dhe kur kthehet në atdhe, në përfundim të detyrës.

10. Ngarkohet Prokuroria e Përgjithshme për përcaktimin e fondeve të këtyre shpenzimeve dhe të masës së mbulimit të tyre, në përputhje me parashikimet e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

11. Ngarkohet Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 174, datë 24.3.2021

**PËR KRYERJEN E PAGESËS SË
DOZAVE TË VAKSINAVE, QË RRJEDH
NGA MARRËVESHJA NDËRMJET
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE
INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK,
DHE DISTRIBUTORIT TË
AUTORIZUAR “KEYMEN ILAÇ SANAYI
VE TICARET” A.Ş., PËR FURNIZIMIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME
VAKSINËN E INAKTIVIZUAR KUNDËR
COVID-19 (VERO CELL) CORONAVAC,
TË KRIJUAR NGA SINO VAC LIFE
SCIENCE CO LTD. DHE TË
PRODHUAR NË REPUBLIKËN
POPULLORE TË KINËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14,



të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen nga Instituti i Shëndetit Publik të pagesës së dozave të vaksinave anticovid-19, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret*” A.Ş., për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (*vero cell*), *Coronovac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co, Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për Institutin e Shëndetit Publik, në llogarinë ekonomike 6050000 (Produkti 91305AH) të programit të shëndetit publik (07450), i shtohet ekuivalenti në lekë (sipas kursit zyrtar të këmbimit në datën e pagesës) i shumës 10 000 000 (dhjetë milionë) USD, të pagesës së dozave të vaksinave anticovid-19, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret*” A.Ş., për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (*vero cell*), *Coronovac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës.

3. Fondi, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 175, datë 17.3.2021

**PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E SPITALIT RAJONAL
“MEMORIAL” NË FIER, SI PROJEKT
PILOT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e spitalit rajonal “Memorial” në Fier, si projekt pilot me status të veçantë të funksionimit si spital i nivelit terciar, që ushtron veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor dhe bazuar në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr. 23/2021, me seli në Fier, pjesë e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

2. Spitali rajonal “Memorial” në Fier do të funksionojë për një periudhë tranzitore në bashkëpunim me personat e caktuar nga ministria e shëndetësisë turke, sipas protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy ministrave përkatës, përgjegjës për shëndetësinë.

3. Spitali rajonal “Memorial” në Fier ofron shërbimet bazë, sipas listës së shërbimeve në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Spitali rajonal “Memorial” në Fier e ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokolleve të diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

5. Rregullimet e përgjithshme dhe në hollësi të veprimtarisë së spitalit rajonal “Memorial” në Fier përcaktohen në statutin e spitalit, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.



6. Organet drejtuese të spitalit rajonal “Memorial” në Fier janë:

a) Bordi Drejtues i spitalit rajonal “Memorial” në Fier, si organi më i lartë ekzekutiv, i cili është i pavarur në veprimtarinë e tij dhe funksionon si organ kolegjal;

b) drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet dhe shkarkohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

7. Bordi Drejtues kryesohet nga përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ka në përbërje:

a) 1 përfaqësues të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;

b) 1 përfaqësues të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

c) 1 përfaqësues të sindikatës që ka lidhur kontratë kolektive me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

ç) 1 përfaqësues të Urdhrit të Mjekut.

8. Funksionet e Bordit Drejtues përcaktohen në statutin e spitalit rajonal “Memorial” në Fier.

9. Institucionet e përmendura në pikën 7 të këtij vendimi, përcaktojnë anëtarët e bordit, të cilët marrin një shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje, masa e të cilit propozohet dhe miratohet nga Bordi Drejtues.

10. Bordi Drejtues raporton periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

11. Rregullorja e brendshme e spitalit miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

12. Financimi nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore realizohet sipas paketave të shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

13. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratë me spitalin rajonal “Memorial” në Fier për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore, duke përfshirë shpenzimet për personelin, shërbimet korrente dhe paketat e shërbimeve të ofruara dhe, në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, kontrollon e monitoron buxhetin spitalor, vlerëson aktivitetin vjetor të spitalit dhe treguesit e performancës, nëpërmjet strukturave të tyre audituese e kontrolluese, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

14. Në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, alokohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave fondi shtesë për menaxhimin dhe funksionimin e spitalit rajonal “Memorial” në Fier, në vlerën 300 000 000 (treqind milionë) lekë.

15. Të ardhurat dytësore, të realizuara nga spitali rajonal “Memorial” në Fier, përdoren nga vetë spitali, sipas kriterëve që përcaktohen në statut dhe miratohen nga Bordi Drejtues i spitalit.

16. Struktura dhe organika e spitalit miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, me propozim të Bordit Drejtues të spitalit.

17. Numri i punonjësve të spitalit rajonal “Memorial” në Fier për vitin 2021 është 398 veta.

18. Personeli prej 398 punonjësish i spitalit rajonal “Memorial” në Fier i shtohet numrit të punonjësve që financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të miratuar për vitin 2021.

19. Personeli i kujdesit shëndetësor turk caktohet nga Republika e Turqisë gjatë fazës së tranzicionit të spitalit rajonal “Memorial” në Fier, në zbatim të nenit 1, të marrëveshjes së lidhur, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, ratifikuar me ligjin nr. 23/2021.

20. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të spitalit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

21. Përzgjedhja e personelit mjekësor dhe administrativ shqiptar bëhet nga komisioni *ad hoc* që ngrihet me urdhër të veçantë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

22. Institucionet kompetente ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e spitalit rajonal “Memorial” në Fier, sipas legjislacionit në fuqi dhe brenda fushës së tyre të përgjegjësisë.

23. Spitali rajonal “Memorial” në Fier ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, spitali rajonal “Memorial” në Fier, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

24. Vula e spitalit rajonal “Memorial” në Fier ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e përdorimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave



zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

25. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË
DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” NË
FIER

1. Shërbimi i urgjencës;
2. Shërbimi i kardiologjisë;
3. Shërbimi i hematologjisë;
4. Shërbimi i nefrologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i ORL-së;
7. Shërbimi i okulistikës;
8. Shërbimi i pneumologjisë;
9. Shërbimi i neurologjisë;
10. Shërbimi i urologjisë;
11. Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme;
12. Shërbimi i ortopedisë dhe i traumatologjisë;
13. Kirurgjia torakale;
14. Shërbimi i neurokirurgjisë;
15. Shërbimi i kirurgjisë vaskulare;
16. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
17. Shërbimi i sëmundjeve infektive;
18. Shërbimi i radiologjisë;
19. Shërbimi i fizioterapisë;
20. Farmacia;
21. Konsultat e specializuara ambulatorë;
22. Kontrolli i infeksioneve spitalore.

VENDIM

Nr. 7, datë 23.2.2021

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	Kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska	Anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari	Anëtare e “ “
Altin Binaj	Anëtar i “ “
Përparim Kalo	Anëtar i “ “
Sonila Bejtja	Anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	Anëtare e “ “

me sekretare Enina Ktoni në datën 23.2.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 2(G)/2018 Regj. Them., që u përket:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, KËSHILLI I
MINISTRAVE

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me nenin 81, pika 2, të Kushtetutës i shprehjes “*së Apelit*”, në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, që kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Apelit Tiranë (*gjykata referuese*) ka marrë në shqyrtim çështjen me paditës SH.M., me të paditur Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 716, datë 7.9.2017 të ATP-së, Tiranë, që ka rrëzuar kërkesën për njohjen e pronësisë të subjektit të shpronësuar O.M. (trashëgimtarëve të tij); njohjen e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme të ndodhura në Priskë të Madhe, qarku Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar O.M., sipas kufijve të përcaktuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 7710, datë 30.9.2009, i shoqëruar me planvendosjen përkatëse, dhe kthimin në natyrë të tyre.

2. Me vendimin e ndërmjetëm nr. 949, datë 12.1.2018, gjykata referuese i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë pajtueshmërinë me nenin 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës, të shprehjes “*së Apelit*” në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 133/2015*).

3. Neni 29 i ligjit nr. 133/2015 parashikon se “*kundër vendimit të ATP -së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.*”.

4. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në datën 20.2.2018, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, por ndërkohë prej datës 23 mars 2018 Gjykata Kushtetuese nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për formimin dhe funksionimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve.

5. Me plotësimin e kuoromit të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin paraprak të çështjeve nga Mbledhja e Gjyqtarëve, kjo e fundit, në datën 15.1.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

6. Gjykata referuese i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të shprehjes “*së Apelit*” në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015 dhe ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto argumente:

6.1 Gjykata referuese legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për kontrollin incidental të normës, pasi plotëson kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me legjitimitimin e gjykatave, sipas nenit 145, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000.

6.2 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj. Nenet 3, 41, pika 1, 442, 442/a dhe 452 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) përcaktojnë kompetencën e gjykimit të çështjeve sipas shkallëve normale të gjykimit, si parim i rëndësishëm procedural. Kjo do të thotë se gjykata e apelit është gjykatë rishikuese e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë (nga pikëpamja e ligjit dhe faktit) dhe jo gjykatë e shkallës së parë për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të ATP-së, si në rastin konkret. Vetë KPC-ja, si një ligj i miratuar me shumicë të cilësuar (3/5), parashikon rastet përjashtimore kur gjykata e apelit gjykon çështjet si gjykatë e shkallës së parë. Parashikime të kundërta me ato të KPC-së mund të bëhen vetëm nga ligje të miratuara me shumicë të cilësuar prej 3/5-at e votave dhe jo me ligje të zakonshme, siç është rasti i ligjit nr. 133/2015.

6.3 Neni 29 i ligjit nr. 133/2015 ka zhbërë parimet bazë të KPC-së lidhur me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatave (*gjykimi sipas shkallëve normale të gjyqësorit*), duke ndryshuar kompetencën e gjykatave për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve civile me një ligj të zakonshëm (të miratuar me 78 vota), siç është ligji nr. 133/2015, si dhe duke lënë pa fuqi KPC-në, që është ligj me fuqi më të lartë juridike. Kjo ka passjell cenimin e nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës dhe të parimeve të hierarkisë së normave të së drejtës dhe të ligjshmërisë.

6.4 Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim konstant në jurisprudencën e saj në lidhje me rastet kur ligjvënësi ka cenuar parashikimin e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës, duke tentuar të rregullojë me ligj të zakonshëm çështje që përfshihen



ekskluzivisht në fushën e rregullimit me anë të kodeve.

6.5 Duke njohur të drejtën e ankimit të drejtpërdrejtë në gjykatën e apelit të vendimeve të ATP-së, neni 29 i ligjit nr. 133/2015 ndikon në zgjatjen e afateve kohore të shqyrtimit të çështjeve në apel, çka nuk përputhet me qëllimin e ligjvënësit për përshpejtimin e procedurës së kompensimit të pronave. Për shkak se gjykatat e apelit gjykojnë me trupa gjykues prej 3 gjyqtarësh dhe gjykojnë edhe çështjet që ndjekin rrugën normale të ankimit, ato kanë infrastrukturë të pakët për njoftimin e palëve, si dhe kanë vështirësi në planifikimin dhe gjykimin e shpejtë të çështjeve.

7. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, ka parashtruar, në mënyrë të përmblodhur:

7.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën, për arsye se: i. ka konstatuar papajtueshmërinë midis dy ligjeve, konkretisht KPC-së dhe nenit 29 të ligjit nr. 133/2015, çka nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese; ii. ndryshe nga sa ajo argumenton, neni 29 i ligjit nr. 133/2015 nuk cenon parimin e hierarkisë së normave të së drejtës dhe nuk u mohon palëve ushtrimin e kontrollit nga Gjykata e Lartë, si dhe është në harmoni me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të KPC-së; iii. nuk është nisur nga prezumimi i pajtueshmërisë së dispozitës së kundërshtuar me Kushtetutën dhe nuk ka dhënë argumente në lidhje me shkeljen e normave e vlerave kushtetuese.

7.2 Neni 29 i ligjit nr. 133/2015 nuk cenon asnjë parashikim kushtetues. Gjykata referuese nuk ka argumentuar se përse shqyrtimi nga gjykata e apelit si gjykatë fakti i ankimeve ndaj vendimeve të ATP-së passjell cenimin e primeve të shtetit të së drejtës, të ligjshmërisë dhe hierarkisë së normave të së drejtës. Individit nuk i cenohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet nga gjykimi në një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj. Ligjvënësi ka parashikuar një shkallë gjykimi nga pikëpamja e faktit dhe ligjit, konkretisht gjykatën e apelit, me qëllim përfundimin e procesit të kompensimit të pronave brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata e ka shqyrtuar nenin 29 të ligjit nr. 133/2015 në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, dhe nuk ka gjetur probleme kushtetutshmërie. Në këto kushte, kontrolli kushtetues i shprehjes “*së Apelit*” në

dispozitën e kundërshtuar është bërë nga Gjykata dhe kjo çështje përbën gjë të gjykuar.

8. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka parashtruar si vijon:

8.1 Gjykata e ka shqyrtuar nenin 29 të ligjit nr. 133/2015 në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, prandaj kontrolli kushtetues i shprehjes “*së Apelit*” në dispozitën e kundërshtuar është bërë nga Gjykata dhe përbën “*res judicata*”.

8.2 Papajtueshmëria midis dy ligjeve, konkretisht KPC-së dhe nenit 29 të ligjit nr. 133/2015, që është identifikuar dhe argumentuar nga gjykata referuese, nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Ligjvënësi ka parashikuar një shkallë gjykimi nga pikëpamja e faktit dhe ligjit, konkretisht gjykatën e apelit, me qëllim përfundimin e procesit të kompensimit të pronave brenda një afati të arsyeshëm. Neni 29, i ligjit nr. 133/2015, nuk cenon parimin e hierarkisë së normave të së drejtës, nuk u mohon palëve ushtrimin e kontrollit nga Gjykata e Lartë, si dhe është në harmoni me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të KPC-së. Gjykata referuese nuk është nisur nga prezumimi i pajtueshmërisë së dispozitës së kundërshtuar me Kushtetutën dhe nuk ka dhënë argumente serioze në lidhje me shkeljen e normave dhe primeve kushtetuese.

8.3 Megjithëse ligji nr. 133/2015 ka një rend hierarkik më të ulët se KPC-ja dhe duhet të respektojë dispozitat e këtij të fundit, pretendimi i gjykatës referuese se dispozita e kundërshtuar cenon nenin 81, pika 2, të Kushtetutës nuk është i bazuar. Pavarësisht shkallës se ku inicohet gjykimi, ligji nr. 133/2015 i garanton individit aksesin në gjykatë dhe mundësinë e ankimit ndaj vendimit të ATP-së në gjykatën e apelit, si dhe rekursin në Gjykatën e Lartë. Një rregullim i ngjashëm gjendet edhe në nenin 238 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, që parashikon ankimin në Gjykatën Administrative të Apelit ndaj vendimeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

III

Vlerësimi i Gjykatës

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata vëren se ligji nr. 133/2015 është marrë në shqyrtim në tërësinë e tij edhe më parë prej saj në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017. Për



rrjedhojë, Gjykata vlerëson të ndalet nëse në rastin konkret ndodhemi përpara gjësë së gjykuar dhe nëse ajo mund të shprehet sërish për kushtetutshmërinë e përmbajtjes së dispozitës objekt shqyrtimi.

10. Sipas gjykatës referuese, papajtueshmëria e shprehjes “*së Apelit*” në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015 me nenin 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës nuk është “gjë e gjykuar” në aspektin kushtetues, pasi një pretendim i tillë nuk është ngritur më parë në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk është trajtuar në vendimin e saj nr. 1, datë 16.1.2017.

11. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se Gjykata e ka shqyrtuar nenin 29 të ligjit nr. 133/2015 në vendimin e lartpërmendur dhe nuk ka gjetur probleme kushtetutshmërie. Në këto kushte, sipas tyre shprehja “*së Apelit*” në dispozitën e kundërshtuar është kontrolluar nga Gjykata dhe kjo çështje përbën gjë të gjykuar.

12. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në të drejtën kushtetuese parimi *res judicata* njihet si një nga tri format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal e procedural “gjë e gjykuar” nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë detyruese të vendimit. Tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur Gjykata nuk është shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me

Kushtetutën të normës juridike, subjektet që mund t’i drejtohen kësaj Gjykate nuk ndalohen të paraqesin përsëri të njëjtën kërkesë për kontrollin e pajtueshmërisë së kësaj norme me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga ana tjetër Gjykata në praktikën e saj, ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit të parashikuar nga ligji i saj organik, është argumentuar një shkak i ri për antikushtetutshmërinë e akteve normative. Ndërsa, në rastet kur Gjykata është shprehur më parë me vendim për themelin e pretendimeve të ngritura nga palët, në situatën e riparaqitjes të kërkesës ajo ka vlerësuar se vendimi i mëparshëm përbën pengesë në aspektin kushtetues, për sa kohë që është mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me të njëjtat shkaqe të ngritura sërish në kërkesë (*shih vendimet nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se referuar vendimit nr. 1, datë 16.1.2017 të saj, rezulton se në gjykimin abstrakt të antikushtetutshmërisë së ligjit nr. 133/2015, ndër të tjera, është pretenduar se ligji cenon të drejtën e ankimit, pasi duke parashikuar vetëm ankimin e vendimeve të ATP-së në gjykatën e apelit, praktikisht ka pamundësuar ankimin e vendimit gjyqësor në një gjykatë më të lartë, duke qenë se vendimet e gjykatës së apelit janë vendime të formës së prerë dhe përfundimtare dhe Gjykata e Lartë është gjykatë e ligjit dhe, si e tillë, nuk mund të investohet në fakte të çështjes (*shih prg. 48 të vendimit nr. 1/2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 është shprehur: “Në çështjen konkrete për shqyrtim, Gjykata vlerëson se e drejta e ankimit e parashikuar nga ligji nr. 133/2015 i plotëson kriteret për të pasur një kontroll gjyqësor të akteve të nxjerrta nga organet administrative ose quasi gjyqësore. Pretendimi i kërkuar se nuk duhet parashikuar si shkallë e ankimit Gjykata e Apelit, por gjykata administrative e shkallës së parë, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimeve të ATP-së, nuk është i bazuar. Gjykata thekson se shteti nuk ka detyrim të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi, për sa kohë që ka një ankim në një gjykatë të parashikuar me ligj, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kriteri i kontrollit gjyqësor të akteve të pushtetit



publik është i garantuar nga ligji objekt shqyrtim? (shih prg. 52 të vendimit nr. 1/2017 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimi i gjykatës referuese për pajtueshmërinë me Kushtetutën të përmbajtjes së nenit 29 të ligjit nr. 133/2015, konkretisht të shprehjes “*së Apelit*”, është shqyrtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese, në këndvështrim të cenimit të së drejtës së ankimit (*vendimi nr. 1/2017 i Gjykatës Kushtetuese*), por jo në këndvështrim të përputhshmërisë me nenin 81, pika 2, shkronja “d” të Kushtetutës.

18. Gjykata ka theksuar se natyra e pretendimeve të ngritura para saj është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje dhe se, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, ajo e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata vlerëson se megjithëse objekti i shqyrtimit në vendimarrjen e saj të mëparshme ka qenë i njëjtë, shkaku i ngritur në atë gjykim kushtetues ka qenë i ndryshëm, prandaj ajo ka juridiksion për të marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura nga gjykata referuese.

B. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

19. Çështja e legjitimitimit të subjekteve që mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental rregullohet nga neni 145, pika 2, i Kushtetutës, i konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000. Këto dispozita parashikojnë se kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka zhvilluar disa standarde për legjitimitimin e gjykatës referuese për iniciimin e kontrollit incidental të normës ligjore për pajtueshmëri me Kushtetutën. Sipas këtyre standardeve, gjykata referuese duhet që gjatë procesit gjyqësor: i. të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes

konkrete (lidhja e drejtpërdrejtë); ii. të parashtrojë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii. të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv. të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t’i referohet për zgjidhjen e çështjes, të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 8, datë 7.2.2017; nr. 22, datë 11.4.2016; nr. 26, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se gjykata referuese nuk është nisur nga prezumimi i pajtueshmërisë së dispozitës së kundërshtuar me Kushtetutën dhe nuk ka dhënë argumente në lidhje me shkeljen e normave dhe vlerave kushtetuese.

22. Gjykata, në analizën e respektimit të kriterëve të sipërcituara për legjitimitimin e gjykatës referuese, vëren se në kuptim të përmbajtjes së nenit 145 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, gjykata referuese në vendimin për pezullimin e gjykimit dhe iniciimin e kontrollit kushtetues, është e detyruar të përcaktojë dispozitat e ligjit të zbatueshëm dhe të argumentojë ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë, pra që midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete ekziston një marrëdhënie juridike konkrete, reale dhe aktuale. Në çështjen në shqyrtim Gjykata vëren se gjykata referuese ka identifikuar shprehjen “*së Apelit*” në përmbajtjen e nenit 29 të ligjit nr. 133/2015, si pjesë të dispozitës ligjore të zbatueshme drejtpërdrejt në rastin konkret, pasi dispozita në fjalë përcakton gjykatën kompetente nga pikëpamja lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të ATP-së.

23. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjykata referuese, duke argumentuar se kjo shprehje bie ndesh me nenin 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës dhe cenon parimin e ligjshmërisë dhe hierarkisë së normave të së drejtës, pasi me një ligj të zakonshëm janë zhbërë parimet bazë të KPC-së lidhur me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatave (*gjykimi sipas shkallëve normale të gjyqësorit*), ka arsyetuar për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, duke referuar normat dhe parimet



përkatëse të Kushtetutës, të cilat ajo i vlerëson se janë shkelur.

24. Për sa më sipër, Gjykata çmon se dispozita e kundërshtuar duke i njohur subjektit të shpronësuar të drejtën e ankimit kundër vendimeve të ATP-së, i ka dhënë kompetencën lëndore gjykatave të apelit për shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre. Për rrjedhojë, dispozita e kundërshtuar është e zbatueshme në rastin në shqyrtim dhe gjykata referuese ka identifikuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis nenit 29 të ligjit nr. 133/2015 dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Gjithashtu, në ndryshim nga sa është parashtruar prej subjekteve të interesuara, Gjykata vëren se gjykata referuese ka paraqitur në kërkesë argumente të mjaftueshme për të mbështetur jo vetëm pretendimin e saj për antikushtetutshmërinë e dispozitës ligjore që kundërshton, por edhe se gjykimi nuk mund të përfundojë pa u shprehur Gjykata Kushtetuese për kushtetutshmërinë e normës.

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se gjykata referuese plotëson kriteret e legjitimitit, në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

26. Gjykata referuese ka pretenduar se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj. Sipas saj, nenet 3, 41, pika 1, 442, 442/a dhe 452 të KPC-së përcaktojnë kompetencën e gjykimit të çështjeve sipas shkallëve normale të gjykimit, si parim i rëndësishëm procedural. Kjo do të thotë se gjykata e apelit është gjykatë rishikuese e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë (nga pikëpamja e ligjit dhe faktit) dhe jo gjykatë e shkallës së parë për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të ATP-së, si në rastin konkret. Vetë KPC-ja, si një ligj i miratuar me shumicë të cilësuar (3/5), parashikon rastet përjashtimore kur gjykata e apelit gjykon çështjet si gjykatë e shkallës së parë (si p.sh. neni 395, pika 1, në lidhje me dhënien fuqi vendimit të gjykatës së huaj).

27. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se pavarësisht shkallës se ku iniciohet gjykimi, ligji nr. 133/2015 i garanton individit aksesin në gjykatë dhe mundësinë e ankimit ndaj vendimit të ATP-së në gjykatën e apelit, si dhe rekursin në Gjykatën e Lartë. Ndryshe nga sa pretendon gjykata referuese, ankimi ndaj vendimeve të ATP-së, në bazë të

KPC-së, nuk cilësohet si një gjykim i posaçëm. Ligjvënësi ka parashikuar një shkallë gjykimi nga pikëpamja e faktit dhe ligjit, konkretisht gjykatën e apelit, me qëllim përfundimin e procesit të kompensimit të pronave brenda një afati të arsyeshëm.

28. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin konkret, ligji nr. 133/2015 rregullon fushën e trajtimit dhe kompensimit përfundimtar të pronës, duke pasur për qëllim përfundimin e procesit të trajtimit të pronave në një kohë të arsyeshme (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndër të tjera, në nenin 29 të tij ky ligj parashikon të drejtën e ankimit të subjektit të shpronësuar kundër vendimeve të ATP-së, duke përcaktuar se “*kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë*”.

30. Po ky ligj përcakton se ATP-ja është personi juridik publik i ngarkuar për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, e cila kur shqyrton kërkesat e paraqitura nga subjektet e shpronësuar, mbledh, kontrollon dhe analizon prova e dokumente, bën interpretimin e ligjit/akteve nënligjore dhe në përfundim të shqyrtimit shprehet me vendim të arsyetuar për rrëzimin e kërkesës ose njohjen e së drejtës së pronësisë/kompensimit të pronës (neni 26 i ligjit



nr. 133/2015). Nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin për të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, brenda afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t'i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për të trajtuar kërkesën e tyre (neni 34 i ligjit nr. 133/2015).

31. Nga sa më lart, Gjykata konstaton se thelbi i nenit 29 të ligjit nr. 133/2015 është njohja e së drejtës së ankimit të subjekteve të shpronësuara kundër vendimeve të ATP-së. Në këtë mënyrë dispozita e kundërshtuar, duke u dhënë këtyre subjekteve mundësinë për të vënë në lëvizje gjykatën e apelit, përcakton jo vetëm të drejtën e ankimit të tyre kundër vendimeve të ATP-së, por tregon në të njëjtën kohë se ky ankim paraqitet pranë gjykatës së apelit sipas rregullave të KPC-së. Ndërkohë, nëse Gjykata ka vlerësuar tashmë se neni 29, i ligjit nr. 133/2015, garanton të paktën një shkallë ankimi në një gjykatë të parashikuar me ligj dhe se në këtë drejtim nuk cenohet e drejta e ankimit (shih paragrafin nr. 16 më sipër), ajo nuk është shprehur drejtpërsëdrejti në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës së apelit për të shqyrtuar ankimet e kësaj natyre.

32. Gjithashtu, Gjykata vëren se nga përmbajtja dhe objekti i ligjit nr. 133/2015 rezulton në mënyrë të qartë se qëllimi i tij nuk është përcaktimi i kompetencave dhe i funksionimit të gjykatës së apelit, por rregullimi dhe shpërblimi i drejtë i çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet, në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së. Për këtë qëllim, ligji parashikon procedurat për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, si dhe përgjegjësitë e organeve administrative të ngarkuara për realizimin e tyre.

33. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se edhe pse neni 29 i ligjit nr. 133/2015 tregon gjykatën e apelit, si gjykatë kompetente për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të ATP-së, ai nuk ka sjellë ndonjë ndryshim të kompetencës lëndore ose funksionale të gjykatës së apelit, të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të saj, të përbërjes së trupit gjykues ose të procesit të shqyrtimit gjyqësor në apel. Në vlerësimin e Gjykatës, ky ligj nuk ka parashikuar kompetenca të reja për gjykatën e apelit dhe as ndërhyrje në kompetencat ekzistuese të saj. Vetëm parashikimi në një ligj të veçantë i kompetencës së gjykatës së apelit për të shqyrtuar

ankimet ndaj vendimeve të ATP-së, për njohjen e së drejtës të subjekteve të shpronësuara, nuk duhet trajtuar si kompetencë e re, pasi shqyrtimi i ankimeve është faktikisht kompetencë e gjykatës së apelit, e cila ushtron funksionet e saj si gjykatë fakti dhe ligji.

34. Gjykata vëren se si rregull kompetenca e gjykatave përcaktohet nga KPC-ja. Konkretisht, sipas nenit 36 të KPC-së, në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë kod e në ligje të veçanta. Kjo është një dispozitë e natyrës së përgjithshme, e cila përmban një rezervë po të natyrës së përgjithshme për parashikimin e juridiksionit të gjykatave ose të mosmarrëveshjeve që hyjnë në juridiksionin e tyre edhe në ligje të veçanta. Po kështu, sipas nenit 10, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), Gjykata Administrative e Apelit shqyrton në shkallë të parë mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.

35. Nisur nga këto premisa, ndryshe nga sa pretendon gjykata referuese, Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim nuk cenohen parimet bazë të KPC-së lidhur me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatave. Përkundrazi, këto parime janë respektuar, pasi ankimi i parashikuar në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015 shqyrtohet në përputhje me rregullat e parashikuara nga KPC-ja, sikurse përcakton edhe vetë dispozita e kundërshtuar.

36. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Gjykata çmon se dispozita ligjore, në përmbajtje të nenit 29 të ligjit nr. 133/2015, garanton të drejtën e ankimit të subjekteve të shpronësuara kundër vendimeve të ATP-së dhe parashikon kompetencën lëndore të gjykatës së apelit për shqyrtimin e tij sipas rregullave të KPC-së. Ajo nuk ka përcaktuar kompetenca të reja për gjykatën referuese dhe nuk ka ndërhyrë në gjykimin që zhvillohet sipas shkallëve normale të gjykimit. Për rrjedhojë, pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar.

C.2. Për cenimin e nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës

37. Gjykata referuese ka pretenduar se shprehja “së Apelit” në përmbajtjen e nenit 29 të ligjit nr. 133/2015 bie ndesh me nenin 81, pika 2, shkronja



“d” të Kushtetutës e, për rrjedhojë, cenon parimet e ligjshmërisë dhe hierarkisë së normave të së drejtës, pasi me një ligj të zakonshëm janë zhbërë parimet bazë të KPC-së lidhur me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatave (*gjykimi sipas shkallëve normale të gjyqësorit*). Sipas saj, parashikime të kundërta me ato të KPC-së mund të bëhen vetëm nga ligje të miratuara me shumicë të cilësuar me 3/5-at e votave dhe jo me ligje të zakonshme, siç është rasti i ligjit nr. 133/2015.

38. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë parashtruar se neni 29 i ligjit nr. 133/2015 nuk cenon parimin e hierarkisë së normave të së drejtës, nuk u mohon palëve ushtrimin e kontrollit nga Gjykata e Lartë, si dhe është në harmoni me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të KPC-së. Pretendimi i gjykatës referuese se dispozita e kundërshtuar cenon nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, nuk është i bazuar.

39. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme ose me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë. Uniteti i këtij sistemi qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës së “krijuar” (*shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Gjithashtu, Gjykata ka nënvizuar dallimin që ekziston midis ligjeve organike, që miratohen me shumicë të cilësuar, dhe ligjeve të zakonshme, që miratohen me shumicë të thjeshtë. Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës ligjet organike ose të cilësuar qëndrojnë më lart se ligjet e zakonshme prandaj këto të fundit nuk mund të rregullojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet ose ligjet organike. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte vlerësuar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte. Një kategori ligjesh, për shkak të rëndësisë së tyre, miratohen nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, së pari, për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme dhe, së dyti, për të shmangur mundësinë që forca politike që do të kishte shumicën të cenonte parimet themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike (*shih vendimin nr. 77, datë 4.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Duke ndjekur të njëjtën logjikë, edhe ndryshimet që mund t'u bëhen ligjeve të

përforuara ose dispozitave të veçanta të tyre, nuk mund të arrihen nëpërmjet një ligji të thjeshtë, por me një ligj që do të kërkonte sërish të paktën tri të pestat e deputetëve. Kuvendi nuk mund të miratojë një ligj të ri ose shtesa në një ligj të mëparshëm, të cilat kërkojnë “shumicë të cilësuar”, me “shumicë të thjeshtë”, sepse në këtë mënyrë ligjet që kërkojnë “shumicë të cilësuar” mund ta humbasin rëndësinë e tyre dhe ndërhyrja do të cenonte parimin që garanton neni 81, pika 2, i Kushtetutës (*shih vendimet nr. 25, datë 5.12.2008; nr. 10, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Gjykata vëren se neni 81, pika 2, i Kushtetutës ka përcaktuar në mënyrë shteruese ligjet të cilat miratohen me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, për shkak të rëndësisë së tyre. Në shkronjën “d” të këtij neni, si ligje të cilat duhet të miratohen me shumicë të cilësuar, përcaktohen edhe kodet, ku hyjnë edhe ato procedurale që rregullojnë veprimtarinë e gjykatave. Megjithatë, Gjykata vlerëson se vetëm fakti që kodet përfshihen në përmbajtje të nenit 81, pika 2, shkronja “d”, nuk do të thotë që kjo shkronjë përmbledh në vetvete çdo ligj i cili vetëm përmend organet ose institucionet që rregullohen nga kodet, ose materializon konceptet e parashikuara në to edhe pse nuk ndërhyr në kompetencat e tyre. Në të njëjtën linjë arsyetimi, parashikimi i shprehjes gjykatë “e Apelit” në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015, nuk kërkon detyruesisht miratimin e këtij të fundit me shumicë të cilësuar, në kushtet kur, siç u tha edhe më lart, ligji nr. 133/2015 nuk ka për qëllim ndryshimin, përcaktimin ose ndërhyrjen në kompetencat e gjykatës së apelit sipas parashikimeve të KPC-së.

43. Në vështrim të kësaj analize, Gjykata konstaton se në rastin në shqyrtim neni 29 i ligjit nr. 133/2015 nuk cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Për më tepër, ky nen në thelb rregullon të drejtën e ankimit, e cila është shqyrtuar më parë nga kjo Gjykatë dhe nuk janë gjetur probleme kushtetutshmërie në drejtim të cenimit të saj (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese se dispozita e kundërshtuar bie ndesh me nenin 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës, është i pabazuar.

44. Për sa i përket pretendimit të gjykatës referuese se dispozita e kundërshtuar ndikon në zgjatjen e afateve kohore të shqyrtimit të çështjeve



kundër vendimeve të ATP-së në apel, pasi këto gjykojnë me trup gjykues prej 3 gjyqtarësh, kanë infrastrukturë të pakët për njoftimin e palëve, si dhe kanë vështirësi në planifikimin dhe gjykimin e shpejtë të çështjeve, Gjykata vlerëson se argumentet e sjella nga gjykata referuese në mbështetje të këtij pretendimi nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

45. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e gjykatës referuese në lidhje me cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës, nuk janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.2.2021.

Shpallur më 19.3.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë pro: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska,
Përparim Kalo, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja

Anëtar kundër: Altin Binaj,

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje, për sa i përket jokushtetutshmërisë për shkaqe formale dhe konkretisht cenimit të parimeve të ligjshmërisë dhe hierarkisë së normave të së drejtës të parashikuara në nenin 81/2-d të Kushtetutës, çmoj të shprehem me mendim pakice si në vijim.

2. Për këtë pretendim të kërkuarës, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar

në jurisprudencën e saj kur ka theksuar se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme ose me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë. Uniteti i këtij sistemi qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës së “krijuar” (*shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Po ashtu, Gjykata ka nënvizuar dallimin që ekziston midis kodeve dhe ligjeve organike, që miratohen me shumicë të cilësuar, dhe ligjeve të zakonshme që miratohen me shumicë të thjeshtë. Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës ligjet organike ose të cilësuar, në hierarkinë e akteve normative, qëndrojnë më lart se ligjet e zakonshme, prandaj këto të fundit nuk mund të rregullojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet ose ligjet organike. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte vlerësuar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte. Një kategori ligjesh, për shkak të rëndësisë të tyre, miratohen nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, së pari, për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme dhe, së dyti, për të shmangur mundësinë që forca politike që do të kishte shumicën të cenonte parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike (*shih vendimin nr. 77, datë 4.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Kurse për sa u përket ndërhyrjeve në ligjet që kërkojnë shumicë të cilësuar në momentin e miratimit të tyre, Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj se edhe ndryshimet që mund t'u bëhen ligjeve të përforcuara ose dispozitave të veçanta të tyre, nuk mund të arrihen nëpërmjet një ligji të thjeshtë, por me një ligj që do të kërkonte sërish të paktën tri të pestat e deputetëve. Kuvendi nuk mund të miratojë një ligj të ri ose shtesa në një ligj të mëparshëm, të cilat kërkojnë “shumicë të cilësuar”, me “shumicë të thjeshtë”, sepse në këtë mënyrë ligjet që kërkojnë “shumicë të cilësuar” mund ta humbasin rëndësinë e tyre dhe ndërhyrja do të cenonte parimin që garanton neni 81, pika 2, i Kushtetutës (*shih vendimet nr. 10, datë 6.3.2014; nr. 25, datë 5.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në kuptim të kësaj jurisprudence kushtetuese, lidhur me pretendimin e kërkuarës për cenimin e nenit 81/2-d të Kushtetutës në çështjen në shqyrtim, ka rëndësi vendimtare përcaktimi i natyrës së ndërhyrjes nga ligjvënësi, me shprehjen



“Gjykatës së Apelit”, në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015.

6. Këtë çështje e ka trajtuar edhe shumica në disa paragrafë të vendimit, duke arritur në përfundimin se formulimi në nenin 29, të ligjit nr. 133/2015, nuk ndërhyt në çështje të kompetencës së gjykatave.

7. Kurse në vlerësimin e pakicës caktimi i gjykatës së apelit në dispozitën ligjore të lartpërmendur, si gjykata që në shkallë të parë do të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të ATP-së, përbën ndërhyrje në institutin procedural civil të kompetencës lëndore të gjykatave, për arsyet që do të trajtohen më hollësisht në vijim.

8. Në modelin ligjor shqiptar, përveç parimeve të tjera, sistemi gjyqësor civil është organizuar dhe funksionon me tri shkallë, çka nënkupton që, si rregull, mosmarrëveshjet juridiko-civile shqyrtohen fillimisht në gjykatën e shkallës së parë (nenet 41 e vijues të Kodit të Procedurës Civile), kurse gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë shqyrtojnë ankimet eventuale ndaj vendimeve të shkallëve më të ulëta (nenet 442 e vijues të Kodit të Procedurës Civile), ndërkohë që është vetë ligji që parashikon rastet përjashtimore nga rregulli i mësipërm.

9. Nga ana tjetër, në legjislacionin dhe jurisprudencën shqiptare, pavarësisht nga mënyrat e interpretimit, me kompetencën gjyqësore është njohur e drejta ose pushteti që ka gjykata për të vendosur për mosmarrëveshjet juridike në fusha të caktuara dhe të paraqitura përpara saj, kurse parimet dhe rregullat për ushtrimin e kompetencave gjyqësore janë parashikuar në kodet respektive ose ligje të tjera.

10. Në kuptim të sa më sipër dhe lidhur me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve juridiko-civile, në nenin 1 të Kodit të Procedurës Civile është përcaktuar se është pikërisht ky ligj i cilësuar që përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile dhe mosmarrëveshjeve të tjera, të parashikuara në atë kod ose në ligje të tjera.

11. Pikërisht për shkak të rezervës ligjore, të parashikuar nga neni 1 i Kodit të Procedurës Civile, përveç kodit mund të parashikojnë rregulla për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile edhe ligje të tjera, por kushti në këtë rast të fundit është që ligjet e tjera të respektojnë parimet kushtetuese në momentin e miratimit të tyre.

12. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, rezulton se pavarësisht nga objekti dhe qëllimi i ligjit nr. 133/2015, në parashikimin e nenit 29 të tij është kryer një ndërhyrje në kompetencën e gjykatave, pasi vetëm nëpërmjet asaj dispozite ligjore i është caktuar gjykatës së apelit shqyrtimi në shkallë të parë i mosmarrëveshjeve përkatëse juridiko-civile, të shkaktuara nga vendimmarrja e ATP-së, ndërkohë që në mungesë të parashikimit në nenin 29 të ligjit nr. 133/2015, kompetenca natyrale për sa më sipër, bazuar në parimet e lartpërmendura të Kodit të Procedurës Civile, do të ishte e gjykatës së shkallës së parë.

13. Në këtë vështrim, pakica e vlerëson të gabuar përfundimin e shumicës, sipas të cilit: “Vetëm parashikimi në një ligj të veçantë i kompetencës së gjykatës së apelit për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të ATP-së, për njohjen e së drejtës të subjekteve të shpronësuara, nuk duhet trajtuar si kompetencë e re, pasi shqyrtimi i ankimeve është faktikisht kompetencë e gjykatës së apelit, e cila ushtron funksionet e saj si gjykatë fakti dhe ligji” (*paragrafi 33 i vendimit të Gjykatës*).

14. Në fakt, sipas rregullave të përcaktuara në nenet 442, 442/a dhe 443/1 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit është kompetente për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe jo për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të tjera të administratës publike, jashtë gjyqësorit.

15. Në këto kushte, çdo ndërhyrje ligjore për ndryshimin e rregullave dhe të parimeve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, sikurse ajo në nenin 29, të ligjit nr. 133/2015, për çështje të tilla si ajo se cila gjykatë do të shqyrtojë në shkallë të parë mosmarrëveshjet, ose si pasojë për mosparashikimin e së drejtës së ankimit gjyqësor në dy shkallë më të larta, por eventualisht vetëm në një të tillë, përbën një rregullim në fushën e kompetencës së gjykatave.

15. Për tërësinë e arsyeve që u përmendën më sipër, pakica arrin në konkluzionin se ligjvënësi ka pasur kompetencën e plotë për të përcaktuar rregullimin ligjor sipas nenit 29 të ligjit nr. 133/2015, por duke qenë se parashikimi në atë dispozitë ligjore përbën njëkohësisht edhe ndërhyrje në kompetencën e gjykatave, që është një institut i parashikuar në Kodin e Procedurës Civile, vetë ligji duhej të ishte miratuar me shumicë të



cilësuar, çka nuk do të ishte e nevojshme nëse nuk do t'i ishte caktuar gjykatës së apelit kompetenca për të shqyrtuar në shkallë të parë ankimet kundër vendimeve të ATP-së.

Anëtar: Altin Binaj

VENDIM
Nr. 8, datë 23.2.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska	anëtare e	“	“
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	“
Altin Binaj	anëtar i	“	“
Përparim Kalo	anëtar i	“	“
Sonila Bejtja	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	“

me sekretare Enina Kotoni, në datën 23.2.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 1(O)/2019 regj. them, që u përket:

KËRKUES: Osman Levanaku

SUBJEKT I INTERESUAR: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2018-217 (30), datë 13.2.2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari ka qenë i punësuar në strukturat e Policisë së Shtetit. Me urdhrin nr. 2553, datë 5.11.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ai është liruar nga detyra, për arsye të ndryshimit të strukturës organizative të Policisë së Shtetit.

2. Ky urdhër është ankimmuar nga kërkuari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 579, datë 17.2.2014, ka vendosur të pranojë pjesërisht kërkesëpadinë, duke e detyruar palën e paditur t'i paguajë kërkuarit pagën e 12 muajve si dëmshpërblim për shkak të lirimt të paligjshëm nga detyra.

3. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pas ankimit të ushtruar nga subjekti i interesuar, me vendimin nr. 163, datë 4.2.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 579, datë 17.2.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Për rekursin e ushtruar nga subjekti i interesuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2018-217(30), datë 13.2.2018, bazuar në nenin 63, shkronja “dh”, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë.

5. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 27.2.2019. Me plotësimin e kuorumit të kërkuar nga neni 31, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin paraprak të çështjeve nga Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, ky i fundit në datën 5.2.2020, ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

II
Pretendimet e palëve

6. Kërkuari Osman Levanaku, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se i janë cenuar:



6.1 E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e seancës gjyqësore, edhe pse neni 62 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore. Gjithashtu, sipas kërkesit, ai nuk është njoftuar as nga Zyra e Përmbartimit për vendimin e Gjykatës së Lartë.

6.2 Parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me ndryshimet e reja që ka passjellë ligji nr. 39/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative'", nuk mund të disponojë ndryshimin e vendimeve të ankimuara (ligji nr. 39/2017).

7. Subjekti i interesuar Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka prapësuar si vijon:

7.1 Kërkuksi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi nuk e ka paraqitur kërkesën brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000. Ndryshe nga sa pretendon kërkuksi, ai ka pasur dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 2.10.2018, kur ka marrë njoftim nga përmbartuesi privat për kthimin e shumës së përfituar, si rezultat i vendimit të kësaj të fundit.

7.2 Pretendimi i tij për mosnjoftim nga Gjykata e Lartë për zhvillimin e seancës gjyqësore nuk gjen bazueshmëri kushtetuese, për arsye se Gjykata e Lartë nuk e kryen njoftimin me "fletë-thirrje", pasi ai konsiderohet i kryer në momentin e publikimit në sistemin online të Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

8. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars të vitit 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor, të parashikuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

A. Për legjitimitimin e kërkesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një

proces kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Gjykata vlerëson se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin është dhënë vendimi objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese.

12. Për sa i përket *shterimit të mjeteve ligjore*, bazuar në parashikimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe të nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata konstaton se kërkuksi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në rastin konkret, kërkuksi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, përveç kërkesës drejtuar kësaj Gjykate, pra është përmbushur kriteri i shterimit të mjeteve për të ushtruar ankimin kushtetues individual.

13. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, individ mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit.

14. Në çështjen në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë është ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 13.2.2018, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 27.2.2019. Kërkuksi pretendon se ai ka qenë në mungesë në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, pasi nuk është njoftuar nga kjo e fundit për datën dhe orën e seancës gjyqësore. Ai ka parashtruar në kërkesë se



është vënë në dijeni të vendimit që kundërshton rastësisht në muajin dhjetor të vitit 2018, por nuk ka paraqitur provë në këtë drejtim.

15. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim rekursi nuk është paraqitur nga kërkuesi, por nga subjekti i interesuar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur ta kalojë rekursin për shqyrtim në seancë gjyqësore, me praninë e palëve, duke i njoftuar ato me shpallje. Sipas nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Ndërsa sipas nenit 62, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, vendimi i Gjykatës së Lartë që vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore, të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore. Gjykata konstaton se ndërsa neni 61, i ligjit nr. 49/2012, shprehimisht parashikon njoftimin me shpallje të datës dhe orës së seancës në dhomë këshillimi, neni 62, pika 2, i po këtij ligjit për datën dhe orën e seancës gjyqësore nuk përcakton mënyrën e njoftimit me shpallje.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike apo mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka zhvilluar gjykimin në seancë gjyqësore publike në mungesë të kërkuesit dhe në përfundim, bazuar në

nenin 63, shkronja “dh”, të ligjit nr. 49/2012, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit, si dhe rrëzimin e padisë. Nga aktet e dosjes gjyqësore konstatohet se kërkuesi, në datën 18.3.2015, është njoftuar për rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, duke u vënë kështu në dijeni të faktit që subjekti i interesuar ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs. Gjithashtu, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se në datën 29.1.2018 është shpallur data e caktimit të seancës (*data e planifikimit*) më 13.2.2018, ora 9:00. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjatë gjykimin në Gjykatën e Lartë kërkuesi ka qenë në mungesë, ndërsa subjekti i interesuar ka qenë i përfaqësuar nga përfaqësuesi me autorizim, i cili ka qenë i pranishëm dhe ka parashtruar pretendimet e tij.

18. Për sa më lart, kërkuesi ka qenë në dijeni të procesit të gjykimin të iniciuar në Gjykatën e Lartë, pasi atij i është komunikuar rekursi dhe sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka njoftuar me shpallje datën dhe orën e seancës, të paktën 15 ditë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, sipas nenit 62, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar. Megjithatë edhe pse njoftimi me shpallje është një praktikë e ndjekur nga Gjykata e Lartë, pavarësisht se, sikurse u përmend më lart, neni 62, pika 2, i ligjit të lartpërmendur nuk e parashikon shprehimisht, Gjykata është shprehur se në rastet kur kërkesa kalon për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve, sekretaria ka detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve (*shih vendimet nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin e Gjykatës kjo është e rëndësishme, sidomos në rastet, si në atë në shqyrtim, kur rekursi është bërë nga subjekti i interesuar, çështja është gjykuar në seancë gjyqësore, në mungesë të paditësit/kërkuesit, dhe vendimet gjyqësore të gjykatave më të ulëta janë ndryshuar.

19. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuesi ka qenë në dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë në datën 2.10.2018, kur ka marrë njoftim nga përmbartuesi privat për kthimin e shumës së përfutur si rezultat i vendimit të Gjykatës së Lartë. Gjykata vëren se, ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, nga aktet e paraqitura nga kërkuesi rezulton se letra e porositur e dërguar nga



përmbaruesi gjyqësor, e cila përmbante aktin përmbarimor nr. 664/16, datë 2.10.2018, mban shënimin “adresë e gabuar” dhe nuk mund të përbëjë provë për marrjen dijeni prej tij të ekzistencës së vendimit gjyqësor të kundërshtuar.

20. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuksi legjitimohet *ratione temporis* për paraqitjen e kërkesës.

21. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, për përmbajtjen e pretendimeve (*ratione materiae*) të ngritura në ankimin kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuksin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se *prima facie* pretendimet e kërkuksit hyjnë në juridiksionin e saj, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe do të shqyrtohen në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur

22. Kërkuksi pretendon se për shkak të mungesës së njoftimit të datës dhe orës së seancës nga ana e Gjykatës së Lartë, ai nuk ka mundur të marrë pjesë në gjykim, për rrjedhojë i janë cenuar edhe e drejta për t'u dëgjuar dhe e drejta për t'u mbrojtur.

23. Subjekti i interesuar ka prapësuar se Gjykata e Lartë nuk e kryen njoftim me “fletë-thirrje”, pasi ai konsiderohet i kryer në momentin e publikimit në sistemin *online* të Gjykatës së Lartë.

24. Gjykata thekson se në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo

detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 49, datë 22.7.2016; nr. 21, datë 4.4.2016; nr. 31, datë 26.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata rithekson se shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet e komentet e palës tjetër, e bën të cënueshëm procesin gjyqësor. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet e argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë civile apo penale të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra (*shih vendimin nr. 17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).



27. Në çështjen konkrete, sikurse u përmend më lart, Gjykata konstaton se vetëm njoftimi me shpallje nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, pasi ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykimi administrativ bëhet si rregull në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh (neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012), dhe në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji (neni 62 i ligjit nr. 49/2012) zhvillohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Gjykata vlerëson se gjykimi në seancë gjyqësore ka si qëllim të garantojë të drejtën e palës për t'u dëgjuar në seancën publike për shkak të veçorisë së çështjes.

29. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të marrte masat e nevojshme për t'i garantuar kërkuessit të drejtën për të marrë pjesë në gjykim, si dhe të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuessit në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Për këtë arsye, pretendimi i kërkuessit është i bazuar.

B.2. Për parimin e gjykatës së caktuar me ligj

30. Kërkuessi ka pretenduar, gjithashtu, se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me ndryshimet e reja që ka passjellë ligji nr. 39/2017, nuk mund të disponojë ndryshimin e vendimeve të ankimuara.

31. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Ajo ka nënvizuar se termi “*gjykatë*” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale

për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimin nr. 1, datë 19.1.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata vëren se përpara ndryshimeve ligjore që i janë bërë ligjit nr. 49/2012 në vitin 2017, neni 63, shkronja “dh” parashikonte: “*Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi shqyrton çështjen në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore, vendos: ... ndryshimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit*”.

33. Me ndryshimet që i janë bërë ligjit nr. 49/2012 me ligjin nr. 39/2017 (të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 7.5.2017), tashmë kjo kompetencë e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është ndryshuar. Ndërsa në lidhje me zbatimin në kohë të ligjit nr. 39/2017, Gjykata vëren se neni 11 i tij parashikon se çështjet aktualisht në gjykim në Gjykatën e Lartë do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

34. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se rekursi është paraqitur në Gjykatën e Lartë në datën 13.5.2015, pra para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 39/2017. Për rrjedhojë Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka disponuar në përputhje me kompetencat e dhëna prej ligjit të kohës.

35. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuessit nuk është i bazuar.

36. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuessit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe të së drejtës për t'u mbrojtur është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.



- Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2018-217 (30), datë 13.2.2018, të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.2.2021.

Shpallur më 19.3.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Përparim Kalo, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 11, datë 9.3.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	“
Altin Binaj	anëtar i	“	“
Përparim Kalo	anëtar i	“	“
Sonila Bejtja	anëtare e	“	“
Elsa Toska	anëtare e	“	“

me sekretare Enina Kotoni, në datën 2.3.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen me nr. 4 (P) Regj. Them., që u përket:

KËRKUESE: Partia Republikane Shqiptare

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i urdhrit nr. 633, datë 17.11.2020 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 9, 17, 18, 22, 47, 117, pika 1, 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; nenet 27-31 dhe 49 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, që kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, që parashtroi se nuk mund të shprehet për aktet nënligjore të nxjerra nga ekzekutivi, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja është parti politike e miratuar dhe e regjistruar me urdhrin nr. 16/2, datë 10.1.1991 të ministrit të Drejtësisë. Ajo është përfshirë në procesin e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të datës 25 prill 2021.

2. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nëpërmjet urdhrit nr. 633, datë 17.11.2020 (urdhri nr. 633/2020), ka urdhëruar: “1. Të ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore, deri në një urdhër të dytë; 2. Pika 4 e urdhrit nr. 351, datë 29.5.2020, “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, të ndryshuar, shfuqizohet; 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.”.

3. Në fund të urdhrit është disponuar shprehimisht se ai hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Urdhri nr. 633/2020 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 210, datë 2.12.2020.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

4. **Kërkuësja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e urdhrit nr. 633/2020 me pretendimin se ai bie ndesh me parimet, të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura



nga Kushtetuta dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, pasi cenon:

4.1 *Nenin 9 të lidhur me nenin 18 të Kushtetutës*, pasi ndalon aktivitetin politik të saj dhe të partive të tjera opozitare, si dhe përmbushjen e rolit të tyre kushtetues si parti politike në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve. Ai ndalon zhvillimin e mbledhjeve partiake dhe të tubimeve, tërësisht, pa asnjë dallim. Në periudhën parazgjedhore urdhri ka kufizuar shanset e barabarta konkurruese që duhet të kenë partitë politike dhe ka krijuar situatë të pabarabartë për partitë politike të opozitës, pasi sjell avantazh për Partinë Socialiste, e cila, si parti në pushtet, ka më shumë vizibilitet dhe mundësi për të bërë fushatë në kuadër të ushtrimit të funksioneve të rëndësishme publike. Kufizimi që vendos akti i kundërshtuar nuk është proporcional edhe për shkak se ndalimi i mbledhjeve partiake dhe i tubimeve nuk përbën mjetin më të përshtatshëm dhe të nevojshëm për të arritur qëllimin e mospërhapjes së COVID-19.

4.2 *Nenin 47 (liria e tubimeve) të lidhur me nenin 22 (liria e shprehjes) të Kushtetutës*, pasi ndalon tërësisht tubimet dhe mbledhjet partiake, duke kufizuar mundësinë e anëtarëve të partive politike opozitare për t'u mbledhur dhe për të shkëmbyer idetë e tyre. Organizimi i zgjedhjeve demokratike është vetë thelbi i demokracisë, e cila është e pamundur nëse nuk respektohen liritë e shprehjes, të tubimit dhe të organizimit të partive politike.

4.3 *Parimin e proporcionalitetit*, për shkak të paqartësisë në kohëzgjatjen e masave kufizuese. Urdhri duhet të kishte një kohëzgjatje të përcaktuar për zbatimin e tij, afat i cili duhet të përfundonte përpara fillimit të fushatës zgjedhore. Ky urdhër duhet të rishikohej për të shmangur problemin e proporcionalitetit dhe për të marrë në konsideratë kontekstin e fushatës zgjedhore.

4.4 *Nenin 117, pika 1, të Kushtetutës*, pasi është zbatuar në datën 21.11.2020, përpara botimit në Fletoren Zyrtare nr. 210, datë 2.12.2020.

5. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë***, prapësoi me shkrim si vijon:

5.1. Kuvendi nuk mund të shprehet për rregullimet konkrete të miratuara me akte nënligjore të nxjerra nga pushteti ekzekutiv. Neni 118 i Kushtetutës lejon organin ligjvënës t'u delegojë organeve të tjera të pushtetit publik kompetencën e nxjerrjes së akteve me natyrë *quasi* legislative. Llojet e akteve nënligjore përcaktohen

nga ligji nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe një prej tyre është edhe urdhri i ministrit, i cili ka karakter të brendshëm dhe mund të vendosë rregulla sjelljeje të përgjithshme ose mund të rregullojë një marrëdhënie konkrete. Për pasojë, urdhri i kundërshtuar është nxjerrë në bazë të delegimit që i ka dhënë Kushtetuta dhe ligji.

6. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke prapësuar si vijon:

6.1 *Roli kushtetues i kërkuarës (neni 9 i Kushtetutës)* nuk cenohet në mënyrë disproporcionale. Aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe të MSHMS-së janë miratuar në përgjigje të situatës së krijuar nga COVID-19 dhe parashikojnë detyrime të njëjta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë. Urdhri nr. 633/2020 nuk përmban favorizime ose privilegje për grupe të caktuara, aq më pak për ndonjë subjekt politik. Ky urdhër nuk i ndalon partitë politike të ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet komunikimit *online* dhe me anë të mjeteve të tjera që nuk cenojnë shëndetin e individëve. Argumenti se partia në pushtet ka më shumë vizibilitet dhe mundësi për të bërë fushatë, është i pabazuar, pasi urdhri nr. 633/2020 ndalon të gjitha tubimet dhe mbledhjet partiake për çdo parti politike pa asnjë dallim.

6.2 *Liria e shprehjes (neni 22 i Kushtetutës)*, e cila mbrohet edhe nga neni 10, pika 2, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), është prekur nga pandemia. Megjithatë, urdhri nr. 633/2020 nuk ndalon realizimin e aktiviteteve *online*, ku pjesëmarrësit mund të shprehin mendimet e tyre bashkërisht me të tjerët dhe në të njëjtën kohë të mbrojnë shëndetin e tyre dhe të komunitetit.

6.3 *Liria e mbledhjeve dhe tubimeve (neni 47 i Kushtetutës)* nuk cenohet, pasi urdhri nr. 633/2020 lejon grumbullimet deri në 10 persona. Në praktikë, organet ligjzbatuese nuk kanë vendosur gjoba për mbledhje partiake ose tubime me pjesëmarrje deri në 10 persona. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pranuar se subjektet politike mund të bëjnë fushatë edhe nga shtëpia, falë evolucionit të metodave të komunikimit *online*. Kufizimi i vendosur është i përkohshëm deri në një urdhër të dytë dhe mund të ndryshojë nëse situata epidemiologjike përmirësohet.



7. **Subjekti i interesuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, në seancë gjyqësore, iu bashkua prapësimeve të Këshillit të Ministrave, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

8. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve normative me Kushtetutën. Në rastin në shqyrtim, kërkesja, Partia Republikane Shqiptare, ka vënë në lëvizje Gjykatën për kontrollin e kushtetutshmërisë së urdhrit nr. 633/2020. Prandaj, fillimisht, Gjykata do të analizojë natyrën e aktit të kundërshtuar.

9. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se një akt ka karakter normativ kur vendos norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektsh (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur nga ky këndvështrim, si dhe nga përmbajtja e urdhrit nr. 633/2020, Gjykata vlerëson se ai ka karakter normativ.

10. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se natyra e pretendimeve të ngritura para saj është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje dhe se, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, ajo e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës duke pretenduar se urdhri nr. 633/2020 ka cenuar në mënyrë disproporcionale rolin kushtetues të saj në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve, lirinë e tubimit dhe atë të shprehjes. Në vlerësimin e Gjykatës, pretendimet e kërkuarës janë të natyrës kushtetuese. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh karakterin normativ të aktit të kundërshtuar dhe natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura nga kërkesja, Gjykata çmon se çështja, sipas objektit të kërkesës, hyn në juridiksionin e saj.

B. Për legjitimitimin e kërkuarës

12. Çështja e legjitimitimit të kërkuarës (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Partitë politike,

bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “gj” dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 3, shkronja “d” dhe pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, janë subjekte që mund të paraqesin kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën. Gjithsesi, në gjykime të kësaj natyre, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

13. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, demokracia përfaqësuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion i veçantë që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet, përcakton njëkohësisht dhe interesin e tyre për të pasur një legjislacion dhe rregulla sa më të qarta e të drejta (*shih vendimin nr. 1, datë 7.1.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin në shqyrtim kërkesa është paraqitur nga Partia Republikane Shqiptare, e cila është një person juridik, i regjistruar si parti politike që në vitin 1991. Sikurse u përmend më lart, ajo ka pretenduar se urdhri nr. 633/2020 cenon në mënyrë disproporcionale rolin kushtetues të saj në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve, lirinë e tubimit dhe atë të shprehjes. Për pasojë, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis* të kërkuarës, sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Rezulton se urdhri nr. 633/2020 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 210, datë 2.12.2020 dhe kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur në datën



4.12.2020, pra menjëherë pas hyrjes në fuqi të tij, që do të thotë brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

16. Për sa u përket pretendimeve të kërkuases në aspektin *ratione materiae*, ato *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës dhe do të vlerësohen në vijim prej saj.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e veprimtarisë së partisë politike (neni 9 i Kushtetutës) në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit (neni 18 i Kushtetutës)

17. Kërkuësja ka pretenduar se urdhri nr. 633/2020, në shkellje të neneve 9 dhe 18 të Kushtetutës, ka cenuar në mënyrë disproporcionale rolin kushtetues të saj në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve. Ai ndalon tërësisht zhvillimin e mbledhjeve partiake, pa asnjë dallim, specifikim ose saktësim, që passjell ndalim efektivisht të aktivitetit politik të partive opozitare në tërësi dhe të kërkuases në veçanti. Duke ndaluar aktivitetin politik të saj dhe të partive të tjera opozitare, akti, objekt shqyrtimi, ka kufizuar shanset e barabarta që duhet të kenë partitë politike në konkurrimin zgjedhor. Si barazia e votës, ashtu edhe barazia e konkurruesve në zgjedhje janë të domosdoshme për realizimin e një procesi zgjedhor të drejtë. Ky akt krijon një situatë të pabarabartë mes partive politike në fushatën parazgjedhore dhe zgjedhore, në cenim të nenit 18 të Kushtetutës, duke sjellë avantazh për Partinë Socialiste, e cila si parti në pushtet ka më shumë vizibilitet dhe mundësi për të bërë fushatë në kuadër të ushtrimit të funksioneve të rëndësishme publike, siç janë aktivitetet ministrore, të Kryeministrit ose të deputetëve. Kufizimi që vendos akti i kundërshtuar nuk është proporcional edhe për shkak se ndalimi tërësor i aktiviteteve të partive politike nuk përbën mjetin më të përshtatshëm dhe të nevojshëm për të arritur qëllimin e mospërhapjes së COVID-19. Në kushtet kur aktiviteti i Kuvendit është lejuar për sa kohë respektohen distancimi fizik dhe mbajtja e maskave, këto rregulla mund të zbatohen edhe në rastet e tubimeve politike. Pra, lejimi i tubimeve politike, duke respektuar rregullat e vendosjes së maskave dhe distancimit fizik, do të përbënte, sipas kërkuases, mjetin më të përshtatshëm dhe proporcional në rastin konkret për arritjen e qëllimit të përballimit të pandemisë.

18. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se mbrojtja e shëndetit dhe jetës së individëve nga COVID-19, si dhe pasojat që vijnë

prej tij, është domosdoshmëri dhe detyrim i përgjithshëm i shteteve, bazuar në KEDNJ. Në këtë kuadër, pas shpalljes së gjendjes së pandemisë nga OBSH-ja, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë një sërë aktesh normative në përgjigje të situatës së krijuar. I gjithë kuadri ligjor dhe nënligjor, i miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe MSHMS-ja, parashikon detyrime të njëjta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë dhe, ndryshe nga sa pretendon kërkuësja, urdhri nr. 633/2020 nuk përmban favorizime ose privilegje për grupe të caktuara, e aq më pak për ndonjë subjekt politik. Ky urdhër nuk i ndalon partitë politike të ushtrojnë veprimtarinë në përmbushje të misionit të tyre nëpërmjet komunikimit *online* dhe me anë të mjeteve të tjera që janë të lejueshme, që nuk cenojnë shëndetin e individëve. Argumenti i kërkuases se partia në pushtet ka më shumë vizibilitet dhe mundësi për të bërë fushatë është i pabazuar.

19. Gjykata vë në dukje se me dekretin nr. 11700, datë 6.9.2020, Presidenti i Republikës, ka caktuar se “zgjedhjet për Kuvendin të zhvillohen ditën e diel, më datë 25 prill 2021”, ndërkohë që në kohën e marrjes në shqyrtim të kësaj çështjeje, bazuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor, kanë filluar përgatitjet për procesin zgjedhor, janë regjistruar partitë politike dhe subjektet zgjedhore, si dhe vendi është në prag të fushatës zgjedhore. Nga ana tjetër, urdhri nr. 633/2020, objekt shqyrtimi, mban datën 17.11.2020 dhe është në fuqi, pasi nuk ka dalë ende një urdhër i dytë.

20. Gjykata ka çmuar se partitë politike luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin demokratik pluralist, pasi kontribuojnë në shfaqjen e vullnetit politik të popullit përmes pjesëmarrjes në zgjedhje dhe ndihmojnë në realizimin e sovranitetit të tij. Falë këtyre funksioneve ato kanë status kushtetues dhe konsiderohen elemente të domosdoshme të jetës politike (*shih vendimin nr. 28, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Pluralizmi është një tërësi rrethanash, ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme. Pushteti i përfaqësuesve kufizohet nga Kushtetuta dhe



mekanizma të tjerë të balancimit dhe kontrollit të pushteteve. Problemet e përfaqësimit të drejtë janë çështje të shanseve të barabarta që zëri i gjithkujt të dëgjohet ose të jetë i përfaqësuar. Neni 3 i Kushtetutës parashikon pluralizmin si një nga bazat e shtetit, ndërsa neni 1, paragrafi 3 i saj sanksionon parimin e barazisë së votës. Ky parim ka komponentin e tij aktiv (e drejta për të votuar) dhe atë pasiv (e drejta për t'u votuar/zgjedhur). Gjykata thekson se parimi i barazisë të së drejtës për t'u votuar/zgjedhur ndalon shtetin të diskriminojë ose të privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në përballjen konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit. Barazia në çështjet zgjedhore përfshin shumë aspekte. Parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë barazia në votën numerike, barazia për sa i përket fuqisë zgjedhore dhe mundësive të barabarta (*shih vendimin nr. 32, datë 21.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka vlerësuar se midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë. Në veçanti, kërkesa për asnjësi zbatohet për fushatën zgjedhore, e cila mund të realizohet si në formën e një barazie “strikte”, ashtu edhe të barazisë “proporcionale”. Sipas barazisë “strikte”, partitë politike trajtohen pa marrë në konsideratë forcën e tyre aktuale në Kuvend ose të zgjedhësve, ndërsa sipas barazisë “proporcionale”, trajtimi i partive bëhet në raport me numrin e votave. Disa forma mbështetjeje mund t'u nënshtrohen, nga një anë, barazisë strikte dhe, nga ana tjetër, barazisë proporcionale (*shih vendimin nr. 32, datë 21.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke qenë se qëllimi kryesor i partive politike është marrja e pushtetit me mjete dhe mënyra demokratike, elementi kryesor që karakterizon veprimtarinë politike të partive është konkurrenca midis tyre. Konkurrimi i lirë është shprehje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të një shoqërie demokratike dhe bazohet edhe në faktin që për të gjitha partitë politike zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara më parë. Këto rregulla bazohen në parimin e mosdiskriminimit, të mostrajimit preferencial të disa partive ndaj disa të tjerave, duke u dhënë atyre mundësi të njëjta në konkurrimin politik. Çdo kufizim në barazinë e palëve në konkurrimin elektoral nuk mund të arrijë

deri në atë masë që të bëjë të pamundur vetë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrim (*shih vendimin nr. 28, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në koncept, parimi i konkurrimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë (*shih vendimin nr. 32, datë 21.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se urdhri nr. 633/2020 ka ndaluar, ndër të tjera, grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura ose të hapura, tubimet dhe mbledhjet partiake deri në një urdhër të dytë. Kërkuesja ka pretenduar se ky akt ka paqartësi në tekstin e tij, pasi mënyra e formulimit ndalon tërësisht tubimet dhe mbledhjet partiake, pavarësisht numrit të personave, duke krijuar një situatë pabarazie mes partive politike në fushatën parazgjedhore dhe zgjedhore. Ndërsa subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se akti parashikon detyrime të njëjta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë dhe është i qartë në përmbajtjen e tij. Ai duhet kuptuar se lejon çdo lloj grumbullimi deri në 10 persona, duke përfshirë edhe tubimet dhe mbledhjet partiake.

26. Gjykata thekson se si rregull hartimi i akteve nënligjore në mënyrë të shkurtuar dhe të përmbledhur, pa një pjesë hyrëse dhe pa raporte shpjeguese që i shoqëron ato, e bën më të vështirë vlerësimin nëse një kufizim i veçantë i të drejtave përmbush parimet dhe standardet kushtetuese dhe kjo situatë përkeqësohet kur rregullat ndryshojnë shpesh ose kur qasjet janë *ad hoc*. Në këtë drejtim, urdhri i kundërshtuar duhet të arsyetonte përse disa veprimtari janë grupuar së bashku (tubimet, mbledhjet partiake dhe ceremonitë familjare) dhe trajtohen ndryshe nga disa veprimtari të tjera, që përfshijnë grumbullime personash dhe që nuk mbulohen nga ky urdhër.



27. Pavarësisht se urdhri i kundërshtuar nuk përmban elementet e cituara më lart, që do të ndihmonin në eliminimin e çdo dyshimi për saktësinë e përmbajtjes së tij, Gjykata çmon se ai duhet kuptuar se lejon grumbullimet e çfarëdo lloji deri në 10 persona, duke përfshirë lejimin e mbledhjeve partiake deri në 10 persona dhe të tubimeve deri në 10 persona. I kuptuar në këtë mënyrë, kufizimi që ai vendos nuk cenon barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor dhe nuk sjell pasoja diferencuese e as trajtim preferencial për parti të caktuara. Të gjitha partitë politike, pa dallim, janë të detyruara të respektojnë kufizimin e vendosur nga akti i kundërshtuar dhe organet kompetente për dhënien e masave administrative duhet t'i zbatojnë ato njëjloj për të gjitha partitë politike. Rrjedhimisht, nuk mund të thuhet se pjesëmarrja e partive politike në zgjedhje në kushte të barabarta cenohet për shkak të mënyrës së formulimit të urdhrit nr. 633/2020.

28. Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata vlerëson se kërkesja nuk ka arritur të provojë pretendimin e saj se kufizimi ndalon veçanërisht veprimtarinë politike të saj dhe të partive opozitare, me argumentin se partia në pushtet ka avantazh dhe vizibilitet më të madh për të bërë fushatë, pasi ka mundësi të ushtrojë tërthorazi, në interes të fushatës, funksionet e rëndësishme publike të përfaqësuesve të saj në pushtetin ekzekutiv. Për më tepër, për sa i takon ushtrimin të funksioneve të larta publike dhe efekteve të tyre në fushatën zgjedhore, Gjykata vë në dukje se e drejta kushtetuese e barazisë midis partive politike gjatë fushatës zgjedhore garantohet në mënyrë të posaçme nga Kodi Zgjedhor. Ky kod, bazuar, ndër të tjera, në parimet e votimit të lirë dhe të barabartë, si dhe në lirinë e subjekteve zgjedhore për shpalljen e programeve të tyre në çdo formë e mënyrë të ligjshme (neni 3), cakton rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet (neni 1). Pjesë e rëndësishme e këtyre rregullave janë ndalimet specifike për funksionarët publikë dhe institucionet publike gjatë fushatës zgjedhore (shih ndër të tjera nenet 3, pikat 7 e 8, 78, pika 6 dhe 80, pika 4). Gjithashtu, Gjykata vëren se Kodi Zgjedhor jo vetëm garanton barazinë e partive politike në procesin zgjedhor, por mbi bazën e tij janë ngritur

organe të posaçme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Kolegji Zgjedhor, të cilat, sipas kompetencave respektive kanë përgjegjësinë të garantojnë në praktikë këtë barazi, si dhe të zgjidhin mosmarrëveshjet e ndryshme që mund të lindin, duke vendosur edhe sanksionet përkatëse sipas ligjit.

29. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e veprimtarisë së partisë politike (neni 9 i Kushtetutës) në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit (neni 18 i Kushtetutës), nuk është i bazuar.

C.2. Për cenimin e lirisë së tubimit (neni 47 i Kushtetutës) në lidhje me lirinë e shprehjes (neni 22, pika 1, i Kushtetutës)

30. Kërkesja ka pretenduar se akti i kundërshtuar cenon lirinë e shprehjes (neni 22, pika 1, i Kushtetutës), pasi duke ndaluar aktivitetet dhe mbledhjet partiake ka kufizuar mundësinë e anëtarëve të partive politike opozitare për t'u mbledhur dhe për të shkëmbyer idetë e tyre. Gjithashtu, kërkesja ka pretenduar se akti i kundërshtuar cenon lirinë e mbledhjes dhe të tubimeve (neni 47 i Kushtetutës), për arsye se organizimi i zgjedhjeve demokratike dhe, për pasojë, vetë thelbi dhe ekzistenca e demokracisë është i pamundur pa respektuar, ndër të tjera, lirinë e shprehjes dhe të shtypit, si dhe lirinë e tubimit dhe të organizimit të partive politike.

31. Ndërsa subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se edhe pse urdhri i dalë për shkak të pandemisë ka prekur lirinë e shprehjes, ai nuk ndalon realizimin e aktiviteteve *online*, ku pjesëmarrësit jo vetëm mund të shprehin mendimet e tyre, por mund t'i shprehin ato bashkërisht me të tjerët dhe në të njëjtën kohë të mbrojnë shëndetin e tyre dhe të komunitetit. Pretendimi i kërkuar se urdhri i kundërshtuar, në pikën 1 të tij, ndalon tërësisht mbledhjet dhe tubimet politike nuk qëndron, pasi akti në fjalë lejon mbledhjet partiake dhe tubimet deri në 10 persona. Edhe në praktikë zbatimi i urdhrit ka qenë i tillë. Organet ligjzbatuese nuk kanë vendosur gjopa për mbledhje ose tubime partiake me pjesëmarrje deri në 10 persona. Kufizimi i vendosur është i përkohshëm për gjendjen aktuale, deri në një urdhër të dytë, i cili mund të ndryshojë masën kufizuese nëse situata epidemiologjike përmirësohet.



32. Neni 22, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria e shprehjes është e garantuar dhe ajo përbën një nga gurët themelore të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është, gjithashtu, bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore (*shih vendimet nr. 56, datë 27.7.2016; nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Edhe GJEDNJ-ja ka vënë në pah rëndësinë e lirisë së shprehjes. Në interpretimin që i ka bërë nenit 10 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka pohuar se “liria e shprehjes përbën një prej bazave thelbësore të shoqërisë (demokratike), një prej kushteve themelore për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo individi” (*shih Handysyde kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 dhjetor 1976, § 49*). Duke pasur në fokus rolin kyç të medias së pavarur gjatë fushatës zgjedhore, nën dritën e lirisë së shprehjes, GJEDNJ-ja është shprehur se veçanërisht diskutimi i kandidatëve dhe i programeve të tyre kontribuon për të drejtën e publikut për të marrë informacion dhe për të fuqizuar mundësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të informuara midis kandidatëve në garë (*shih Orlonskaya Iskra kundër Rusisë, 3 korrik 2017, § 130*).

34. Po ashtu, duke interpretuar lirinë e shprehjes në kontekstin e lirisë së shtypit, GJEDNJ-ja ka theksuar se ajo i ofron publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe formuar një mendim për idetë dhe qëndrimet e udhëheqësve të tyre politikë. Në mënyrë më të përgjithshme, liria e debatit politik qëndron pikërisht në thelbin e konceptit të një shoqërie demokratike, e cila mbizotëron në të gjithë Konventën (*shih Lingens kundër Austrisë, 8 korrik 1986, § 42*). Në një shoqëri të tillë, që bazohet në sundimin e ligjit, ideve politike të cilat sfidojnë rendin ekzistues dhe realizimi i të cilave mbështetet në mjete paqësore, duhet t'u jepet një mundësi e duhur shprehjeje nëpërmjet së drejtës së organizimit. Kjo kërkohet nga vlerat e qenësishme të një sistemi demokratik, siç janë pluralizmi, toleranca dhe kohezioni social (*shih Egitim dhe Bilim*

Emekçileri Sendikası kundër Turqisë, 25 dhjetor 2012, § 70).

35. Duke iu referuar standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se edhe pse liria e shprehjes është një e drejtë e veçantë, në situata të ndryshme ajo paraqitet e lidhur ngushtë me të drejta të tjera themelore dhe se kufizimi i njërës prej tyre, prek për shkak të lidhjes, edhe të drejtat e tjera. Në këtë mënyrë, në rastin në gjykim, Gjykata konstaton se liria e shprehjes paraqitet e ndërthurur me lirinë e tubimit dhe me të drejtën e votës.

36. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to, garantohet në nenin 47, pika 1, të Kushtetutës. Kjo liri nuk kufizohet nga qëllimi i tubimit, mjafton që ai të jetë paqësor. Termi “tubim” përkufizohet nga ligji nr. 8773, datë 23.4.2001, “Për tubimet” (*ligji nr. 8773/2001*) dhe përfshin grumbullimet, manifestimet, mbledhjet dhe parakalimet me karakter paqësor dhe pa armë, në të cilat një grup personash shprehin kërkesat dhe pikëpamjet e tyre për probleme për të cilat janë të interesuar dhe përfshin edhe tubimet urgjente (neni 2, pika 5).

37. GJEDNJ-ja në praktikën e saj ka pranuar se e drejta e tubimit paqësor është themelore në një shoqëri demokratike e, për rrjedhojë, nuk duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtuar (*shih Kudrevičius dhe të tjerë kundër Lituanisë, 15 tetor 2015, § 91*). Kjo e drejtë mbulon si mbledhjet private, ashtu edhe mbledhjet në vende publike, qofshin të palëvizshme ose në formë procesioni. E drejta ushtrohet si nga pjesëmarrësit individualë, ashtu edhe nga personat që e organizojnë tubimin (*shih Djavit An kundër Turqisë, 20 shkurt 2003, § 56*).

38. Në kontekstin e nenit 11, GJEDNJ-ja i është referuar shpesh rolit thelbësor që luajnë partitë politike në sigurimin e pluralizmit dhe të demokracisë, duke pranuar se edhe organizatat e formuara për qëllime të tjera janë gjithashtu të rëndësishme për funksionimin e demokracisë. Është e natyrshme që kur një shoqëri civile funksionon në mënyrë të shëndetshme, pjesëmarrja e qytetarëve në procesin demokratik arrihet në një masë të madhe përmes përkatësisë në shoqata në të cilat ata mund të integrohen me njëri-tjetrin dhe të ndjekin objektivat e përbashkët kolektivisht (*shih Gorzelik dhe të tjerët kundër Polonisë, 17 shkurt 2004, § 92*).

39. Mbrojtja e mendimeve dhe liria e shprehjes së tyre, të garantuara nga neni 10 i Konventës,



është një nga objektivat e lirisë së tubimit dhe organizimit, të parashikuara në nenin 11 të saj. Kjo zbatohet më tepër në lidhje me partitë politike në drejtim të rolit thelbësor të tyre për të siguruar pluralizmin dhe funksionimin e duhur të demokracisë (*shih Partia e Lirisë dhe Demokracisë (ÖZDEP) kundër Turqisë, 8 dhjetor 1999, § 37*).

40. GJEDNJ-ja është shprehur se liria e tubimit nuk është absolute; ajo mund të kufizohet në përputhje me paragrafin 2 të nenit 11 të Konventës. Ndërhyrja mund të mos jetë një ndalim i plotë, ligjor ose *de facto*, por mund të konsistojë në masa të tjera të ndryshme të marra nga autoritetet (*shih Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë, 15 tetor 2015, § 100*). Gjithashtu, një ndërhyrje në lirinë e tubimit paqësor përbën shkelje të nenit 11, përveçse kur është “parashikuar nga ligji”, ndjek një ose më shumë “qëllime legjitime”, sipas paragrafit 2 të nenit 11 dhe është “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për të arritur qëllimin ose synimet në fjalë (*shih Vyerentsov kundër Ukrainës, 11 prill 2013, § 51*).

41. Në zbatim të parimit themelor të parashikuar nga neni 1, pika 3, i Kushtetutës, sipas të cilit qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike, neni 45 i Kushtetutës garanton të drejtën vetjake të votës të barabartë dhe të lirë. Në kontekstin e çështjes për gjykim, e drejta e votës lidhet ngushtë me liritë e tubimit dhe të shprehjes si kërkesë e shtetit të së drejtës, në drejtim të zhvillimit të zgjedhjeve të lira e të barabarta, të cilat realizohen kur individët votojnë në mënyrë të informuar për alternativën dhe programet politike të subjekteve zgjedhore. Ndërthurja e këtyre të drejtave konfirmohet edhe nga neni 3 i Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili duke garantuar një parim të demokracisë parashikon se “*Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës*”.

42. Duke i zbatuar standardet e mësipërme në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se urdhri nr. 633/2020 ka vendosur një kufizim të lirisë së tubimit dhe bashkë me të edhe të lirisë së shprehjes në mënyrë kolektive, që do të materializohej gjatë zhvillimit të tubimit për të informuar zgjedhësit. Këto kufizime të të drejtave kushtetuese Gjykata i vlerëson në aspektin e respektimit të kriterëve të

vendosura nga neni 17 i Kushtetutës, i cili është testi që duhet të gjejë zbatim në çdo ndërhyrje në të drejtat dhe liritë themelore të individit, sipas praktikës së konsoliduar të Gjykatës. Sipas këtij neni “kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ”.

43. Në vijim Gjykata do të analizojë nëse janë përmbushur kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, me referencë te liria e tubimit, duke qenë se urdhri i kundërshtuar disponon drejtpërsëdrejti mbi këtë liri. Vlerësimi i Gjykatës për lirinë e tubimit mbulon edhe dy liritë e tjera, meqë ato, sikurse u shpjegua më lart, janë të lidhura ngushtë me të.

C.2.1 Për kriterin e kufizimit me ligj

44. Sipas nenit 17 të Kushtetutës, kriteri i parë për t’u analizuar është që të drejtat dhe liritë e individit mund të kufizohen vetëm me ligj. Qëllimi i këtij kriteri është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe për këtë shkak, kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht organi më i lartë ligjvënës. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në çmim vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Konteksti në të cilin është përdorur togfjalëshi “vetëm me ligj” nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta. Gjykata Kushtetuese çmon se rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret, që në këtë rast është vetëm Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 20, datë 11.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Neni 118, pika 1, i Kushtetutës sanksionon se “aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim



të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë”. Ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni parashikon: “Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.”. Këto dispozita ndihmojnë për t’i dhënë kuptimin kushtetues dhe doktrinar konceptit “rezervë ligjore”, nëpërmjet të cilit kufizohet ose orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Kjo rezervë ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetutshmërisë. Gjykata në disa raste e ka konsideruar veprimin e qeverisë për nxjerrjen e akteve nënligjore si cenim të kufijve të rezervës ligjore kur ligji nuk ka bërë asnjë delegim tek ekzekutivi për të rregulluar një çështje konkrete (rezervë ligjore absolute) ose kur ekzekutivi ka rregulluar çështje të tjera nga ato që i ka deleguar ligjvënësi (rezerva ligjore relative). Në rastin e rezervës ligjore relative, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat, nga njëra anë, e detyrojnë ligjvënësin t’u përmbahet atyre në mënyrë rigorozë dhe, nga ana tjetër, orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 12, datë 28.4.2009; nr. 24, datë 24.7.2009; nr. 17, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se është e nevojshme të analizohet nëse në rastin konkret kufizimi është bërë me ligj, si dhe nëse materializimi në urdhrin nr. 633/2020 është bërë në përputhje me rezervën ligjore relative.

47. Qasja që kanë ndjekur autoritetet publike në Shqipëri, në marrjen e masave parandaluese ndaj përhapjes së COVID-19, është që në hartimin e strategjive dhe të masave të posaçme janë mbështetur në një masë të konsiderueshme në këshillat e ekspertëve, duke ngritur edhe një Komitet Teknik të posaçëm. Nga ana tjetër, kjo qasje, e ndërthurur me kërkesën kushtetuese që kufizimet e të drejtave themelore të kufizohen me ligj, rrezikon të zbehë rolin thelbësor të Kuvendit

në aspektin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, i cili ka rëndësi jetike për shtetin ligjor dhe demokracinë. Po ashtu, për shkak të rëndësisë së situatës së shkaktuar nga pandemia, edhe pritshmëritë e qytetarëve kërkojnë një përfshirje të Kuvendit në një masë më të lartë në rregullimin ligjor të të drejtave të tyre dhe në monitorimin e situatës. Për të adresuar këtë shqetësim, një praktikë e mirë do të ishte që autoritetet publike t’i justifikonin publikisht aktet nënligjore, duke dhënë detaje për shkakun, objektin dhe qëllimin, që në një term të vetëm nënkupton *ratio legis*, si dhe duke vënë në dispozicion të publikut informacionin e duhur. Kjo lloj praktike përfshin edhe informacionin se si kufizimet janë në përputhje me kërkesat e parimeve kushtetuese të ligjshmërisë, barazisë dhe proporcionalitetit. Kjo, gjithashtu, mund të përfshijë edhe arsyet se përse disa veprimtari grupohen së bashku, ndërsa disa të tjera trajtohen ndryshe. Po ashtu, raportimi periodik përpara legjislativit i autoriteteve publike që marrin këto masa kufizuese është një praktikë tjetër e mirë, që i shërben shtetit të së drejtës, në të cilin pushteti legjislativ, ndër të tjera, kontrollon dhe garanton përgjegjshmërinë e organeve të ekzekutivit.

48. Në çështjen në shqyrtim, akti i kundërshtuar është bazuar në ligjin nr. 15/2016, datë 10.3.2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” (*ligji nr. 15/2016*), neni 4 i të cilit parashikon parimet për parandalimin dhe eliminimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive. Ndërsa neni 7 i po të njëjtut ligj autorizon ministrin përgjegjës për shëndetësinë të miratojë me urdhër masa të veçanta për të mbrojtur popullatën nga sëmundjet infektive që kanë impakt të madh në shëndetin e saj. Konkretisht, në këto masa përfshihen edhe: kufizimi ose ndalimi i udhëtimeve në vendin ku është përhapur epidemia nga këto sëmundje; kufizimi ose ndalimi i qarkullimit në rajonet e infektuara ose të rrezikuara; *mbyllja e aktiviteteve jopublike apo publike; anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura*; kufizimi i lëvizjeve brenda vendit.

49. Nga ana tjetër, edhe ligji nr. 8773/2001, në nenet 1, pika 2, 16, 17 dhe 18 të tij parashikon se e drejta e tubimit kufizohet në rast se rrezikohet, *inter alia*, ruajtja e shëndetit ose mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të të tjerëve.

50. Për sa më sipër, Gjykata çmon se në kuadrin e masave të veçanta që merren për të mbrojtur



popullatën nga sëmundjet infektive, me impakt të madh, kufizimi i së drejtës së tubimit, i lidhur me lirinë e shprehjes, në rastin konkret është i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 15/2016, në formën e anulimit të grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura. Urdhri nr. 633/2020 ka dalë për të bërë të zbatueshëm këtë dispozitë ligjore dhe, për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nuk ka shkelje të kriterit të kufizimit “me ligj”, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

C.2.2 Për kriterin e interesit publik

51. Kriteri i dytë në radhë për t’u vlerësuar për kufizimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese, sipas nenit 17 të Kushtetutës, është ekzistenca e interesit publik ose mbrojtja e të drejtave të të tjerëve.

52. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar tashmë në disa raste nga kjo Gjykatë, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese rastet e interesit publik ose të arsyes publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 10, datë 19.3.2008; nr. 18, datë 14.5.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Edhe KEDNJ-ja, në nenin 11, pika 2, liston “qëllimet legjitime”, të cilat duhet të përmbushë një “ndërrhyrje” që kufizon të drejtën e tubimit paqësor, të cilat janë: siguria publike ose siguria kombëtare, mbrojtja e rendit ose parandalimi i krimit, mbrojtja e shëndetit ose e moralit, ose mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

54. Po ashtu, Gjykata i referohet edhe Dokumentit Informativ SG/Inf(2020)11, datë 7 prill 2020, të Këshillit të Evropës, për “Respektimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19”, i cili, ndër tjera, thekson se “mbrojtja e shëndetit” është një nga “qëllimet legjitime” që u mundëson qeverive përkatëse të ndërmarrin masa kufizuese gjatë parandalimit dhe luftimit të pandemisë përkatëse, po kuptohet, vetëm nëse ato

janë të “përvaktuara në ligj” dhe “të domosdoshme në një shoqëri demokratike”.

55. Paraprakisht Gjykata sqaron se nuk është roli i saj të vlerësojë nëse masat e marra nga autoritetet publike janë të përshtatshmet dhe të duhurat, në aspektin teknik, për përballimin e pandemisë. Në këtë vështrim, edhe pse nuk është kundërshtuar nga asnjë prej palëve, Gjykata vë në pah se interesi publik i mbrojtjes së shëndetit dikton marrjen e masave kufizuese. Gjithsesi, përcaktimi i politikave të shëndetit publik nuk bën pjesë në kompetencat e kësaj Gjykate, e cila edhe vetë respekton institucionet përkatëse shëndetësore dhe profesionale.

56. Pavarësisht rezervës së mësipërme për aspektin teknik të masave, çështja e paraqitur për gjykim i jep mundësinë Gjykatës të analizojë rëndësinë e ruajtjes së shëndetit publik, si pjesë e qëllimit legjitim që justifikon kufizimet e lirive dhe të drejtave kushtetuese në kushtet e pandemisë. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se pandemia COVID-19, masa e shpërndarjes së virusit, efektet e tij të shëndeti e jeta e njerëzve, nga njëra anë, dhe të panjohurat, nga ana tjetër, me të cilat u përballën jo vetëm autoritetet publike, por edhe individët, vuri në vijë të parë urgjencën, pasigurinë dhe nevojën për ndërhyrje, që u materializuan në kufizime të reja dhe të forta. Megjithatë, ndërkohë që rëndësi parësore merr nevoja për të vepruar në përballimin e pandemisë, çështjet e lirive dhe të të drejtave themelore, të cilat përbëjnë vlera kushtetuese, nuk mund të lihen mënjanë, por duhen trajtuar me të njëjtën vëmendje. Gjykata vë në dukje, po ashtu, se tashmë jetesa e individëve nën masa kufizuese po shndërrohet në një karakteristikë të qëndrueshme të jetës së përditshme të tyre. Kjo situatë, nga njëra anë, rrit masën e kufizimeve dhe, nga ana tjetër, zbeh peshën e nevojës për caktimin e kufizimeve. Thënë ndryshe, sa më shumë zgjat situata në praktikë, aq më shumë përvojë fitojnë autoritetet publike për të përballuar pandeminë dhe, për rrjedhojë, kanë kohën e mjaftueshme për të zbatuar masa të menduara mirë në të ardhmen.

57. Për sa më sipër, në kufizimin që i ka bërë së drejtës së tubimit, MSHMS-ja ka ndjekur një “qëllim legjitim”, përkatësisht atë të “mbrojtjes së shëndetit të popullatës nga një sëmundje infektive me impakt të madh”, i cili përfaqësohet në konceptin e interesit publik, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.



C.2.3 Për kriterin e proporcionalitetit

58. Bazuar në nenin 17 të Kushtetutës, kriteri tjetër për kufizimin e të drejtave themelore është përpjesëtimi i drejtë midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e dikton atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

59. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe të proporcionalitetit. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me të drejtat që kufizohen. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se respektimi i përmbushjes së kushteve të mësipërme të kufizimit kërkon një trajtim të diferencuar, në varësi të të drejtave dhe lirive individuale që i nënshtrohen kufizimit (*shih vendimet nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 2, datë 18.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Në jurisprudencën e saj Gjykata, kur ka çmuar ndërhyrjen në të drejtat themelore, ka marrë parasysh kriteret në vijim: i. nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Gjykata ka theksuar se proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh se aspektet e mësipërme nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (*shih vendimin nr. 33, datë 26.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i

drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1 datë 6.2.2013; nr. 52, datë 5.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

61. GJEDNJ-ja është shprehur se ndonëse autoritetet publike kanë një hapësirë të pakufizuar vlerësimi për të caktuar kufizime të të drejtave themelore, që janë “të nevojshme në një shoqëri demokratike”, i takon Gjykatës të vendosë mbi përputhshmërinë e kufizimeve me Konventën, duke vlerësuar rrethanat konkrete të rastit, duke shqyrtuar “ndërhyrjen” nën dritën e çështjes në tërësi dhe duke përcaktuar që kjo ndërhyrje ka ndjekur një “qëllim legjitim”, në kuptimin që i është përgjigjur “një nevojë urgjente shoqërore” dhe, në veçanti, nëse ka qenë proporcionale me atë qëllim dhe nëse arsyet e përdorura nga autoritetet publike për ta justifikuar atë kanë qenë “të rëndësishme dhe të mjaftueshme”. Parimi i proporcionalitetit kërkon vendosjen e një balance midis kërkesave të qëllimeve legjitime të listuara në paragrafin 2 të nenit 11 të Konventës, nga njëra anë, me ato të lirisë së shprehjes së mendimeve të individëve të mbledhur në rrugë ose në vende të tjera publike, në anën tjetër (*shih Kudrevičius dhe të tjerë kundër Lituanisë, 15 tetor 2015, §§ 142-144*).

62. Për të justifikuar një ndalim të përgjithshëm, shteti duhet të tregojë që ekziston një rrezik real, i cili nuk mund të parandalohet me masa të tjera më pak shtrënguese. Ai duhet të marrë parasysh efektin e ndalimit dhe të arrijë në përfundimin nëse disavantazhet që shkakton ndalimi kanë qartazi me më shumë peshë se siguria publike dhe se nuk ka mënyra të tjera të mundshme për të shmangur këto efekte të padëshirueshme, duke zvogëluar fushëveprimin ose kohëzgjatjen e ndalimit (*shih Christians against Racism and Fascism kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 korrik 1980*).

63. Në disa raste GJEDNJ-ja i ka gjetur të mbështetura kufizimet mbi grumbullimet publike (si p.sh. kufizime të vendit ose numrit të pjesëmarrësve), ku qëllimi ishte mbrojtja e sigurisë publike ose ruajtja e rendit publik. Ajo nuk ka gjetur shkelje të nenit 11 të Konventës kur grumbullimi është shpërndarë për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e pjesëmarrësve (*shih Chappell kundër Mbretërisë së Bashkuar, 14 korrik 1987; Cisse kundër Francës, 9 prill 2002*).



64. Në kontekstin e rrethanave të pazakonta të krijuara nga pandemia COVID-19, Gjykata vë në dukje se ndalimi i përhapjes së këtij virusi përbën një “*nevojë urgjente shoqërore*”. Prandaj dhe masat e marra, duke përfshirë edhe urdhrin e ministrit në rastin konkret, janë të lidhura me këtë objekt, në kuadër të detyrimeve dhe përgjegjësi që kanë autoritetet shtetërore për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjyese.

65. Kërkesja ka pretenduar se ndalimi i tubimeve nuk është mjeti i duhur dhe i nevojshëm dhe se mënyrat alternative të komunikimit *online* nuk janë të përshtatshme, pasi nuk mbulojnë të gjithë territorin. Ndërsa subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar se urdhri nr. 633/2020 ka dalë pas shpalljes së gjendjes së pandemisë nga OBSH-ja, në përgjigje të situatës së krijuar, si rezultat i shtimit të rasteve të të prekurve dhe viktimeve nga COVID-19. Sipas tij, kërkesja ka në dispozicion mënyra alternative të komunikimit *online* për ushtrimin e të drejtave që pretendon se i janë cenuar.

66. Gjykata konstaton se në kuadrin e lirisë së shprehjes dhe të së drejtës së tubimit, shpërndarja e informacionit dhe ideve ka një rëndësi të veçantë. Padyshim, tubimet politike dhe mbledhjet partiake zënë vend kryesor në procesin zgjedhor, pasi përmes tyre pjesëmarrësit dhe organizatorët japin e shkëmbejnë opinione, ide e çështje të programeve politike, me të cilat partitë politike konkurrojnë në zgjedhje, ndërsa zgjedhësit informohen për të bërë zgjedhjen e duhur. Gjykata thekson se kur kufizohen të drejtat kushtetuese, për kontrollin e proporcionalitetit të ndërhyrjes nuk mjafton vetëm ekzistenca e mjeteve alternative, por një faktor i rëndësishëm lidhet me vlerësimin se sa këto mënyra alternative lejojnë ushtrimin e së drejtës, qoftë edhe në masë të kufizuar. Kur kufizimet vendosen për lirinë e shprehjes dhe të tubimit përgjatë procesit zgjedhor, për Gjykatën merr rëndësi vlerësimi i hapësirës dhe shkallës së përdorimit të mënyrave alternative të komunikimit që iu mundësohen zgjedhësve dhe partive politike për të përhapur mesazhin dhe idetë e tyre politike tek votuesi përmes: video-konferencave, angazhimeve aktive në platforma elektronike me ndjekje të gjerë, rrjeteve sociale, takimeve *online*, emisioneve televizive, medieve etj.

67. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se si rregull çdo kufizim i të drejtave në vetvete duhet të ketë

elementin e përkohshmërisë. Po ashtu, parimi i proporcionalitetit kërkon që sa më i madh të jetë kufizimi, aq më i detajuar dhe bindës duhet të jetë justifikimi i tij. Në këtë këndvështrim, krahas numrit të kufizuar të personave që lejohen të grumbullohen, mënyrat alternative të ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe të së drejtës së tubimit e justifikojnë konceptin e kufizimit të përkohshëm të tyre. Megjithatë, kur këto kufizime zgjasin pa afat, duke humbur karakteristikën e përkohshmërisë dhe për kohëzgjatjen e pacaktuar nuk jepet justifikim, ato shndërrohen në ndalim tërësor të kësaj të drejte, duke zbehur rolin që luajnë mënyrat alternative.

68. Për sa më lart, Gjykata vëren se urdhri nr. 663/2020, në pikën 1 të tij, përmban shprehjen “deri në një urdhër të dytë”, që tregon se nuk ka një afat të qartë se kur këto masa kufizuese përfundojnë ose rishikohen. Konkretisht, nga hyrja në fuqi e tij e deri aktualisht ky urdhër nuk është rishikuar.

69. Në vlerësimin e Gjykatës termi “deri në një urdhër të dytë” krijon problematikë në dy drejtime: *së pari*, nuk detyron autoritetet përgjegjëse të bëjnë vlerësim periodik për masat kufizuese të përcaktuara me urdhrin në fjalë dhe, *së dyti*, nuk i përgjigjet standardit të proporcionalitetit. Kjo çështje merr edhe më shumë rëndësi po të merret në konsideratë që vendi tashmë është në prag të zgjedhjeve parlamentare.

70. Në dritën e rrethanave konkrete që kanë të bëjnë me nivelin e përhapjes së virusit dhe ndikimin e tij në Shqipëri, të shpjeguara nga subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe MSHMS-ja, Gjykata çmon se kufizimi nga urdhri i ministrit i së drejtës së tubimit, të lidhur me të drejtën e shprehjes, është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, pasi diktohet nga një nevojë urgjente shoqërore. Megjithatë, Gjykata vlerëson se akti i kundërshtuar nuk respekton kriterin e proporcionalitetit, sipas nenit 17 të Kushtetutës, për shkak të mosparashikimit të një afati të përcaktuar për kohëzgjatjen e masave kufizuese dhe për këtë shkak shprehja “gjer në një urdhër të dytë” duhet të shfuqizohet.

71. Në kushtet e shfuqizimit pjesërisht të urdhrit nr. 633/2020, Gjykata, në bazë të neneve 76, pikat 1 dhe 4, dhe 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, çmon se organi kompetent duhet të rishikojë kohëzgjatjen e kufizimeve brenda një jave nga



shpallja e këtij vendimi. Në këtë proces rishikimi, Gjykata vlerëson domosdoshmërinë e përmbushjes nga ana e organit kompetent të standardeve të analizuar në këtë vendim, të cilat në mënyrë të përmbledhur sigurojnë: a) analizën e kujdesshme të parimeve kushtetuese përpara miratimit të kufizimeve të të drejtave kushtetuese; b) rritjen e besimit publik për instrumentet e përdorura, përmes informimit të qytetarëve mbi to; c) lehtësimin e veprimtarisë së organeve të tjera publike, nëse ato shqyrtojnë ankesa administrative ose gjyqësore nga zbatimi i kufizimeve; ç) monitorimin dhe vlerësimin e duhur nga Kuvendi për kufizimet e të drejtave kushtetuese. Në caktimin e afatit për rishikimin e kohëzgjatjes së kufizimeve, Gjykata mban në konsideratë nevojën që organi kompetent të veprojë me ritmin e duhur nisur nga fakti se vendi tashmë është në prag të zgjedhjeve të përgjithshme, fakt i cili padyshim shkakton disa vështirësi kohore për qytetarët për të materializuar të drejtat kushtetuese në fjalë, në kuptimin e mbrojtjes së tyre në rrugë administrative apo gjyqësore.

Ç. Për pretendimin e cenimit të nenit 117 të Kushtetutës

72. Kërkuësja ka pretenduar se është cenuar edhe neni 117, pika 1, i Kushtetutës, për arsye se akti i kundërshtuar ka hyrë në fuqi përpara botimit në Fletoren Zyrtare. Për këtë fakt, kërkuësja ka parashtruar se edhe pse urdhri është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 210, të datës 2.12.2020, ai është zbatuar në datën 21.11.2020, pasi në këtë datë është dhënë një masë administrative për një subjekt nga punonjësit e policisë të Komisarariatit nr. 5.

73. Gjykata vëren se urdhri i kundërshtuar, në pjesën e fundit të përmbajtjes së tij, disponon se hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Gjithsesi, pavarësisht përmbajtjes së aktit, Gjykata thekson se duke qenë se ai është një akt normativ, duhet të zbatohet neni 117, pika 1, i Kushtetutës, i cili parashikon se “ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”.

74. Për sa më sipër, Gjykata çmon se edhe në rastin në shqyrtim nuk duhet të bëhet përjashtim nga ky rregull kushtetues dhe se urdhri nr. 633/2020 ka hyrë në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës për cenimin e nenit 117, pika 1, të Kushtetutës nuk është i bazuar. Nëse janë dhënë

masa administrative përpara hyrjes së tij në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare, kjo është çështje që i përket zbatimit të urdhrit nga organet ligjzbatuese.

75. Si përfundim, Gjykata, bazuar në arsyetimin e mësipërm, vlerëson se urdhri nr. 633/2020 i MSHMS-së, në drejtim të caktimit të masave kufizuese pa afat, cenon standardet kushtetuese të nenit 17 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “c”, 134, pika 1, shkronja “g”, dhe 132, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 76, pikat 1 dhe 4, dhe 81, pika 3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 - Shfuqizimin e shprehjes “deri në një urdhër të dytë” në pikën 1 të urdhrit nr. 633, datë 17.11.2020 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 - Detyrimin e organit kompetent të rishikojë kohëzgjatjen e kufizimeve brenda një jave nga shpallja e këtij vendimi.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 9.3.2021

Shpallur më 18.3.2021

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari,
Përparim Kalo, Sonila Bejtja

Anëtarë kundër: Altin Binaj, Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Shumica argumenton se: “Gjykata vlerëson gjithashtu se si rregull, çdo kufizim i të drejtave, në



vetvete duhet të ketë elementin e përkohshmërisë. Po ashtu, parimi i proporcionalitetit kërkon që sa më i madh të jetë kufizimi aq më i detajuar dhe bindës duhet të jetë justifikimi i tij. Në këtë këndvështrim, mënyrat alternative të ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe të së drejtës së tubimit e justifikojnë konceptin e kufizimit të përkohshëm të tyre. Megjithatë, kur këto kufizime zgjasin pa afat, duke humbur karakteristikën e përkohshmërisë dhe për kohëzgjatjen e pacaktuar nuk jepet justifikim, ato shndërrohen në ndalim tërësor të kësaj të drejte, duke zbehur rolin që luajnë mënyrat alternative.” (prg. 67 i vendimit). Për sa më lart, Gjykata vëren se urdhri nr. 663/2020, në pikën 1 të tij përmban shprehjen “deri në një urdhër të dytë” që tregon se nuk ka një afat të qartë se kur këto masa kufizuese përfundojnë apo rishikohen. Konkretisht, nga hyrja në fuqi e tij e deri aktualisht, ky urdhër nuk është rishikuar (prg. 68 i vendimit). Në vlerësimin e Gjykatës termi “deri në një urdhër të dytë” krijon problematikë në dy drejtime: *së pari*, nuk detyron autoritetet përgjegjëse të bëjnë vlerësim periodik për masat kufizuese të përcaktuara me urdhrin në fjalë dhe *së dyti*, nuk i përgjigjet standardit të proporcionalitetit. Kjo çështje merr edhe më shumë rëndësi po të merret në konsideratë se vendi tashmë është në prag të zgjedhjeve parlamentare.” (prg. 69 i vendimit).

3. Në thelb, shumica ka arritur në konkluzionin e shfuqizimit të urdhrit nr. 633/2020, vetëm për pjesën “deri në një urdhër të dytë”, pasi akti i kundërshtuar nuk respekton kriterin e proporcionalitetit, sipas nenit 17 të Kushtetutës, për shkak të mosparashikimit të një afati të përcaktuar për kohëzgjatjen e masave kufizuese (prg.70 i vendimit). Po kështu, ajo ka urdhëruar detyrimin e organit kompetent të rishikojë kohëzgjatjen e kufizimeve, brenda një jave nga shpallja e këtij vendimi (*pjesa e tretë e dispozitivit të vendimit*).

4. Ne, gjyqtarët në pakicë, në mënyrë të përmbledhur, vlerësojmë:

4.1 Urdhri nr. 633/2020, objekt kundërshtimi, e plotëson kriterin kushtetues të proporcionalitetit në vështrim të nenit 17 të Kushtetutës, edhe duke përfshirë shprehjen “deri në një urdhër të dytë”, pasi ai e ka në përmbajtje periodicitetin e rivlerësimit dhe rishikimit të kufizimeve nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në vijim “ministri i Shëndetësisë”) dhe nuk mund të

lexohet i shkëputur vetëm në kuptimin gramatikor dhe gjuhësor të mospasjes afat specifik në terma konkretë.

4.2 E gjithë procedura administrative, në fazat para dhe gjatë nxjerrjes së urdhrit nr. 633/2020, shoqërohet nga procesi i vlerësimit paraprak dhe periodik i gjendjes faktike të pandemisë në vend nga Komiteti i Përkohshëm Teknik përpara se, si rezultat përfundimtar i kësaj procedure, të shprehet me urdhrin përkatës ministri i Shëndetësisë, bazuar në nenin 102/4 të Kushtetutës.

4.3 Kohëzgjatja e kufizimeve të tubimeve dhe mbledhjeve partiake deri në 10 persona, para fillimit të fushatës zgjedhore, plotëson testin e domosdoshmërisë dhe të përshtatshmërisë së masës kufizuese, pa cenuar thelbin e së drejtës, në raport me qëllimin e synuar, parandalimin e përhapjes së infeksionit nga COVID -19 dhe ruajtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve.

4.4 Para kësaj gjykate u provua se ky kufizim është i domosdoshëm për arritjen e qëllimit, pra parandalimin e përhapjes së infeksionit, si dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. Ndërkohë nuk u provua se mjeti i përzgjedhur për kufizimin e lirisë së tubimit është më i ashpri për arritjen e qëllimit.

5. Më konkretisht, argumentet e detajuara për këtë qëndrim do t'i paraqesim për sa vijon:

A. Për përmbajtjen e urdhrit nr. 633/2020

6. Kërkuesja, si në kërkesë, ashtu edhe në seancë gjyqësore, i është referuar vetëm kuptimit literal dhe gramatikor të aktit objekt kundërshtimi, duke pretenduar se ky akt ndalon në mënyrë totale tubimet dhe mbledhjet partiake, për të cilat numri maksimal prej 10 personash nuk aplikohet. Ndaj dhe ajo parashtroi se nuk e ka ushtruar të drejtën e tubimit gjatë kësaj periudhe parazgjedhore. Ndërsa, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar se bazuar në interpretimin qëllimor të urdhrit, lejohen grumbullimet deri në 10 persona, përfshirë edhe tubimet, edhe mbledhjet partiake. Nëse kërkuesja do t'i ishte drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, do të kishte marrë përgjigje për kuptimin e urdhrit objekt gjykimi.

7. Në vështrim të standardeve të kësaj gjykate, kur kjo e fundit ndodhet para mundësisë së interpretimit të një akti normativ, në më shumë se një mënyrë dhe vetëm njëra prej këtyre interpretimeve është në pajtim me Kushtetutën, zgjedh këtë të fundit. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe



përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve. Gjykata nisët nga premisa që një akt normativ duhet të interpretohet në kuptimin që lejon zbatimin e tij, jo në atë që e përjashton këtë zbatim (*actus interpretandus est potius ut valeat quam ut pereat*) (shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

8. Në pikën 1 urdhri parashikon: “*Të ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore, deri në një urdhër të dytë.*”

9. Duke bërë një interpretim sistematik dhe jo vetëm gramatikor të aktit të kundërshtuar, konstatohet se pjesa e parë e fjalisë në pikën 1 të aktit përmban një ndalim të përgjithshëm “të grumbullimeve me më shumë se 10 persona”, të cilat nuk lidhen me një qëllim të caktuar, ndërsa në pjesën tjetër të fjalisë janë listuar disa aktivitete specifike që kanë një qëllim të caktuar. Termi “tubim” përkufizohet nga ligji nr. 8773, datë 23.4.2001, “Për tubimet” dhe përfshin grumbullimet, manifestimet, mbledhjet dhe parakalimet me karakter paqësor dhe pa armë, në të cilat një grup personash shprehin kërkesat dhe pikëpamjet e tyre për probleme për të cilat janë të interesuar dhe përfshin edhe tubimet urgjente (neni 2, pika 5). Edhe mbledhjet partiake nuk janë gjë tjetër veçse grumbullime personash që kanë një qëllim të caktuar, konkretisht qëllim politik. Si të tilla, ato bien në fushëveprimin e ndalimit të përgjithshëm të “grumbullimeve me më shumë se 10 persona”, i cili ka një spektër më të gjerë aplikimi, që nuk ngushtohet nga qëllimi i grumbullimit apo lloji i personave që marrin pjesë në të.

10. Pavarësisht paqartësive që mund të lindin nga interpretimi literal i tekstit të aktit, nisur nga *ratio legis* (ose qëllimi final i aktit normativ), vlerësojmë se qëllimi i urdhrit në fjalë është të vendosë ndalime për grumbullime me më shumë se 10 persona për të gjitha aktivitetet e listuara në pikën 1 të urdhrit, duke përfshirë tubimet dhe mbledhjet partiake, me qëllim ruajtjen e shëndetit publik nga COVID-19. Pra, mesazhi normativ i tekstit të aktit është lejimi i çdo lloji grumbullimi, pavarësisht qëllimit (politik, argëtues, profesional

ose familjar), me kushtin që numri i personave të mbledhur të mos jetë më tepër se 10.

11. Kjo analizë vjen në këndvështrim të respektimit të standardeve të vendosura nga Gjykata Kushtetuese, në rastet e zbatimit të teknikës së interpretimit pajtues, sipas së cilës, akti i kundërshtuar nuk cenon lirinë e tubimit, vetëm nëse interpretohet për sa është elaboruar më sipër.

12. Po në këtë drejtim, duhet theksuar paraprakisht se kërkesja nuk ka ezauruar rrugën administrative, duke iu drejtuar me kërkesë për interpretim Ministrisë së Shëndetësisë për paqartësitë dhe kuptimin e saktë të urdhrit. Kjo do të thotë se ajo nuk ka pasur qasje funksionaliste në kuptim të të drejtave dhe lirive të veta si subjekt politik. Nëse, do të kishte pasur një qëndrim zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë për lejimin e tubimeve dhe mbledhjeve partiake deri në 10 persona, kërkesja do të kishte ushtruar potencialisht gjatë kësaj periudhe parazgjedhore këtë të drejtë dhe liri politike, ose nëse kjo e drejtë do t’i mohohet, do të kishte mundësi që në këtë gjykim kushtetues të provonte dëmin real të ardhur nga norma objekt kundërshtimi, si dhe një argument më tepër në drejtim të pretendimit të saj për kuptimin gramatikor të urdhrit, si dhe zbatimin e tij në praktikë në këtë aspekt.

13. Duke mbajtur në konsideratë interpretimin pajtues të urdhrit, të analizuar sa më sipër, që e kishte detyrim edhe shumica ta elaboronte, për sa kohë që ai kishte paqartësi në përmbajtje dhe mundësi për më shumë se një mënyrë interpretimi, do u referohemi standardeve të proporcionalitetit, sipas nenit 17 të Kushtetutës, pasi kriterin e kufizimeve “me ligj” dhe për “interes publik”, shumica e ka analizuar dhe ne jemi dakord.

B. Për pretendimin për cenimin e parimit të proporcionalitetit

14. Kërkesja ka pretenduar se ndalimi i tubimeve nuk është mjeti më i përshtatshëm dhe i nevojshëm. Referuar kërkesës, por edhe seancës gjyqësore, ajo pretendon se tubimet politike, do të duhej të lejoheshin pa numër të specifikuar, duke respektuar rregullat e vendosjes së maskave dhe të distancimit fizik, dhe kjo do të përbënte, sipas kërkeses, mjetin më të përshtatshëm dhe proporcional në rastin konkret për arritjen e qëllimit (parandalimin e përhapjes së COVID-19). Po ashtu, sipas kërkeses, mospasja e një afati për rishikim para fushatës parazgjedhore, në pjesën e



ndalimeve të grumbullimeve, e bën urdhrin antikushtetues.

15. Në këtë drejtim, edhe subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se urdhri nr. 633/2020, ka dalë si rezultat i shtimit të rasteve të të prekurve dhe viktimave nga COVID-19. Po sipas subjektit të interesuar, natyra e këtij virusi është e tillë që e bën të pamundur identifikimin e jetës ose jetëve që janë në rrezik dhe gjithë popullata mund të infektohej në masë të paparashikuar, në qoftë se do të lejohej grumbullimi i pakontrolluar i njerëzve në vende publike, në aktivitete të ndryshme politike ose shoqërore.

16. Lidhur me kufizimet e të drejtave themelore dhe testin e proporcionalitetit, Gjykata ka theksuar se, në zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, kriteret për të vlerësuar nëse një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit, janë: i. objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin – ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t'u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme” (*shih vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror dhe shëndetin publik, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 47, datë 27.6.2012, nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit është thelbësore të theksohet se nuk i takon Gjykatës të përcaktojë nëse mjeti i përzgjedhur është mënyra më e përshtatshme, më e arsyeshme ose e duhura, por roli i saj është të kontrollojë nëse përmbajtja e vetë dispozitës normative është e pajtueshme me të drejtat, liritë dhe parimet themelore kushtetuese (*shih vendimin nr. 55 datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në vështirim të standardeve të sipërpërmendura, balancimi i të drejtave, është

metoda kryesore që përdoret nga Gjykata, kur ndodhemi para “konfliktit të të drejtave” dhe në rastin konkret nga njëra anë qëndron e drejta e jetës dhe sigurisë së shëndetit publik, ndërsa nga ana tjetër liria e tubimit.

19. Për sa i përket së drejtës së jetës, kjo Gjykatë ka vlerësuar se “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 21 të saj parashikon se: “Jeta e personit mbrohet me ligj”. Kjo dispozitë shpreh në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e jetës njerëzore, e cila përbën një vlerë kushtetuese. Koncepti për jetën dhe dinjitetin njerëzor paraqiten në dispozitat e Kushtetutës si vlera shumë të rëndësishme, të cilat konsiderohen si burimi nga i cili rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera si të drejta themelore. (...) Thelbi i dispozitave kushtetuese është nxjerrja sa më në pah e atyre drejtimeve themelore që si orientim primar kanë respektimin e vlerës së jetës dhe të dinjitetit njerëzor. Vlera më superiore për shtetin është njeriu dhe jeta e tij. Kjo e drejtë qëndron në themel të të gjitha të drejtave dhe mohimi i saj sjell edhe eliminimin e të drejtave të tjera njerëzore. Jeta njerëzore, duke u konsideruar e tillë që nga fillimi i saj, bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta. Ky është edhe qëllimi i Kushtetutës sonë, i cili del që në Preambulën e saj, si dhe në mjaft dispozita të tjera” (*shih vendimin nr. 65, datë 10.12.1999 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa i përket lirisë së tubimit, Gjykata Kushtetuese nuk ka jurisprudencë të mëparshme, por GJEDNJ-ja si gjykatë me kompetenca ekskluzive, për sa i përket nenit 17 të Kushtetutës, në sistemin tonë juridik, ka theksuar: “Një ndërhyrje në lirinë e tubimit paqësor do të përbëjë shkelje të nenit 11 nëse nuk është “parashikuar nga ligji”, nuk ndjek një ose më shumë “qëllime legjitime” sipas paragrafit 2 të nenit 11 dhe nuk është “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” për të arritur qëllimin ose synimet në fjalë” (*shih Vyerentsov kundër Ukrainës, kërkesa nr. 20372/11, Aktgjykim i datë 11 korrik 2013, prg. 51*). Në disa raste GJEDNJ-ja i ka gjetur të mbështetura kufizimet mbi grumbullimet publike (si p.sh. kufizime të vendit ose numrit të pjesëmarrësve), ku qëllimi ishte mbrojtja e sigurisë publike ose ruajtja e rendit publik. Ajo nuk gjeti shkelje të nenit 11 të Konventës kur grumbullimi u shpërnda për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e pjesëmarrësve (*shih Chappell kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.*



12587/86, vendimi i datës 14 korrik 1987; Cisse kundër Francës, nr. 51346/99, vendimi i datës 9 prill 2002). Për të garantuar pajtueshmërinë me nenin 11 të KEDNJ-së, çdo kufizim i lirisë së tubimeve duhet të formulohet me terma sa më të qartë brenda rrethanave, për shembull, duke specifikuar numrin e saktë të njerëzve që lejohet të takohen në të njëjtën kohë, për të zvogëluar rrezikun e ndërhyrjes arbitrare në të drejtën e organizimit¹⁵.

21. Në rastin konkret, kufizimi i ushtrimit të lirisë së tubimit publik duhet të kalojë provën e proporcionalitetit, duhet të ketë një ekuilibër të drejtë midis së drejtës së qytetarëve që ushtrojnë lirinë për t'u grumbulluar dhe për të tubuar në mënyrë paqësore, si dhe interesit publik të mbrojtjes së sigurisë së shëndetit dhe të jetës të njerëzve.

22. Në këndvështrim të testit të balancës së të drejtave, liria e tubimit, e cila garantohet nga neni 47 i Kushtetutës, qëndron më poshtë se e drejta e jetës së qytetarëve, e cila garantohet nga neni 21 i Kushtetutës. Mbrojtja e jetës përbën një vlerë kushtetuese dhe burimin e të gjitha të drejtave të tjera, si të drejta themelore (shih vendimin nr. 65, datë 10.12.1999, të Gjykatës Kushtetuese).

23. Edhe Gjykata Federale Gjermane në disa raste, duke vlerësuar *balancën e pasojave*, ka konstatuar se e drejta për të lejuar grumbullimin duhet të qëndrojë më poshtë të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë për sigurimin e mbrojtjen e jetës së qytetarëve¹⁶. Konkretisht, po citojmë disa nga vendimet e kësaj gjykate: “Qëllimi i urdhrat për ndalimin e grumbullimeve është mbrojtja e jetës dhe integritetit fizik, për të cilat shteti në parim ka detyrim t'i mbrojë sipas nenit 2, paragrafi 2, pika 1 e ligjit themelor. Nëse, siç pretendon kërkuesi, një numër i madh njerëzish do të mbledheshin në një hapësirë të kufizuar, do të kishte një rrezik real për një përhapje të mëtejshme dhe të pakuptueshme të virusit, i cili duhet të shmanget veçanërisht për të mbrojtur kapacitetet e trajtimit mjekësor nga

mbingarkesa. Kur krahasohen këto pasoja, interesi i kërkuesit për të mbajtur takimin e planifikuar qëndron më poshtë” (1 BvQ 29/20). “Kur krahasohen këto pasoja, interesi i kërkuesit për të mbajtur takimin e planifikuar me më shumë se 5,000 pjesëmarrës qëndron më poshtë. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme këtu është që aplikanti në parim është i aftë të ushtrojë të drejtat e tij themelore. Ai mund ta mbajë mbledhjen në çfarëdo mënyre që dëshiron, si për nga koha, ashtu edhe nga vendi” (1 BvQ 63/20). “Kur krahasohen pasojat e mundshme, interesi i kërkuesit për të zhvilluar mbledhjen e planifikuar duhet të shihet në lidhje me mbrojtjen e jetës dhe integritetit fizik, të cilin shteti është gjithashtu i detyruar të mbrojë sipas nenit 2, paragrafi 2, klauzola 1 e ligjit themelor” (1 BvR 1004/20).

24. Edhe në këndvështrim të jurisprudencës së mësipërme të Gjykatës Federale Gjermane, ku theksi i vihet *balancimit të pasojave*, vlerësojmë se situata e pandemisë paraqet probleme në këndvështrim të së drejtës së shëndetit dhe sigurisë së jetës jo vetëm në lidhje me ardhjen e pasojave të dëmshme, por për më tepër në drejtim të parandalimit të atyre pasojave që edhe shkencërisht nuk mund të parashikohen saktë se deri në çfarë përmase do të shfaqen. Duhet mbajtur në konsideratë se gjatë një tubimi pjesëmarrësit mund të mos i respektojnë rregullat e distancimit fizik, mund të kenë kontakt të afërt për një kohë të gjatë dhe mund të mos e mbajnë maskën gjatë gjithë kohës. Po kështu, nuk përjashtohet mundësia e kontaktit të pjesëmarrësve në tubimin elektoral me kalimtarë të rastit, çka mund të përbëjë një rrezik të shtuar infektimi dhe përhapje të pakontrolluar të virusit. Ndërkohë që pjesëmarrësit në tubim kanë kontakte dhe me familjarët e tyre, që mund të mos kenë qenë pjesë e tubimit, duke e bërë të vështirë dhe të paparashikueshme menaxhimin e ardhjes së pasojave për shëndetin publik dhe sigurinë e jetës së njerëzve.

25. Për sa më lart, e drejta themelore për jetën dhe integritetin fizik nënkupton, së pari, një detyrë të shtetit për të mbrojtur jetën e njerëzve dhe individin nga pasoja si dëmtimet e shëndetit, apo humbja e jetës. Interesi publik i ruajtjes së shëndetit në rastin konkret e tejkalon interesin e kërkueses për të mbajtur një tubim apo mbledhje partiake, pa numër të kufizuar njerëzish, duke ruajtur masat higjienike e distancat. Kufizimet përkatëse, para

¹⁵ COVID-19 dhe Impakti mbi të drejtat e njeriut, “Shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, *The Aire Centre, Civil Rights Defenders*, botim i vitit 2020, faqe 109.

¹⁶ Raporti Vjetor i Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane (*Federal Constitutional Court Annual Report*) 2020, “Vendime të Gjykatës Federale Gjermane në kuadër të Pandemisë”, faqja 59, paragrafi i fundit. I disponueshëm në https://jahresbericht.bundesverfassungsgericht.de/pdf-f-en/#dearflip-df_720/48/



fushatës zgjedhore, reflektojnë një balancim të mjaftueshëm mes interesit publik, në njërën anë, dhe së drejtës së kërkueses, nga ana tjetër.

26. Masa e marrë nga ministri i Shëndetësisë është ndalimi i grumbullimeve, tubimeve dhe mbledhjeve partiake mbi 10 persona, deri në një urdhër të dytë. Pyetja që shtrohet është: a e ka cenuar thelbin e tubimit kjo masë dhe a është ndërhyrja më e ashpër se sa qëllimi i vetë ndërhyrjes për të parandaluar përhapjen e sëmundjes, për shkak të grumbullimit të personave pavarësisht nga qëllimi, por përfshirë dhe qëllimet politike?

27 Parametrat kushtetues të masës ndërhyrëse: i. nevoja; ii. domosdoshmëria; iii. përshtatshmëria, do të elaborohen në vijim në vështrim të standardeve kushtetuese.

28. *Nevoja* do të thotë se duhet të ketë një lidhje të arsyeshme mes kufizimit dhe gjendjes që ka nevojë për ndërhyrje. Nga kërkuesja nuk është vënë në diskutim nevoja, i cili në kërkesë dhe në seancë gjyqësore pranon rëndësinë e situatës dhe nevojën e ndërhyrjes. Po ashtu, edhe subjekti i interesuar shpjegoi para Gjykatës gjendjen e vendit si rezultat i pandemisë dhe nevojën e ndërhyrjes. Në këto kushte, vlerësojmë se kufizimi i përgjigjet mjaftueshëm kriterit të nevojës për mbrojtjen e shëndetit publik në marrjen e masave kufizuese.

29. *Domosdoshmëria* e masës ka lidhje me faktin se mjeti i ndërhyrjes duhet të jetë jo i ashpër dhe të dëmtojë të drejtën e kufizuar vetëm për atë që arrihet qëllimi, duke mos e shuar thelbin e së drejtës. Sipas kërkueses, masë më pak e ashpër do të ishte nëse urdhri do të lejonte çdo lloj grumbullimi, pa numër të caktuar, por duke ruajtur masat higjienike dhe distancat (*referuar pyetjeve dhe përgjigjeve specifike sipas procesverbalit të seancës së datës 2.3.2021*).

30. Shumica në këtë drejtim ka analizuar se “... si rregull, çdo kufizim i të drejtave, në vetvete, duhet të ketë elementin e përkohshmërisë. Po ashtu, parimi i proporcionalitetit kërkon që sa më i madh të jetë kufizimi atëherë më i detajuar dhe bindës duhet të jetë justifikimi i tij. Në këtë këndvështrim, mënyrat alternative të ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe të së drejtës së tubimit e justifikojnë konceptin e kufizimit të përkohshëm të tyre. Megjithatë, kur këto kufizime zgjasin pa afat, duke humbur karakteristikën e përkohshmërisë dhe për kohëzgjatjen e pacaktuar nuk jepet justifikim, ato

shndërrohen në ndalim tërësor të kësaj të drejte, duke zbehur rolin që luajnë mënyrat alternative.” (*prg. 67 i vendimit*).

31. Pra, sipas qëndrimit të shumicës, të sipërcituar, mjeti i përzgjedhur, kufizimi pa afat dhe pa justifikim i kohëzgjatjes së pacaktuar të kufizimit të lirisë së tubimit, shndërrohet në ndalim tërësor të së drejtës së tubimit.

32. Ne nuk jemi dakord me këtë qëndrim, pasi kohëzgjatja e kufizimit në rastin konkret është mbi baza periodike dhe nuk mund të shndërrohet në ndalim tërësor të së drejtës, dhe as ta shuajë thelbin e së drejtës, për sa kohë që gjendja faktike e pandemisë verifikohet periodikisht nga Komiteti Teknik i Përkohshëm. Ministri i Shëndetësisë, bazuar në propozimet konkrete, ka të drejtë dhe mund të shfuqizojë tërësisht ose pjesërisht urdhrin e tij, po ashtu në mënyrë periodike. Grumbullimi i njerëzve, përmes tubimeve apo mbledhjeve partiake deri në 10 persona, vazhdon të qëndrojë në fuqi, derisa të dalë një urdhër i dytë. Ky kufizim ka filluar që kur urdhri ka hyrë në fuqi dhe e ka shoqëruar edhe fushatën parazgjedhore, por nuk do të thotë se do të shoqërojë edhe fushatën zgjedhore, ndaj dhe shumica ka kapërcyer dhe periudhën e vlerësimit që duhej të bënte në analizën e saj, në raport me të drejtën e tubimit, dhe të drejtën e informimit të zgjedhësve në fushatë zgjedhore (*prg. 66 i vendimit*). Gjatë gjyqimit të çështjes, nuk kemi pasur të dhëna, deri në ditën e seancës gjyqësore, që këto masa kufizuese do të jenë po të njëjtat, do të shtrëngohen apo do të zgjerohen gjatë periudhës zgjedhore. (Kodi Zgjedhor, neni 77, fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve).

33. Neni 1 i ligjit nr. 15/2016 parashikon qëllimin e tij për mbrojtjen e popullatës nga infeksionet dhe sëmundjet infektive, duke përcaktuar rregullat dhe aktivitetet për zbulimin në kohë, evidentimin, parandalimin dhe kontrollin e tyre, për eliminimin dhe zhdukjen e sëmundshmërisë dhe të vdekshmërisë nga këto sëmundje. Neni 4 i ligjit nr. 15/2016 parashikon parimet mbi të cilat udhëhiqen organet e parashikuara po në këtë ligj gjatë ushtrimit të detyrës dhe përgjegjësisë së mbrojtjes së shëndetit publik. Në këtë dispozitë parashikohet konkretisht se një nga qëllimet e ligjit është edhe përpjekja për kontrollin, eliminimin dhe zhdukjen e sëmundjeve infektive. (*neni 4/g i ligjit*). Ndërsa, neni 33 i po këtij



ligji parashikon ngritjen e komiteve me funksione këshillimore pranë ministrit të Shëndetësisë, me qëllim marrjen e ekspertizës së duhur dhe këshillimin në vendimmarrje. Me urdhrin nr. 53, datë 31.1.2020, të ministrit të Shëndetësisë është ngritur edhe Komiteti i Përkohshëm Teknik për Infeksionin e Përhapur nga COVID-19, i cili në shkronjën “P” parashikon: “Komiteti raporton te ministri për të gjitha çështjet, dokumentet dhe vendimet e marra në mbledhjet e komitetit”. Ndërsa në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të urdhrit parashikohet veprimtaria monitoruese dhe verifikuese e tij për sa u përket rasteve të mundshme të përhapjes së infeksionit të COVID-19. Ky komitet ka në përbërje shumicë anëtarësie me kualifikim mjekësor (*pika 2 e urdhrit nr. 53/2020 për përbërjen e komitetit*).

34. Nga të dhënat e çështjes rezulton se me vendimin nr. 4856/1 të datës 16.11.2020, Komiteti i Përkohshëm Teknik ka vendosur ndalimin totalisht të tubimeve dhe mbledhjeve partiake, në pikën 2 të tij. Ndërsa, urdhri i ministrit nr. 633/2020, i mbështetur dhe i bazuar në këtë vendim, ka vendosur lejimin deri në 10 persona të çdo lloj grumbullimi në pikën 1 të tij, përfshirë edhe tubimet e mbledhjet partiake.

35. Në vështrim të këtyre fakteve, rezulton se ka pasur mundësi edhe për masa më të ashpra, në kuptim të ekspertizës së dhënë nga Komiteti Teknik, i cili qëllim parësor ka ruajtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, si dhe frenimin e përhapjes së pandemisë, që në vetvete mund të ngrinin probleme lidhur me cenimin e thelbit të lirisë së tubimit, pra ndalimin tërësor të grumbullimeve, por që nga ministri i Shëndetësisë nuk janë përzgjedhur, sikundër rezulton në interpretim të diferencave mes propozimit të Komitetit Teknik dhe vendimmarrjes së ministrit të Shëndetësisë. Në këtë aspekt, vlerësojmë se urdhri ka për qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksionet, duke përcaktuar rregullat dhe aktivitetet e lejuara për evidentimin dhe parandalimin e infektimeve, marrjen e masave për eliminimin dhe zhdukjen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë nga COVID-19, ndaj mes qëllimit që duhet realizuar dhe mjetit të përzgjedhur nga ministri i Shëndetësisë nuk është cenuar thelbi i së drejtës, që është e drejta dhe interesi i kërkueses për t’u mbledhur. Për rrjedhojë, çmujmë se mes mjetit të propozuar nga Komiteti Teknik, dhe mjetit të propozuar nga kërkuesja,

zgjedhja e masës së kufizimit nga ministri i Shëndetësisë nuk është më e ashpra, duke provuar në këtë gjykim, se ka zgjedhur një formë më pak strikte për t’u përgjigjur qëllimit të kufizimit.

36. Përveç sa më lart, vlerësojmë se kjo Gjykatë prezumon pajtueshmërinë e aktit normativ me Kushtetutën, derisa palët t’i provojnë asaj të kundërtën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrohen argumente bindëse para Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë nëse zgjidhjet e aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 16, datë 25.7.2008; 12, datë 14.4.2010; nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në çështjen në gjykim vlerësojmë se kërkuesja nuk dha argumente se masat që ajo mund të marrë për parandalimin e COVID-19 gjatë zhvillimit të një tubimi elektorale me pjesëmarrje të pakufizuar, do të parandalojnë përhapjen e virusit dhe në këtë kontekst të argumentonte dhe ashpërsinë e mjetit të përzgjedhur për kufizimin nga ministri i Shëndetësisë.

38. Po ashtu, Gjykata nuk ka kompetencë të analizojë nëse masa e ndërhyrjes është më e drejta, më e duhura apo më e përshtatshme për arritjen e qëllimit të urdhrit objekt gjykimi. Pakica vlerëson se nga masa më e ashpër shtrënguese deri te masa më pak shtrënguese, është përzgjedhur një masë e arsyeshme dhe e lidhur mjaftueshëm me qëllimin e kufizimit. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse kufijtë e jashtëm të hapësirës vlerësuese të ekzekutivit janë kapërcyer ose jo në rastet e nxjerrjes së akteve normative nënligjore. Edhe GJEDNJ-ja, për sa u përket masave kufizuese të të drejtave konventore për shtetet që duhet të kalojnë testin e proporcionalitetit, është shprehur se në disa raste hapësira e vlerësimit është e gjerë dhe në disa raste e ngushtë. Për sa i përket doktrinë së “hapësirës së vlerësimit”, kjo hapësirë i duhet lënë shteteve, të cilat nisur nga kontakti i drejtpërdrejtë dhe thelbësor me vendet e tyre, janë në pozicion më të mirë për të vlerësuar nevojat kombëtare dhe gjendjen e vendit. Hapësira e vlerësimit dhe diskrecioni varet nga natyra e së drejtës për të cilën bëhet fjalë, rëndësinë që ka ajo për individin, natyra e kufizimit, si dhe arsyeja dhe qëllimi i ndjekur për kufizimin (*Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 18 janar 2001, prg. 91.*) Po në këtë drejtim, Komisioni i Venecias ka



përmbledhur në një buletin të gjitha çështjet e shqyrtuara gjatë periudhës së pandemisë nga gjykatat kushtetuese ose gjykatat që kanë në kompetencë kontrollin e akteve të marra gjatë pandemisë, sipas sistemeve ligjore përkatëse, ku mund të dallohet lehtësisht shumëllojshmëria e qasjeve të vendeve të ndryshme në kontekstin e masave dhe kufizimeve, si edhe e vendimmarrjeve nga këto gjykata¹⁷.

39. Nga ana tjetër, shumica është shprehur se “...urdhri nr. 663/2020, në pikën 1 të tij përmban shprehjen “deri në një urdhër të dytë” që tregon se nuk ka një afat të qartë se kur këto masa kufizuese përfundojnë apo rishikohen. Konkretisht, nga hyrja në fuqi e tij e deri aktualisht, ky urdhër nuk është rishikuar (*prg. 68 i vendimit*) (...) termi “deri në një urdhër të dytë” krijon problematikë në dy drejtime: *së pari*, nuk detyron autoritetet përgjegjëse të bëjnë vlerësim periodik për masat kufizuese të përcaktuar me urdhrin në fjalë dhe, *së dyti*, nuk i përgjigjet standardit të proporcionalitetit. Kjo çështje merr edhe më shumë rëndësi po të merret në konsideratë që vendi tashmë është në prag të zgjedhjeve parlamentare” (*prg. 69 i vendimit*). Ky qëndrim i saj duket se ka lidhje jo vetëm me mosrespektimin e domosdoshmërisë, por edhe me papërshtatshmërinë e mjetit kufizues, si elemente të proporcionalitetit.

40. *Përshtatshmëria* është nëntesti i parimit të proporcionalitetit, sipas të cilit, kufizimi i së drejtës është bërë me masën apo mjetin që sjell efektin e duhur dhe realizon synimin për të cilin është përzgjedhur. Në këtë kontekst, merr rëndësi analiza e procesit në tërësi dhe fakteve konkrete nga veprimtaria e Komitetit Teknik. Kështu, urdhri nuk ka caktuar afat rishikimi në mënyrë të shprehur, por rezulton se Komiteti Teknik i Përkohshëm është shprehur në mënyrë periodike javore, sipas datave përkatëse: i. 17.11.2020 – masat e reja; ii. 23.11.2020 – universitetet *online*; iii. **2.12.2020** – masat mbeten në fuqi; iv. 8.12.2020 – situatë e qëndrueshme; v. 17.12.2020 – komunikim *online* me ekspertë të huaj; vi. 6.1.2021 – ora policore, situatë epidemiologjike; vii. 21.1.2021 – dëgjësë me ministren e Arsimit; viii. 1.2.2021 – pezullim i fluturimeve ajrore me Anglinë, ix. **25.2.2021** – masat mbeten në fuqi. Nga këto të dhëna, të bëra

publike rezulton se Komiteti Teknik në mënyrë të shprehur ka konfirmuar mosndryshimin e masave, në datën 2 dhjetor 2020, si dhe në datën 25 shkurt 2021, ku është shprehur specifikisht se masa e kufizimit të grumbullimeve deri në 10 persona, nuk do të ndryshohet¹⁸. Ky konfirmim i ekspertizës së Komitetit eventualisht është pranuar edhe nga ministri i Shëndetësisë, për sa kohë që nuk ka shfuqizuar urdhrin objekt kundërshtimi.

41. Po ashtu, rezulton se ministri i Shëndetësisë, bazuar në vendimin nr. 5005/8, datë 21.12.2020 të Komitetit Teknik të Përkohshëm, ka miratuar dy urdhra, përkatësisht nr. 680, 21.12.2020, “Për mbylljen e bareve dhe restoranteve, *fast-food* dhe lokaleve” dhe nr. 681, datë 21.12.2020, “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”. Për rrjedhojë, rezulton se ka pasur vazhdimisht vlerësime për gjendjen faktike të situatës së pandemisë dhe marrjes së masave përkatëse nga ministri i Shëndetësisë, kur është vlerësuar marrja e tyre¹⁹.

42. Pavarësisht sa më sipër, që lidhet me periodicitetin e vlerësimit të kufizimeve në përgjithësi nga Komiteti Teknik dhe ministri i Shëndetësisë, në fakt urdhri objekt gjykimi, i miratuar më 17 nëntor 2020, ka shfuqizuar një pikë të urdhrit të mëparshëm të qershorit 2020, (pikën 4 të urdhrit nr. 351/2020 për ndalimin e grumbullimeve masive), që do të thotë se periodikisht (qershor 2020-nëntor 2020), ministri i Shëndetësisë, bazuar në vlerësimet dhe këshillimet e Komitetit ka rishikuar masat e marra në drejtim të grumbullimeve/tubimeve, nëse duhet t’i ndryshojë apo nëse duhet të vazhdojë t’i lërë në fuqi, sikundër edhe ka ndodhur në rastin konkret. Rivlerësimi dhe rishikimi janë koncepte të ndryshme nga shfuqizimi, ndaj dhe vlerësojmë se masat dhe kufizimet në substancë janë rivlerësuar dhe rishikuar, në tërësinë e këtij procesi administrativ dhe, në këtë kontekst, nuk mundet që urdhri të lexohet i shkëputur dhe vetëm në kuptimin gramatikor të mospasjes afat konkret sikundër ka bërë shumica.

¹⁸ Shih dhe <https://shendetesia.gov.al/?s=komiteti>; <https://shendetesia.gov.al/masat-e-reja-per-te-parandaluar-perhapjen-e-covid-19>; <https://shendetesia.gov.al/komunikimi-i-perditshem-per-koronavirusin/>,

¹⁹ <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Urdher-Nr.680.pdf>; <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Urdher-Nr.681.pdf>

¹⁷ E-Buletin on Constitutional Case- Law, special collection of cases related to COVID-19, Mars 2021. Shih për më tepër: <https://venice.coe.int/files/Bulletin/COVID-19-c.htm>



43. Në kuptimin kushtetues të përshtatshmërisë së masës së përzgjedhur të kufizimit, periodiciteti i sipërpërmendur nga veprimtaria e të dyja organeve këshillimore dhe vendimmarrëse, në tërësi të procesit, e plotëson standardin kushtetues të mjetit të përzgjedhur që sjell efektin e duhur në drejtim të përkohshmërisë dhe arsyeshmërisë, pasi ministri i Shëndetësisë e ka marrë në konsideratë kohëzgjatjen e kufizimit dhe nuk e ka vlerësuar se duhet ndryshuar, deri para fillimit të fushatës zgjedhore.

44. Në këtë aspekt, pretendimi për mosperiodicitetin nuk qëndron, pasi para kësaj Gjykate është provuar kjo karakteristikë e këtij procesi me natyrë shkencore dhe shëndetësore. Për rrjedhojë, autoritetet shëndetësore janë brenda hapësirës së tyre të vlerësimit dhe kohëzgjatjes së arsyeshme të rishikimit të masave kufizuese, për sa kohë që në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme, bazuar në të dhënat që kanë për situatën e pandemisë, kanë informuar publikun si dhe kanë bërë rishikim të tyre herë pas here²⁰.

45. Për më tepër, kohëzgjatja e arsyeshme e proceseve, si standard kushtetues dhe detyrim i organeve publike për zbatim, ka lidhje edhe me kompleksitetin e çështjes, ndaj duke u ndalur vetëm në këtë element, vlerësojmë se ky kompleksitet në rastin konkret është i tillë që justifikon kohëzgjatjen e proceseve për veprimtarinë administrative të ministrit të Shëndetësisë. Për sa kohë që nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme, edhe për këtë arsye, nuk mund të arrihet në konkluzionin se, kur këto kufizime zgjasin pa afat, ato shndërrohen në ndalim tërësor të së drejtës.

46. Në përfundim, vlerësojmë se urdhri objekt gjykimi është rivlerësuar dhe rishqyrtuar brenda afateve të arsyeshme, duke u vendosur mosndryshimi i tij nga ministri i Shëndetësisë, përpara fillimit të fushatës zgjedhore, dhe, si i tillë, nuk cenon kriteret e proporcionalitetit, sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe jurisprudencës së konsoliduar të kësaj Gjykate.

C. Për dispozitivin e vendimit

47. Në dispozitivin e vendimit është urdhëruar: “Detyrimi i organit kompetent të rishikojë kohëzgjatjen e kufizimeve brenda një jave nga shpallja e këtij vendimi” (*pjesa e tretë e dispozitivit*).

48. Duke përdorur shprehjen “*organ kompetent*” vendimi mund të lërë vend për interpretim, se kjo detyrë për rishikim të kohëzgjatjes së kufizimeve i ngarkohet Komitetit të Përkohshëm Teknik, për sa kohë që kjo pjesë nuk është në harmoni me pjesën e dytë të dispozitivit, ku shumica është shprehur për shfuqizimin e pjesshëm të urdhrit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Po ashtu, kjo mundësi interpretimi përforcohet nga gjuha e përdorur edhe në arsyetim, ku përsëri në mënyrë të vazhdueshme përdoret termi “*organ kompetent*” (*prg. 71 të vendimit*).

49. Për sa më lart, çmojmë të qartësojmë se detyrimi i “organit kompetent” për rishikim të kohëzgjatjes së kufizimeve, në përputhje me nenin 131/c të Kushtetutës, i takon vetëm ministrit të Shëndetësisë, pasi objekt i kontrollit kushtetues është urdhri i tij, si akt normativ i nxjerrë nga një organ kushtetues gjatë procedurës administrative, brenda sferës së juridiksionit të tij. Gjykata nuk mund të vendosë detyrime për Komitetin e Përkohshëm Teknik, i cili vepron si organ këshillimor dhe vendimet e të cilit as nuk janë dhe as nuk mund të jenë objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese.

50. Për të gjitha sa më lart, si përfundim, vlerësojmë se kërkesa duhej rrëzuar, duke përdorur interpretimin pajtues të urdhrit nr. 633/2020 dhe duke arritur në konkluzionin se ai nuk cenon thelbin e lirisë së tubimit dhe të së drejtës së kërkuarës për t’u mbledhur, i lidhur me lirinë e shprehjes, parashikuar dhe garantuar nga nenet 47 dhe 22 të Kushtetutës në raport me nenin 17 të saj.

Anëtarë: Altin Binaj, Elsa Toska

²⁰ COVID -19- Strategjia e Rihapjes, Dokument i Ministrisë së Shëndetësisë, fq.12 dhe 13, i disponueshëm në: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Covid_Strategjia-e-rihapjes.pdf <https://shendetesia.gov.al/masat-e-reja-per-te-parandaluar-perhapjen-e-covid-19/> <https://shendetesia.gov.al/komunikimi-i-perditshem-per-koronavirusin/>.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë